



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

---

# RAPORTI VJETOR 2015

## Nr. 15

Prishtinë 2016

Z. Kadri Veseli  
Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës  
Prishtinë

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit,

Bazuar në nenin 135, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 29, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Ju paraqes Raportin e pesëmbëdhjetë vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës.

Njëkohësisht, ju lutem të pranoni edhe kërkesën për paraqitjen dhe diskutimin e këtij Raporti në seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës gjatë sesionit pranveror.

Me nderime,  
Hilmi Jashari  
Avokat i Popullit

Prishtinë 31 mars 2016

Tabela e përmbajtjes:

Fjala e Avokatit të Popullit .....	8
Institucioni i Avokatit të Popullit.....	10
Mandati i Institucionit të Avokatit të Popullit .....	11
Qasja në Institucionin e Avokatit të Popullit .....	15
<b>I. MBROJTJA E TË DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE TË NJERIUT DHE MIRËADMINISTRIMI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS .....</b>	<b>16</b>
1. Legjislacioni.....	16
1.2. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave.....	19
1.3. Roli i ekzekutivit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.....	24
1.3.1. Mbrojtja e të drejtave pronësore në Kosovë.....	26
1.3.2. Shpronësimi .....	27
1.3.3. Agjencia Kosovare e Pronës (AKPr).....	28
1.3.4. Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK).....	29
1.3.5. Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKPv) .....	30
1.3.6. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DPGJSK) .....	32
1.3.7. Të drejtat lidhur me mjedisin jetësor.....	34
1.3.8. E drejta e Qasjes në Dokumente Publike.....	37
1.3.9. Barazia para ligjit.....	40
1.4. Komunitetet Pakicë .....	46
1.4.1. Kthimi dhe siguria .....	47
1.4.2. Të drejtat pronësore .....	48
1.4.3. Arsimi .....	49
1.4.4. Lëvizja e lirë .....	51
1.4.5. Situata e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas.....	52
1.4.6. Përfaqësimi gjatë punësimit në organet qendrore dhe lokale .....	54
1.4.7. Përdorimi i gjuhës.....	55
1.5. Të Drejtat e Fëmijëve.....	59
1.5.1. Ankesat e parashtruara lidhur me të drejtat e fëmijëve .....	60
1.5.2. Të drejtat e fëmijëve në procedurat pranë organeve administ. dhe gjyqësore ....	60
1.5.3. E drejta e fëmijëve për shkollim.....	61

1.5.4. Të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara .....	62
1.5.5. Dhuna dhe gjendja e sigurisë në shkolla .....	62
1.5.6. E drejta shëndetësore e fëmijëve .....	63
1.5.7. Fëmijët në situatë rruge .....	64
1.6. Liria e besimit në Kosovë.....	65
1.7. Barazia Gjinore .....	67
1.7.1. Ligji për Barazi Gjinore nr.05/L-020 .....	68
1.7.2. E drejta në punë .....	68
1.7.3. E drejta e pronës dhe trashëgimisë .....	69
1.7.4. E drejta për mbrojtjen shëndetësore .....	70
1.7.5. Dhuna në familje .....	70
1.7.6. Gratë të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës .....	71
1.7.7. Pozita e popullatës LGBT në Kosovë.....	72
1.8. Ndalimi i Torturës .....	73
1.8.1. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) .....	73
1.8.2. Ankesat e personave të privuar nga liria .....	75
1.8.3. Lirimi me kusht .....	76
1.8.4. Monitorimi dhe vizitat në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria.....	77
<b>II. PËRMBLEDHJA E RAPORTEVE ME REKOMANDIME .....</b>	<b>78</b>
2.1. Rastet A.nr: 48/2012 Xhevdet Kalludra; A.nr.176/2012 Mexhit Balija; A.nr.125/2013 Abdylqerim Mripa; A.nr. 36/2015 Hajrullah Bahtiri; A.nr.49/2015 Muhamed Sherifi kundër Agjencisë Kosovare të Pronës .....	78
2.2. Rasti Ex officio nr. 517/2015, në lidhje me procedurën gjyqësore për ankesat kundër vendimeve preliminare për shpronësimin e pronës së paluajtshme .....	79
2.3. Rasti A. nr. 201/2015 Behram Krasniqi kundër Komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, apo të internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.....	80
2.4. Rastet: A.nr.23/2014 Pjetër Saliquuni dhe të tjerët; 473/2014 Zvonimir Vasić dhe të tjerët kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit në lidhje me vonesat në emërimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.....	81
2.5. Rasti Nr. 302/2012 Agim Memaj kundër Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me zvarritjen procedurale nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës në vendosjen e lëndës SR-11-0315/C-III-12-1993, që ka të bëjë me dorëzimin e patundshmërisë nga KBI “Progres” në Prizren .....	82

2.6.	Rasti Nr.602/2014 Sali Rexhepi kundër Shërbimit Korrektues të Kosovës për shkak të mosrealizimit të së drejtës në arsim, sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sankcioneve Penale, Nr.04/L-149 .....	82
2.7.	Ex officionr.498 /2015 lidhur me ngritjen e “Parkut të Paqes”, “Sheshit Car Lazar”, “Sheshit UÇK” dhe “Sheshit Adem Jashari”, në komunën e Mitrovicës së Veriut .....	83
2.8.	Rasti nr. 221/2013 Arsim Biqaku kundër Gjykatës Themelore në Prizren lidhur me zvarritjet procedurale nga gjykata për vendosjen e lëndës përkitazi me ndërprerjen e marrëdhënies së punës .....	84
2.9.	Ankesa nr. 66/2015 Novica Filipović kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Graçanicë në lidhje me zgjatjen e procedurës gjyqësore .....	85
2.10.	Ankesa nr. 435/2013 Nadežda Jovanović kundër AKPr në lidhje me ekzekutimin e Vendimit të Gjykatës Supreme KI 187/13.....	86
2.11.	Ankesa nr. 290/2015 Hivzija Bukvić kundër MPB në lidhje me procesin e marrjes së shtetësisë dhe përdorimin e gjuhëve.....	87
2.12.	Ex Officio nr. 680/2015, Rekomandimet drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me Strategjinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.....	88
2.13.	Ankesa nr.124/2015 Božidar Perić kundër Komunës Partesh në lidhje me të drejtën për të punuar dhe moszbatimin e Vendimit të Inspektoratit të Punës .....	89
2.14.	Ankesa nr.189/2015 Shaban Jashari kundër PK në Gjakovë në lidhje me të drejtën për jetë .....	90
2.15.	Ankesa nr. 337/2014 Mursel Bytyqi kundër Gjykatës Themelore në Prizren në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore .....	92
2.16.	Ankesa nr. 305/2015 Alinexhat Zeqiri kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë në lidhje me moszekzekutimin e Aktgjykimit përfundimtar dhe të ekzekutueshëm .....	93
2.17.	Ex officio nr.518/2014 lidhur me regjistrimin e kandidatëve nga kategoritë e dala nga Lufta e UÇK-së në vitin akademik 2014/2015 .....	94
2.18.	Rasti Nr.369/2014 lidhur me zvarritjen e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së z. Sahit Kastrati, z. Rrahman Mazreku dhe z. Agim Hyseini, për mos kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të mosbashkëpunimit të MPMS me IAP .....	95
2.19.	Rastet A. nr. 542/2013 Hafije Bislimi, A. nr. 4/2014 Suzana Caca, A. nr. 85/2014 Xhemajl Ademi kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) lidhur me ankesat për pezullimin e kërkesave për realizimin e të drejtave që burojnë nga Ligji për Statusin e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre Ligjin Nr. 04/L-054 .....	96
III.	AKTIVITETET E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT.....	98

3.1.	Aktivitetet e Grupit për të Drejtat e Fëmijëve.....	98
3.2.	Aktivitetet e Departamentit kundër Diskriminimit .....	102
3.3.	Aktivitetet e Njësisë për Barazi Gjinore .....	103
3.4.	Bashkëpunimi i IAP-it me Shoqërinë Civile,.....	104
3.4.1.	Bashkëpunimi me institucionet, organizatat dhe agjencitë ndërkombëtare .....	104
3.5.	Bashkëpunimi ndërkombëtar.....	107
3.5.1.	Bashkëpunimi me homologë dhe organizata të tjera ndërkombëtare.....	109
3.5.2.	Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare .....	111
3.5.3.	Raportimi në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtar .....	112
3.6.	Komunikimi me mediat.....	112
IV.	FINANCIMI .....	115
4.1.	Buxheti i IAP-së.....	115
4.2.	Financimi i IAP-së nga Buxheti i Republikës të Kosovës .....	115
4.3.	Buxheti final i IAP-së dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2015 .....	117
4.4.	Financimi i IAP-së nga donatorët.....	117
V.	STATISTIKAT.....	118
5.1.	Përmbledhja statistikore e ankesave dhe rasteve.....	118
	Shkurtesat.....	130

***Lista e tabelave:***

<i>Tabela 1 Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare .....</i>	<i>109</i>
<i>Tabela 2 Lista e raporteve të dërguara në organizata ndërkombëtare .....</i>	<i>112</i>
<i>Tabela 3 Shpërndarja e informatave/deklaratave/njoftimeve në web faqen e IAP-së.....</i>	<i>113</i>
<i>Tabela 4 Lista e paraqitjeve mediale sipas medimeve.....</i>	<i>114</i>
<i>Tabela 5: Kërkesa buxhetore, buxheti i ndarë, shkurtime buxhetore dhe buxheti final për vitin 2015 .....</i>	<i>116</i>
<i>Tabela 6: Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2015.....</i>	<i>117</i>
<i>Tabela 7: Ankesat e paraqitura nga qytetarët në IAP gjatë vitit 2015.....</i>	<i>119</i>
<i>Tabela 8: Ankesat e shpallura të papranueshme gjatë vitit 2015.....</i>	<i>119</i>
<i>Tabela 9: Rastet e hapura për hetim IAP gjatë vitit 2015 .....</i>	<i>120</i>
<i>Tabela 10: Lënda e rasteve të hetuara, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë (një rast mund të përfshijë më shumë se një shkelje të të drejtave të garantuara).....</i>	<i>121</i>
<i>Tabela 11: Numri i përgjithshëm i rasteve të mbyllura nga IAP gjatë vitit 2015 (jo vetëm rastet e vitit 2015, por edhe rastet e regjistruara më herët e të mbyllura gjatë këtij viti)...</i>	<i>122</i>

<i>Tabela 12: Dështimet e autoriteteve përgjegjëse për t'u përgjigjur në letrat e IAP-së .....</i>	<i>123</i>
<i>Tabela 13: Raportet me rekomandime për rastet nga IAP .....</i>	<i>123</i>
<i>Tabela 14: Zbatimi i rekomandimeve të nxjerra në raporte për rastet e hetuara nga IAP</i>	<i>124</i>

***Lista e figurave:***

<i>Figura 1: Paraqitja grafike e statistikave 1 janar 2015 - 31 dhjetor 2015 .....</i>	<i>125</i>
<i>Figura 2: Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në ankesat e paraqitura në IAP gjatë vitit 2015.....</i>	<i>125</i>
<i>Figura 3: Gjinia e qytetarëve bazuar në ankesat e paraqitura në IAP gjatë vitit 2015 .....</i>	<i>126</i>
<i>Figura 4: Autoritetet përgjegjëse të ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit 2015.....</i>	<i>126</i>
<i>Figura 5: Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në rastet e hapura për hetim - 2015 .....</i>	<i>127</i>
<i>Figura 6: Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP.....</i>	<i>127</i>
<i>Figura 7: Lënda e rasteve të hetuara, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë ...</i>	<i>128</i>
<i>Figura 8: Rastet e mbyllura nga IAP gjatë vitit 2015 (jo vetëm rastet e vitit 2015, por edhe rastet e regjistruara më herët e të mbyllura gjatë këtij viti).....</i>	<i>128</i>
<i>Figura 9: Zbatimi i rekomandimeve të nxjerra në raportet për rastet e hetuara nga IAP..</i>	<i>129</i>

## Fjala e Avokatit të Popullit

Viti 2015 ka shënuar 15 vjet nga themelimi i Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP), prej kur ishin hapur për herë të parë dyert për të pranuar qytetarët, sa herë ata konsideronin se të drejtat e tyre cenoheshin nga autoritetet publike. Kisha fatin të jem një nga tre juristët vendor që filluam të punonim nga ajo ditë, për të vazhduar më tutje si drejtor hetimesh dhe zëvendës e ushtrues detyre i Ombudspersonit të atëhershëm, për t'u rikthyer në krye të këtij institucioni, në korrik të vitit 2015, si i zgjedhur nga Parlamenti i vendit.

Raportimi vjetor i IAP-së para Kuvendit të Republikës së Kosovës është një mundësi e mirë për të reflektuar mbi ndikimin që ka ky mekanizëm i pavarur në kontrollimin e punës dhe shërbimeve të autoriteteve publike kundrejt qytetarit, efektivitetin e shërbimeve dhe shfrytëzimin e mjeteve juridike, respektimin e procedurave administrative, përmirësimin e administrimit dhe llogaridhënien.

Në korrik të vitit 2015, kanë hyrë në fuqi tre ligjet bazë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut: Ligji i Avokatit të Popullit, Ligji për Mbrojtje nga diskriminimi dhe Ligji për Barazi Gjinore, që kanë fuqizuar mandatin dhe i kanë dhënë kompetenca shtesë Avokatit të Popullit.

Këto ligje parashohin afate më të shpejta kohore për shqyrtim të rasteve, themelimin e Mekanizimit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), mbulimin jo vetëm të sektorit publik por edhe atij privat, përkritazi me rastet e diskriminimit, masa ndëshkimore për mosbashkëpunim me Avokatin e Popullit, inicimin e procedurave gjyqësore nga Avokati i Popullit, paraqitjen e Avokatit të Popullit në cilësinë e Mikut të Gjykatës (*amicus curiae*) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi, etj.

Duhet ritheksuar se Avokati i Popullit, si kategori e veçantë dhe e pavarur kushtetuese, në thelb të mandatit dhe misionit, ka mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e të drejtave të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike. Në përmbushje të këtij roli, vizioni im mbetet i qartë, përkritazi me çështjet kryesore në të cilat duhet të përqendrohet puna ime dhe e institucionit të cilin e udhëheq:

- Fuqizimi i zbatimit të rekomandimeve të IAP-së dhe, së këndejmi, rritja e besimit në këtë institucion;
- Shtrirja e njohurive mbi rolin e Avokatit të Popullit, tek secili individ, në të gjithë vendin, dhe dyert e hapura për të pranuar dhe trajtuar ankesat e tyre;
- Bashkëpunimi i ngushtë me mediat, shoqërinë civile dhe me institucionet publike, në funksion të promovimit e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, zbatimit të ligjshmërisë, transparencës dhe llogaridhënies.



Duke e konsideruar Raportin vjetor të Avokatit të Popullit drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës, si një rezymë të përgjithshme të funksionimit të IAP-së gjatë vitit 2015, duhet rikujtuar tre sfidat kryesore, që kanë vazhduar të përcjellin IAP-në:

- Sigurimi i hapësirave publike për funksionimin e Avokatit të Popullit, sipas parimeve dhe standardeve të pranuar ndërkombëtarisht;
- Shkurtimi i buxhetit të IAP-së pa dakordim paraprak me Avokatin e Popullit, që nënkupton cenim të pavarësisë së institucionit dhe pengesë në zbatimin e plotë të mandatit kushtetues dhe ligjor të IAP-së;
- Zbatimi i rekomandimeve të IAP-së, që, në fakt, ka shënuar një trend pozitiv prej rreth 50% në gjashtë mujorin e dytë, në krahasim me gjashtë mujorin e parë të 2015-tës, kur janë zbatuar vetëm 11% prej tyre.

Ky progres në zbatimin e rekomandimeve konsideroj se ka qenë rezultat i inicimit nga ana e Avokatit të Popullit të një komunikimi intensiv me autoritetet publike, me qëllim zgjidhjen pozitive të rasteve, në afate efektive kohore dhe në funksion të avancimit të përgjithshëm të drejtave të njeriut. Ky rezultat pozitiv përkitazi me zbatueshmërinë e rekomandimeve është gjithashtu rezultat i angazhimit të përbashkët të stafit të IAP-së dhe rritjes së përgjegjshmërisë nga ana e autoriteteve publike, sa i përket përmbushjes së obligimeve kushtetuese dhe ligjore, në shërbim të qytetarit.

Gjithsesi, gjendja e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës, imponon domosdoshmërinë e konsolidimit të sistemit ligjor, i cili vazhdon të jetë i fragmentuar dhe në shumë raste i pa harmonizuar. Efektet e një sistemi të tillë pengojnë mbrojtje adekuate të të drejtave të njeriut. Sistemi gjyqësor vazhdon të përballet me mbingarkesë të lëndëve dhe në këtë mënyrë është në pamundësi për të siguruar një mekanizëm efektiv juridik për mbrojtjen e të drejtave, përderisa administrata publike, në të dy nivelet, qendrore dhe lokale është jo llogaridhënëse, në pjesën më të madhe për shkak të mungesës së kontrollit adekuat gjyqësor të sektorit të administratës.

Avokati i Popullit ka dy aspirata themelore për punën e tij: e para për të rivendosur të drejtën e shkelur të individëve të cilët kanë përjetuar shkelje të të drejtave të njeriut dhe e dyta për të përmirësuar punën e administratës dhe autoriteteve publike, përgjegjëse për shkeljet e shkaktuara.

Në këtë kontekst, Avokati i Popullit do të jetë institucioni përmes të cilit do të mund të adresohen dhe të gjejnë zgjidhje shqetësime dhe ankesa të qytetarëve kundrejt veprimeve apo mosveprimeve të autoriteteve publike. Në të njëjtën kohë, Avokati i Popullit do të jetë vlerësues dhe promovues i praktikave të mira e pozitive, me qëllim të konsolidimit të vlerave demokratike, të cilat në bazamentin e vet kanë të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara me Kushtetutën e vendit, ashtu siç edhe me Marrëveshjet dhe Instrumentet Ndërkombëtare, të zbatuara drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.

Të drejtat e njeriut kanë qenë parim udhërrëfytes dhe çështje qendrore e ndryshimeve në këtë vend, prandaj, çdo udhëheqës institucional dhe zyrtar publik duhet të respektojë dhe të përkrahë të drejtat dhe liritë e njeriut dhe mandatin e Avokatit të Popullit, me qëllim zgjidhjen e problemeve të qytetarit në njërën anë dhe forcimin e demokracisë dhe fuqizimin e sundimit të ligjit. Liritë dhe të drejtat nuk janë vetëm garanci abstrakte kushtetuese, ato janë në esencë mjete përmes të cilave ne duhet të krijojmë mënyrën tonë të jetesës dhe shpresën për të ardhmen!

## **Institucioni i Avokatit të Popullit**

Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (nenet 132-135) Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) përcaktohet si kategori kushtetuese, përkatësisht si institucion i pavarur kushtetues.<sup>1</sup> Avokati i Popullit mbikëqyr, promovon dhe mbron të drejtat dhe liritë themelore të personave fizik dhe juridik nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, institucioneve dhe personave apo autoriteteve tjera të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës (më tej: autoritetet publike) si dhe krijimin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT).<sup>2</sup> Po ashtu, Avokati i Popullit përfaqëson mekanizmin e barazisë i cili promovon, monitoron dhe mbështet trajtimin e barabartë pa diskriminim në bazat e përcaktuara me Ligjin për barazi gjinore dhe Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi.<sup>3</sup> Sipas Kushtetutës, Avokati i Popullit ka një ose më shumë zëvendës,<sup>4</sup> ndërsa Ligji për Avokatin e Popullit përcakton se IAP përbëhet nga: Avokati i Popullit, pesë (5) zëvendës të Avokatit të Popullit dhe personeli i IAP-së.<sup>5</sup>

Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 28 maj 2015, ka miratuar pakon e ligjeve bazike për të drejtat e njeriut: Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Ligji nr. 05/L-020 për barazi gjinore dhe Ligji nr. 05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi. Këto ligje janë dekretuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës më 15 qershor 2015, janë botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës (GZRK), nr. 16 më 26 qershor 2015 dhe kanë hyrë në fuqi më 13 korrik 2015.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 2 korrik 2015, ka zgjedhur Avokatin e ri të Popullit, z. Hilmi Jashari, me mandat pesëvjeçar.

---

<sup>1</sup>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 132-135.

<sup>2</sup>Po aty, neni 132 dhe Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 1, paragrafi 1.

<sup>3</sup>Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 1, paragrafi 2.

<sup>4</sup>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 133, paragrafi 2.

<sup>5</sup>Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 5.

## Mandati i Institucionit të Avokatit të Popullit

Mandati i i Avokatit të Popullit është përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Avokatin e Popullit në bazë të të cilëve merr dhe heton ankesat nga çdo person, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës, i/e cili/a pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë nga autoritetet publike në Kosovë.

IAP është i pavarur në ushtrimin e detyrave dhe nuk pranon udhëzime ose ndërhyrje nga autoritetet publike, të cilat janë të detyruara t'iu përgjigjen kërkesave të IAP-së dhe t'i paraqesin të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin.

Në punën e vet IAP udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit<sup>6</sup> si dhe ka pavarësi organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj.<sup>7</sup>

Në kuadër të kompetencave të tij kushtetuese<sup>8</sup> dhe ligjore,<sup>9</sup> Avokati i Popullit zhvillon hetime për ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe aktet tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, posaçërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ).

Avokati i Popullit mund të zhvillojë hetime edhe me iniciativën e vet (*ex officio*) nëse dëshmitë, faktet, konstatimet ose njohuritë e fituara ofrojnë bazë për shkeljen e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, Avokati i Popullit përdorë ndërmjetësimin dhe pajtimin, si dhe mund t'u ofrojë shërbime të mira edhe qytetarëve të Republikës së Kosovës që ndodhen jashtë shtetit. Shërbimet e ofruara nga IAP janë falas.

Me Ligjin e ri për Avokatin e Popullit, ndër kompetencat shtesë të tij janë: nëse Avokati i Popullit gjatë kryerjes së hetimeve vëren se ka elemente të veprës penale e informon organin kompetent për fillimin e hetimeve; dhe se Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi.

Avokati i Popullit nuk ndërhyrë në rastet dhe në procedura tjera ligjore, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave, por Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor.

Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.<sup>10</sup>

---

<sup>6</sup>Po aty, neni 3, paragrafi 1.

<sup>7</sup>Po aty, neni 3, paragrafi 3.

<sup>8</sup>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 132.

<sup>9</sup>Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16.

<sup>10</sup>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 113, paragrafi 2 dhe 135, paragrafi 4; Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 10; Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, neni 29.

Avokati i Popullit kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi, Ligjin për barazi gjinore dhe legjisllacionin tjetër në fuqi; mbledh të dhëna statistikore për çështjet e diskriminimit dhe barazisë të paraqitura në IAP, të cilat edhe i publikon; publikon raporte dhe jep rekomandime për politikën dhe praktikën për luftimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë; bashkëpunon me partnerët social dhe OJQ-të që merren me çështje të barazisë dhe kundër diskriminimit si dhe me trupa të ngjashëm ndërkombëtar me Avokatin e Popullit.<sup>11</sup>

Ligji i ri për Avokatin e Popullit ka paraparë edhe krijimin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese (MKPT).<sup>12</sup>

Brenda një (1) viti pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, IAP do të filloj me ushtrimin e kompetencave dhe obligimeve ligjore si MKPT.<sup>13</sup>

Avokati i Popullit, në kuadër të përgjegjësi si MKPT, është i obliguar që t'i vizitoj rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria (duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut); si dhe të krijoj mekanizëm të veçantë që do të kryej të gjitha funksionet e MKPT-së. Avokati i Popullit duhet të bashkëpunojë me mekanizmat ndërkombëtar dhe vendor në fushën e parandalimit të torturës si dhe formave të tjera të trajtimit apo ndëshkimit mizor, jonjerëzor dhe poshtërues. Gjithashtu, Avokati i Popullit mund të jap sugjerime dhe rekomandime për personat dhe institucionet përgjegjëse ku mbahen personat e privuar nga liria pa marrë parasysh llojin apo objektin dhe rrethanat e mbajtjes së tyre, për përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të tyre.

Avokati i Popullit ka edhe përgjegjësitë e theksuara ligjore: jo vetëm t'i hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit por edhe të angazhohet për eliminimin e tyre; të hartojë dhe miratojë procedura të veçanta për pranimin dhe trajtimin e ankesave për fëmijët, si dhe krijimin e ekipit të specializuar për të drejtat e fëmijëve dhe të programit të përhershëm për vetëdijësimin e fëmijëve për të drejtat e tyre dhe rolin e IAP-së për mbrojtjen e tyre; t'i bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe t'i rekomandoj Qeverisë, Kuvendit dhe autoriteteve të tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit; t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta; të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve si dhe nxjerrjen apo ndryshimin dhe plotësimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës; të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës; të rekomandojë harmonizimin e legjisllacionit vendor me standardet

---

<sup>11</sup>Ligji për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, neni 16, paragrafët 13-16.

<sup>12</sup>Po aty, neni 17.

<sup>13</sup>Po aty, neni 38.

ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut, barazisë dhe diskriminimit, dhe të kryejë hulumtime për çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës; të bashkëpunojë, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, me të gjitha autoritetet vendore dhe ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut; të ruaj fshehtësinë e të gjitha informatave dhe të dhënave që i merr, duke i kushtuar kujdes të veçantë sigurisë së ankuesve, palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve, në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale (obligim ky që vlen për Avokatin e Popullit, zëvendësit e tij dhe personelin e IAP-së, dhe atë edhe pas përfundimit të mandatit ose marrëdhënies së punës).<sup>14</sup>

Avokati i Popullit i paraqet Kuvendit raportin vjetor për vitin paraprak dhe atë deri më 31 mars të vitit vijues, i cili raport shqyrtohet në seancë plenare në Kuvend gjatë sesionit pranveror.<sup>15</sup>

Krijimi dhe zhvillimi i kulturës së qeverisjes dhe administrimit të mirë, që kërkon administratë profesionale, efikase dhe efektive, transparencë, llogaridhënie dhe përgjegjësi të administratës publike karshi qytetarëve dhe forcim e zhvillim të sundimit të ligjit, janë objektivat kryesorë të Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit angazhohet për rritjen e besimit të qytetarëve në administratën publike, sistemin gjyqësor dhe institucionet dhe organet tjera të pushtetit.

Ankesat kundër administratës publike, qytetarët mund t'i parashtrojnë sipas një procedure të thjeshtë dhe pa pagesë. Ankesat e drejtuara në IAP mund t'u referohen veprimeve, mosveprimeve ose vendimeve të administratës publike, që nga ankuesit mund të konsiderohen të padrejta ose të pafavorshme. Në shqyrtimet e ankesave të tilla, veprimet e juristëve të IAP-së kanë të bëjnë me ofrimin e këshillave juridike, me kërkim të të dhënave nga administrata publike, nga gjykatat dhe nga institucionet tjera të rëndësishme, lidhur me ankesat e paraqitura, si dhe me mbikëqyrjen e procedurave të caktuara administrative dhe gjyqësore.

Avokati i Popullit, gjithashtu është edhe mbrojtës i autoriteteve publike nga kritikrat e pabazuara dhe të papërligjura, nga dezinformimi dhe veprimet e paligjshme, të qëllimshme apo të paqëllimshme.

Në rastet që kërkojnë veprime të menjëhershme, Avokati i Popullit paraqet kërkesa për masa të përkohshme. Nëse Avokati i Popullit konsideron se duhet të merren masa të menjëhershme nga autoritetet publike, ai mund të kërkojë ligjërisht që organi administrativ kompetent të ndërmarrë ose të suspendojë një veprim të veçantë, si masë e përkohshme për të parandaluar dëmtimin e papërmirësueshëm të ankuesve apo pasurisë së tyre.

Në qoftë se kërkesat për intervenim dhe përpjekjet për ndërmjetësim nuk janë të suksesshme, Avokati i Popullit mund të nxjerrë raport, duke siguruar analiza dhe paraqitje publike për shkelje të të drejtave të njeriut ose të ligjeve të aplikueshme, së bashku me

---

<sup>14</sup>Po aty, neni 18.

<sup>15</sup>Po aty, neni 29.

rekomandime për institucionin publik, për të evituar shkeljet. Raportet janë metoda e fundit e institucionit për avokim, kurse kopjet e raportit i dorëzohen autoritetit që e ka bërë shkeljen, Kuvendit të Kosovës dhe organizatave të tjera relevante.

Për të mbuluar fusha të caktuara që përfshijnë çështje të veçanta të disa grupeve të njerëzve (fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, gratë, gratë dhe vajzat nga komunitetet Rom Ashkali dhe Egjiptas, komuniteti Lesbike, Gej, Biseksual, Transgjinator etj.), të drejtat e të cilëve konsiderohen më të cenueshme në Kosovë, në IAP tash sa vjet funksionojnë Njësia për të drejtat e fëmijëve, Njësia për barazi gjinore dhe Njësia për mosdiskriminim. Sipas nevojës, Avokati i Popullit mund të krijoj edhe njësi të tjera përkatëse.

Kompetencat e Avokatit të Popullit për të shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga diskriminimi në përgjithësi dhe diskriminimi gjinor në veçanti janë paraparë me dy ligjet tjera bazike për të drejtat e njeriut (Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Ligjin për Barazi Gjinore).

Kështu, sipas Ligjit për Barazi Gjinore,<sup>16</sup> Avokati i Popullit është institucion i barazisë gjinore që trajton rastet që lidhen me diskriminimin gjinor, në përputhje me procedurat e parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit.

Ndërsa, sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi,<sup>17</sup> Avokati i Popullit është institucion i shtetit, i cili bënë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin sipas ligjit përkatës për Avokatin e Popullit. Kompetencat e Avokatit të Popullit të përcaktuara me këtë ligj janë pothuajse të njëjta me ato të përcaktuara në Ligjin për Avokatin e Popullit, por vlen të përmendet ajo që Avokati i Popullit paraqet raport së paku çdo vit në Kuvend për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe gjithashtu mund të hartojë raporte të veçanta për zbatimin e tij.<sup>18</sup>

Përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, është Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM).<sup>19</sup>

Avokati i Popullit, në kuadër të obligimeve ligjore, sipas Ligjit për Avokatin e Popullit,<sup>20</sup> më 15 dhjetor 2015 ka miratuar ***Rregulloren nr. 01/2015 për mënyrën e konkurrimit, procedurën e zgjedhjes dhe të propozimit të listës me emrat e kandidatëve për zëvendës të Avokatit të Popullit***, i cili është publikuar në GZRK më 16 dhjetor 2015 dhe ka hyrë në fuqi më 30 dhjetor 2015.

Njëherësh, është duke u punuar edhe në dy Projekt-rregullore tjera – *Projekt-rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në IAP si dhe Projekt-*

---

<sup>16</sup>Ligji nr. 05/L-020 për barazi gjinore, neni 13.

<sup>17</sup>Ligji nr. 05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi, neni 9.

<sup>18</sup>Po aty, neni 9, paragrafi 2, pika 2.12.

<sup>19</sup>Po aty, neni 10, paragrafi 1, pika 1.2.

<sup>20</sup>Po aty, neni 38, paragrafi 2.

*rregulloren e punës të IAP-së, të cilat pritet të miratohen gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2016.*

## **Qasja në Institucionin e Avokatit të Popullit**

IAP çdo ditë pune pret qytetarët, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre. Ata priten nga këshilltarët ligjorë të IAP-së, të cilët i trajtojnë rastet me kujdes, konfidencialitet dhe profesionalizëm.

Për të lehtësuar qasjen e qytetarëve të Kosovës në IAP, përveç Zyrës Qendrore në Prishtinë, IAP ka edhe zyra rajonale në Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe Graçanicë. Po ashtu, në kuadër të Zyrës Rajonale të IAP-së në Mitrovicë funksionon edhe nën-zyra e saj në veri të qytetit. Zyrat e IAP-së përbëhen nga stafi profesional që u shërben qytetarëve dhe përgjigjet në kërkesat dhe ankesat e tyre, si dhe mbron të drejtat të cilat ata konsiderojnë se u janë shkelur.

Ankesat e qytetarëve në zyrat e IAP-it pranohen çdo ditë pune (nga e hëna deri të premten) nga ora 8:00 - 16.00, por për raste urgjente qytetarët mund të paraqiten edhe jashtë orarit të punës.

Formë tjetër e qasjes më të lehtë të qytetarëve është edhe organizimi i Ditëve të Hapura nga Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij. Ato organizohen në Prishtinë (dy herë në muaj) dhe në zyrat rajonale (nga një herë në muaj). Zyrat rajonale i njoftojnë qytetarët e komunave përkatëse për ditët e hapura me anë të publikimit të datave nëpër këto komuna, nëpërmjet mediave lokale dhe nëpërmjet faqes zyrtare të IAP-së në internet.

Format tjera të qasjes janë edhe me postë, telefon, telefaks dhe me postë elektronike, që po përdoret gjithnjë e më shumë dhe e cila, në të shumtën e rasteve aktualisht po përdoret për parashtrimin e ankesave nga qytetarët që jetojnë jashtë Kosovës. Në Zyrën Qendrore të IAP-së në Prishtinë ekziston edhe linja telefonike falas për raste urgjente, por edhe për raste të tjera të zakonshme.

Zyrtarët e IAP-së bëjnë vizita të rregullta në të gjitha burgjet dhe në vendet ku mbahen personat me liri të kufizuar në Kosovë. Për të mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë me të burgosurit, në bashkëpunim me autoritetet e Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe me autoritetet përgjegjëse të burgjeve në Kosovë, IAP që nga viti 2004, në të gjitha burgjet dhe në qendrat e paraburgimit në Republikën e Kosovës, në vende të dukshme, ka vendosur kutitë postare, të cilat hapen vetëm nga përfaqësuesit e IAP-së. Kjo praktikë ka dëshmuar se kutitë e vendosura nëpër burgje, përkatësisht në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, kanë ndihmuar shumë të burgosur ose të paraburgosur ta vënë kontaktin e parë me Avokatin e Popullit. Kutitë e tilla janë vendosur edhe në Entet dhe Qendrat e Shëndetit Mendor, gjë që lehtëson qasjen e pacientëve në IAP. Këto ente dhe qendra vizitohen rregullisht për çdo muaj nga përfaqësuesit e IAP-së.

# **I. MBROJTJA E TË DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE TË NJERIUT DHE MIRËADMINISTRIMI NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

## **1. Legjislacioni**

Avokati i Popullit edhe gjatë vitit 2015 ka përcjellë procesin e hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve. Sipas Programit legjislativ për vitin 2015, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e saj të gjashtë me Vendimin nr. 02/06, datë 14 janar 2015, është paraparë që gjatë vitit 2015 të shqyrtohen dhe të miratohen 100 projektligje (prej tyre 35 të reja dhe 65 me ndryshime dhe plotësime të ligjeve ekzistuese) si dhe amendamentet kushtetuese në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Gjatë këtij viti Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar 46 ligje si dhe Amendamentin nr. 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ndërsa, në procedurë janë edhe 26 projektligje, 16 prej të cilave kanë kaluar shqyrtimin (leximin) e parë në Kuvend, 9 projektligje u janë shpërndarë deputetëve, kurse një projektligj nuk i është shpërndarë deputetëve.

Brengosë fakti se prej 100 projektligjeve të parapara për shqyrtim dhe miratim gjatë vitit 2015 sipas Programit legjislativ, shumica dërrmuese e tyre, 65 projektligje janë me ndryshime dhe plotësime. Gjithashtu, ky fakt është indikator që dëshmon se ligjet e miratuara, nuk kanë përmbushur standardin e kualitetit të dëshiruar dhe se nuk kanë qenë të hartuara në pajtim me zhvillimet në sektorët të cilët kanë mëtuar t'i rregullojnë. Procese të këtilla ligjore nuk ofrojnë qëndrueshmëri të sistemit juridik dhe gjithashtu, kërcënojnë rëndë parimin e sigurisë juridike.

Gjithashtu, zhvillimet të tilla në sistemin ligjor, nuk ofrojnë mundësi për zbatim adekuat të ligjit, jo vetëm nga organet ekzekutive por edhe në rast të sanksionimit nga organet gjyqësore në procedurat përkatëse administrative, civile apo kundërvajtëse.

Drejtoria për standardizim, përafrim dhe harmonizim ligjor që është në kuadër të Kuvendit të Republikës së Kosovës, do të duhej të gëzon mbështetje më të madhe me ekspertizë profesionale në përafrimin e projektligjeve dhe amendamenteve të propozuara nga komisionet parlamentare, me qasje për t'u përafruar me legjislacionin e Bashkimit Evropian (“*Acquies e BE-së*”) dhe me konventat ndërkombëtare të aplikueshme në Kosovë. Gjithashtu, duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë edhe harmonizimit të projektligjeve të propozuara me ligjet ekzistuese.

Një problem tjetër i cili e ka përcjell procesin e hartimit të ligjeve është edhe mos unifikimi i terminologjisë unike juridike. Shpesh herë ndodh që në ligje përdoren terminologji me dykuptimësi ose përdoren shprehje të ndryshme për institucionin e njëjtë juridik. Lidhur me këtë është e nevojshme që sa më shpejtë të filloj procesi i hartimit të fjalorit të



terminologjisë juridike i cili do të përdorej në procesin e miratimit të ligjeve, por i cili do të ndihmonte gjithashtu në masë të madhe sponzorizuesit e ligjit që vijnë nga degët e ndryshme të qeverisë.

IAP, gjithashtu, në disa raste ka dhënë opinion lidhur me nevojën e fillimit të dy proceseve paralele në Kuvendin e Kosovës, që gjithashtu kanë të bëjnë me fushën legjislative. E para ka të bëjë me procesin e konsolidimit të legjislacionit në fuqi, ndryshe i njohur edhe si proces i harmonizimit të ligjeve në kuadër sistemit juridik. Është evidente se ndodhë që ligjet e ndryshme përmbajnë dispozita juridike të cilat e përjashtojnë njëra tjetrën, e në disa raste dispozite brenda vet ligjit të njëjtë të cilat gjithashtu janë në kundërshtim. Për të evituar një problem të tillë, IAP, ka rekomanduar që të fuqizohen zyrat juridike brenda Kuvendit të cilat me mbështetje të përshtatshme profesionale do të evitonin pasojat e kundërshtimeve të tilla, të cilat e pengojnë zbatimin e ligjit dhe të cilat ofrojnë diskrecion lidhur me zbatimin e ligjit, apo edhe të interpretimit të tij.

Derisa, procesi i dytë që i rekomandohet Kuvendit, përmes opinionëve të IAP, ka të bëjë me procesin e kodifikimit të ligjeve, që nënkupton procesin e përmbledhjes së ligjeve të cilat rregullojnë fushën e njëjtë apo të përafërt. Deri më tani një pjesë e madhe e legjislacionit është rregulluar në mënyra parciale në disa ligje të ndryshme, ose edhe situata kur pjesa dërmuese e legjislacionit është rregulluar me akte nënligjore e të cilat janë të publikuara në web faqet e institucioneve përkatëse. Një proces i kodifikimit do të siguronte që i gjithë legjislacioni i një fushe apo të një resori të jetë i përmbledhur në një dokument, me çka do të lehtësonte qasjen në ligje që përbën kusht themelor për zbatim, por edhe do të ndihmonte zbatuesit e ligjit për kontroll efektiv të fushave përkatëse të së drejtës.

Qeveria, përkatësisht ministritë (si sponzorues kryesorë të projektligjeve) në vitin 2015 i kanë proceduar 72 projektligje, prej të cilave 46 janë miratuar në Kuvend, ndërkohë që në procedurë kanë mbetur edhe 26 projektligje. Edhe pse Qeveria i ka proceduar shumicën e projektligjeve të parapara me Programin legjislativ për vitin 2015, nuk është arritur të miratohen të gjitha, për shkak se një pjesë e tyre janë dërguar me vonesë nga Qeveria, ose nuk janë shqyrtuar me kohë në komisionet parlamentare përkatëse, prandaj edhe nuk kanë mundur të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara. Pengesë në këtë drejtim ka paraqitur edhe mos mbajtja e seancave plenare të Kuvendit gjatë gjysmës së dytë të shtatorit dhe pjesës më të madhe të tetorit, por edhe e një numri të mbledhjeve të komisioneve parlamentare për shkak të mungesës së kuorumit.

Sa i përket legjislacionit me interes vital<sup>21</sup>, në vitin 2015 është miratuar vetëm Ligji nr. 05/L-018 për provimin e maturës shtetërore, por nuk janë miratuar projektligjet tjera të parapara me Programin legjislativ.

---

<sup>21</sup> *Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 81 dhe Amendamentet 2 e 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, hyrë në fuqi më 7 shtator 2012.*

Projektligji për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës i është shpërndarë deputetëve, kurse Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë i është kthyer Qeverisë.

Ndërsa, nuk janë proceduar një numër i projektligjeve me interes vital.<sup>22</sup>Në fushën e legjislacionit që ka të bëjë me të drejtat e njeriut, në vitin 2015 janë miratuar tri ligje bazike për të drejtat e njeriut (Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit; Ligji nr. 05/L-020 për barazinë gjinore dhe Ligji nr. 05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi) si dhe Ligji nr. 05/L-003 për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me Vendim të Gjykatës; Ligji nr. 05/L-030 për përgjimin e telekomunikimeve dhe Ligji nr. 05/L-036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Kanë kaluar në shqyrtim të parë në Kuvendin e Kosovës: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta si dhe Projektligji për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik, ndërsa iu janë shpërndarë deputetëve Projektligji për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkesve dhe punëdhënësve si dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Mirëpo, nuk janë proceduar një sërë Projektligjesh të tjera që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut.<sup>23</sup>

Ndërkohë, IAP ka pranuar një sërë projektligjesh dhe draftesh të udhëzimeve administrative nga Qeveria dhe ministritë për dhënien e komenteve. Sipas Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 09/2011, organi propozues ka obligim që për projektligjet dhe aktet nënligjore, pos me ministritë përkatëse, të konsultohet edhe me IAP-në, për përputhshmërinë e tyre me “... *standardet e pranueshme ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut...*”<sup>24</sup> Pos dhënies së komenteve dhe rekomandimeve në pakon e ligjeve bazike për të drejtat e njeriut, Avokati i Popullit ka dërguar komente edhe për Projektligjin për shëndetin mendor, dhe në Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (së bashku me institucionet e tjera të

<sup>22</sup>Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës; Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L- 88 për trashëgiminë kulturore;

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës; Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/37 për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë; Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale dhe Projektligji për ndryshimi dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-041 për kufijtë administrativ të komunave.

<sup>23</sup> Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë; Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale; Projektligji për mbrojtjen e fëmijëve;

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;

Projektligji për Kundërvajtje; Projektligji për pensionimin e zyrtarëve të Policisë së Kosovës si dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Punës nr. 03/L-212.

<sup>24</sup> Rregullorja e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, neni 7, paragrafi 2.

pavarura kushtetuese: Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, Komisionin Qendror Zgjedhor dhe Komisionin e Pavarur të Mediave).

Avokati i Popullit e vlerëson pozitivisht praktikën e dërgimit të projektligjeve si dhe të drafteve të udhëzimeve administrative dhe të akteve tjera nënligjore nga institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës për konsultim me IAP.

Po ashtu, Avokati i Popullit ri-konfirmon gatishmërinë për të ofruar ndihmën dhe përkrahjen profesionale të IAP-së në këtë drejtim dhe u rekomandon të gjitha institucioneve të vendit që t'i dërgojnë në IAP aktet normative për konsultim dhe komentim, sidomos ato që kanë të bëjnë në çfarëdo mënyre me të drejtat dhe liritë e njeriut.

Në kuadër të përgjegjësiave të Avokatit të Popullit, të përcaktuara me Ligjin për Avokatin e Popullit, është edhe: *“të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës”*.<sup>25</sup>

Avokati i Popullit i ka rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-139 (i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-205) për shpronësimin e pronës së paluajtshme, përkatësisht heqjen në tërësi të disa dispozitave të nenit 35 të këtij ligji: paragrafit 6, nën-paragrafi 3 dhe 4, paragrafit 8 si dhe të paragrafit 13, nën-paragrafi 3 dhe 4 (shih: Raportit me Rekomandime për rastin *ex officio* A. nr. 517/2015).

Gjithashtu, Avokati i Popullit i ka rekomanduar MPMS-së që me përkrahjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarrë iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, në mënyrë që përkufizimet e Ligjit të jenë në harmoni me përmbajtjen e Ligjit (shih: Raporti me Rekomandime për rastin A. nr. 201/2015).

## **1.2. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave**

Sistemi gjyqësor i vendit në pajtim me ligjet e reja është reformuar dhe në aspektin organizativ rishtas është strukturuar, me qëllim të ngritjes së cilësisë sa i përket respektimit të standardeve më të larta të ndershmërisë, integritetit, paanshmërisë, profesionalizmit, efikasitetit dhe llogaridhënies.

Por përkundër reformave të bëra në sistemin gjyqësor, Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të vazhdoj përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve profesionale/profilizimin e gjyqtarëve, përmes trajnimeve në fusha të veçanta lidhur me lëndë civile dhe penale, të cilat mbulohen nga gjyqtarë ndërkombëtarë.

---

<sup>25</sup> Neni 18, paragrafi 1, pika 1.7.

Po ashtu, Këshilli Gjyqësor duhet vazhduar me procesin e përzgjedhjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve, për pozicionet e mbetura, veçanërisht për pakicat, për të cilat legjislacioni i Kosovës ka rezervuar një numër të caktuar të pozitive. Një sfidë tjetër e mbetur e cila kërkon vëmendje është edhe integrimi i gjykatësve dhe prokurorëve, të veriut të Kosovës në sistemin e drejtësisë të vendit sipas , “Marrëveshjes për drejtësi, për integrimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve” të Brukselit, të 10 shkurtit 2015. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me 25 mars 2015, kishte shpallur konkurs për plotësimin e vendeve të lira të punës në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Veri dhe degët e saj. Në bazë të informatave deri në hartimin e këtij raporti vjetor, Këshilli ende nuk ka përfunduar procesin e vlerësimit të aplikacioneve të kandidatëve, në pajtim me kriteret e Ligjit për Gjykatat.

Sistemi gjyqësor i Kosovës vazhdon të mbështetet nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX), në fushën e sundimit të ligjit, në bazë të Ligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian.<sup>26</sup> Gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it do të vazhdojnë të ndihmojnë autoritetet gjyqësore vendore drejt zhvillimit dhe forcimit të sistemit të pavarur të drejtësisë. Gjyqtarët veprojnë në panele të përziera gjyqësore me gjyqtarë vendorë për fusha të rezervuara të hetimit dhe gjyqimit, si: krimet e luftës, gjenocidi, terrorizmi, krimi i organizuar, korrupsioni, krimet ndëretnike, vrasjet e rënda, krimet ekonomike dhe krimet e tjera të rënda, por edhe për gjykimin e lëndëve civile të të gjitha natyrave, sipas Ligjit për Kompetencat.<sup>27</sup>

Një sfidë e vazhdueshme e sistemit gjyqësor mbetet mos zbatimi i standardeve për të drejtat dhe liritë e njeriut, siç parashihet me nenin 53 të Kushtetutës, sipas të cilit interpretimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore duhet të bëhet në pajtim me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Referimet në praktikën e GJEDNJ janë të pakta, dhe në rastet kur kjo ndodh ato bëhen në mënyrë të përgjithësuar por pa përcaktuar në mënyrë konkrete vlerësimet e GJEDNJ dhe lidhshmërinë e rrethanave të rastit në praktikë.

Deri sa për qytetarët sfidë mbetet shfrytëzimi i mekanizmave ndërkombëtar të mbrojtjes gjyqësore të të drejtave pas shterjes së mjeteve juridike, përkatësisht paraqitja e kërkesave në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tyre, pasi që Republika e Kosovës ende nuk është anëtare e Këshillit të Evropës.

Siç e kemi përmendur më lartë kompetencat ligjore të Avokatit të Popullit në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, në fushën e gjyqësorit, për dallim nga fushat tjera të veprimit, janë më të kufizuara, Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme lidhur me administrimin e drejtësisë përkatësisht në rastet e zvarritjeve të procedurave gjyqësore dhe të mos ekzekutimit të vendimeve të plotfuqishme gjyqësore. Gjyqësori mbetet si palë përgjegjëse me numrin më të madh të ankesave të paraqitura në IAP krahasuar me

---

<sup>26</sup> Ligji, nr.04/L-274 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

<sup>27</sup> Ligjin për Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, nr. 03L 053, neni 5. paragrafi 1.

institucionet tjera publike, pasi që ende nuk ka arritur të përmbush detyrimet ligjore në raport me kërkesat dhe të drejtat e garantuara të qytetarëve, për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të tyre.

Nga numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura, një numër i tyre nuk hynë në fushën e veprimit të Avokatit të Popullit, ankuesit kanë kërkuar hartim të parashtrësive të ndryshme me ç'rast edhe janë udhëzuar tek institucionet përkatëse për ofrimin e ndihmës juridike, si në Odën e Avokatëve të Kosovës, Komisionin për Ndihmë Juridike dhe shoqatat joqeveritare, të cilat ofrojnë shërbime ligjore falas për qytetarët.

Nga analiza e ankesave të pranuar për hetim vërehet se pjesa dërrmuese e tyre ka të bëjë me: zvarritje disavjeçare të procedurave gjyqësore në vendosjen e lëndëve; mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të plotfuqishme; parashkrimin e lëndëve gjyqësore si dhe me dyshime në objektivitetin e gjyqtarëve në vendosjen e lëndëve. Ato para së gjithash i referohen kontesteve të natyrës civile si: pronësore, familjare, detyimore, punësimit, sociale, përfshirë këtu edhe ato të natyrës penale. Zvarritjet procedurale në vendosjen e lëndëve gjyqësore, para së gjithash janë pasojë e numrit të madh të lëndëve të mbetura si të pazgjidhura nga vitet paraprake si dhe paraqitja e numrit të madh të lëndëve të reja gjyqësore.

Edhe pse është shtuar numri i gjyqtarëve<sup>28</sup> sa i përket zvarritjeve të lëndëve gjyqësore nuk është vërejtur ndonjë përparim në shqyrtimin e lëndëve brenda afateve të përcaktuara ligjore. Në këtë drejtim pas përfundimit të hetimeve të ankesave, lidhur me zvarritjet e procedurave gjyqësore nga gjykatat<sup>29</sup>, Avokati i Popullit vëren se zvarritja e procedurave me vite të tëra, edhe sa i përket çështjeve pronësore nuk arsyetohet, e posaçërisht kur kemi parasysh se nuk ekziston një mekanizëm përkatës për kompensim e tyre për shkak të zvarritjeve.

Sipas raportit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i cili i referohet gjashtë mujorit të parë të vitit 2015, numri i lëndëve të ngelura si të pazgjidhura ishte 425.277 ndërsa janë parashtruar 165.471 parashtrësia / lëndë të reja gjyqësore.<sup>30</sup>

Nga kjo mund të konstatohet se para gjyqësorit në pritje për shqyrtim dhe vendosje gjendet një numër i madh i lëndëve të cilat do të duhej të vendoseshin në pajtim me legjislacionin gjë që kërkon që KGJK-ja, por edhe institucionet tjera përgjegjëse, të angazhohen për gjetjen e një zgjidhje ligjore.

Sa i përket parashkrimit të lëndëve gjyqësore, raporti i lartpërmendur i KGJK, nuk përmban të dhëna përkitazi me parashkrimin e lëndëve gjyqësore në gjykata. Megjithatë, IAP është në dijeni se edhe në këtë vit raportues ka pasur parashkrime të lëndëve gjyqësore në

---

<sup>28</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës/Sekretariati, *Shkresa e datë 25 nëntor 2015*.

<sup>29</sup> Ankesa, A.25/2015 dhe 20/2015, kundër Gjykate Themelore Prizren, Ankesa, A. 84/2015 dhe ,kundër Gjykatës Themelore Prishtinë. , A.567/2015, kundër Gjykatës se Apelit,

<sup>30</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës, *Raporti i 6-mujorit të parë 2015*, *Statistikat e gjykatave të rregullta*, [www.kgjk-ks.org](http://www.kgjk-ks.org) (11.12.2014), faqe 3.

gjkata. Ndërsa sa i përket prokurorive, në gjashtë mujorin e parë të vitit 2015 janë parashkruar 1100 lëndë nga lëmi penal.<sup>31</sup>

Parashkrimi i lëndëve mund të jetë rezultat i ngarkimit të gjykatave me lëndë gjyqësore dhe i pamundësisë së vendosjes brenda afateve ligjore, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve. Mirëpo, ka raste kur parashkrimi është pasojë e neglizhencës apo e keqpërdorimit të detyrës nga gjykatës.

Avokati i Popullit thekson se parashkrimi i lëndëve gjyqësore paraqet një nga shkeljet më të rënda të të drejtave dhe lirive të qytetarëve të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që shprehimisht garanton se: “Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.”

Avokati i Popullit, konsideron se Zyra e Prokurorit Disiplinor, në të gjitha rastet e parashkrimit të lëndëve gjyqësore, duhet të hetojë në hollësi shkaqet e parashkrimit të lëndëve dhe, në çdo rast, pa asnjë përjashtim, të iniciojë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse ndaj përgjegjësve të pandërgjegjshëm, që e kanë lejuar parashkrimin e lëndëve.

Avokati i Popullit, gjithashtu, konsideron se KGJK duhet të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin strikt të legjislacionit, në mënyrë që gjykatat të shqyrtojnë dhe të vendosin lëndët brenda afateve ligjore në mënyrë që të mos vije deri te parashkrimi i tyre.

Themelimi i institutit të përmbaruesve privat sipas Ligjit për Procedurën Përmbarimore<sup>32</sup>, dhe funksionalizimi i tij me emërimin e përmbaruesve privat ka kontribuar pozitivisht në lehtësimin e punës së gjyqësorit dhe qasjen e qytetarëve në drejtësi në drejtim të përmbarimit të lëndëve gjyqësore në mënyrë më efektive dhe efikase. Por përkundër këtyre zhvillimeve pozitive, Avokati i Popullit, gjatë këtij viti ka pranuar një numër të konsiderueshëm të ankesave për shkak të mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore në nivel të vendit mbetet ende i ulët. Sipas Raportit të KGJK-së,<sup>33</sup> për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015, për përmbarim sipas vendimit/dokumentit përmbarues kanë qenë në punë 20.778 lëndë, ndërsa janë përmbaruar 1582 lëndë. Ndërsa sa i përket ekzekutimit të vendimeve lidhur me kontestet ekonomike kanë qenë në punë 4017 lëndë, ndërsa janë përmbaruar 231 lëndë. Shkaqet të cilat ndikojnë në shkallën e ulët të ekzekutimit të vendimeve të plotfuqishme, sipas KGJK-së, kanë të bëjnë me numrin e vogël të bashkëpunëtorëve për ekzekutim dhe mungesën e adresave të sakta në Kosovë, çka nuk arsyeton mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

---

<sup>31</sup> *Informatat e siguruar nga z.Imer Beka, Kryeprokuror, Prokuroria Themelore Prishtinë, Deklarata e tij në Gazetën “Kosova Sot” 5.8. 2015.*

<sup>32</sup> *Ligji nr.04/L-139,për Procedurën Përmbarimore, neni 323*

<sup>33</sup> *Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti i 6-mujorit të parë 2015 , Statistikat e gjykatave të rregullta, www.kgjk-ks.org (11.12.2014),, faqe 9*

Avokati i Popullit, lidhur me ankesat për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore<sup>34</sup> që janë në kompetencë të gjykatave, sipas Ligjit për Procedurën Përmbartimore, u është drejtuar gjykatave duke kërkuar informata lidhur me arsyet e zvarritjeve në ekzekutimin e tyre.

Një pjesë tjetër e ankesave lidhur me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore i referohet përmbartuesve privat, të cilët kanë lëshuar urdhër përmbartimor, për ekzekutimin e vendimeve në bankat komerciale, dhe llogaritë e ankuesve janë bllokuar nga autoritete bankare.<sup>35</sup> Lidhur me këtë çështje IAP ka zhvilluar edhe hetime ex officio.<sup>36</sup> Pas hetimit të ankesave, Avokati i Popullit ka konstatuar, se bllokimi i llogarive bankare të ankuesve me qëllim ekzekutimi, të cilët kanë qenë shfrytëzues të ndihmave sociale dhe pensioneve të pleqërisë, është bërë në kundërshtim me ligjin, i cili përcakton që nga pensionet mund të ekzekutohen vetëm një e dyta e shumës së pensionit, përkatësisht, një e treta e shumës së ndihmës sociale. Pas ndërmjetësimit të Avokatit të Popullit tek Përmbartuesit privat, është arritur, që llogaritë bankare të ankuesve të zhblokohen dhe ndalesat të bëhen në përputhje me ligjin.

Avokati i Popullit, gjatë pranimit dhe hetimit të rasteve<sup>37</sup> ka vërejtur se ka vonesa edhe në procedurën për vendosje sipas prapësimit. Lidhur me këtë, Avokati i Popullit vëren se ekziston një vlerësim i Gjykatës Supreme të Kosovës i përmbledhur në Mendimin Juridik nr. 223/2015, të datës 14 korrik 2015, me të cilin sqarohen paqartësitë lidhur me nenin 72 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore. Gjykata Supreme vë në pah se versioni i ligjit në gjuhën shqipe nuk cakton afat për vendosje sipas prapësimit, ndërsa versioni në gjuhën angleze (neni 72, paragrafi 1) përcakton se: *“Në prapësimet e paraqitura gjykata vendos në afat prej 15 ditëve nga dita e dorëzimit të prapësimit.”* Gjykata Supreme me anë të këtij Mendimi Juridik ka theksuar se gjykatat themelore, duhet të vendosin lidhur me prapësimet e paraqitura kundër urdhrave përmbartimorë, të nxjerra nga organet përmbartuese, në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së tij. Kjo për shkak se versioni në gjuhën shqipe përmban një lëshim teknik të ligjëvënës.

Avokati i Popullit konsideron se gjykatat themelore duhet t'i përmbahen mendimit juridik të Gjykatës Supreme për shkak se nga ankesat e paraqitura në IAP lidhur me këtë çështje, rezulton se ka vonesa deri në një vit për të vendosur për këtë çështje, në procedurën e cila nuk do të duhej të zgjaste më shumë se 15 ditë.

Një numër tjetër i ankesave janë paraqitur edhe për shkak të mos përfaqësimit të mirë të ankuesve në gjykata nga avokatët e tyre mbrojtës,<sup>38</sup> Në të gjitha këto raste, ankuesit janë njoftuar me të drejtën që të kërkojnë ndërrimin e avokatëve dhe që rastin e tyre ta paraqesin në Odën e Avokatëve të Kosovës.

---

<sup>34</sup> Ankesat, A.462/2015, A.615/2015, kundër Gjykatës Themelore Prishtinë

<sup>34</sup> Ankesat, A.nr.323/2015 dhe 341/2015, kundër Përmbartuesve Privat.

<sup>35</sup> Rasti, Ex.officio,nr.409/2015, kundër Odes se Përmbartuesve Privat.

<sup>36</sup> Ankesat A. nr. 615/2015, A.nr. 643/2015, A.nr. 691/2015 kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë

<sup>37</sup> Ankesat A. nr. 615/2015, A.nr. 643/2015, A.nr. 691/2015 kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë

<sup>37</sup> Ankesat A.nr.158/2015, A.nr.516/2015, kundër Avokatëve/Odes se Avokateve Kosovës.

<sup>38</sup> Ankesa A.637/2015, kundër Gjykatës Themelore në Gjiilan.

Në Odën e Avokatëve të Kosovës/ Zyrën e Prokurorit Disiplinor sipas raportit vjetor janë paraqitur 88 raste/ankesa kundër avokatëve, ndërsa për 44 raste janë iniciuar procedurat disiplinore për sjellje të pahijshme dhe shkelje të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit. Nga numri i rasteve të iniciuara, Komisioni Disiplinor i OAK, në një rast ka marrë vendim për pezullimin e përkohshëm të ushtrimit të profesionit, në katër raste ka shqiptuar dënim me gjobë, në dy raste ka shqiptuar masën e qortimit, ndërsa për rastet e tjera ka refuzuar ankesat<sup>39</sup>.

Oda e Avokatëve (OAK) sa i përket procedurave disiplinore deri diku është transparente me publikun me paraqitjen e punës së Komisionit në Webfaqe. Lidhur me këtë ajo gjithashtu, ka miratuar akte ligjore dhe standarde të punës në pajtim me Kodin e Etikës për sjelljet e avokatëve, por ajo nuk ka arrit të vendos një sistem i cili në mënyrë efikase do të mbikëqyr dhe përcjell respektimin e tyre. Nga hetimi i ankesave të qytetarëve, të parashtruara mbi bazën e legjislacionit pozitiv, Avokati i Popullit ka konkluduar se ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 31, 32 dhe 54 dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ), për shkak të zvarritjeve të procedurave në vendosjen e lëndëve, sipas mjeteve juridike të parashtruara.

Lidhur me këtë, për Avokatin e Popullit është shqetësues fakti se qytetarët nuk kanë një mekanizëm ligjor që do të përbënte mjetin efektiv në kuptim të nenit 13, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që siguron lehtësim në formë të parandalimit apo kompensimit të këtyre shkeljeve, lidhur me parashkrimin e lëndëve gjyqësore dhe zvarritjeve të tepruara të procedurës gjyqësore, përkundër rekomandimeve të vazhdueshme të Avokatit të Popullit për nxjerrjen e një instrumenti ligjor.

### **1.3. Roli i ekzekutivit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut**

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë pandashme, të patjetërsueshme dhe të pacenueshme, si dhe bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Mbrojtja, avancimi dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut janë obligim shtetëror dhe shteti duhet t'iu përmbahet marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Republika e Kosovës i ka përfshirë në nenin 22 të Kushtetutës<sup>40</sup> marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare më të rëndësishme për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të cilat janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë.

---

<sup>39</sup> *Raporti vjetor 2014 i Odës së Avokatëve të Kosovës, publikuar me 15 qershor 2015, faqe 90. OAK për vitin 2015 nuk ka publikuar ende raportin.*

<sup>40</sup> *“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:*



Këto instrumente ndërkombëtare kanë rëndësi të posaçme në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, për shkak se ato zbatohen drejtpërdrejt edhe në raste kur ka mangësi apo zbrastëti të shprehura në legjislacionin e brendshëm të Kosovës.

Avokati i Popullit jo vetëm që heton shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut, por edhe mund t'i këshillojë dhe t'i rekomandojë Qeverisë, Kuvendit dhe autoriteteve të tjera të Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Prandaj, Avokati i Popullit, duke u bazuar në mandatin e tij ka vërejtur se ZQM me "Planin Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2015" ka paraparë nxjerrjen e strategjive dhe planeve të veprimit për strategjitë aktuale për të krijuar politika më efikase, të qëndrueshme dhe të bashkërenduara në fushën e të drejtave dhe të lirive të njeriut, ku ZQM është përgjegjëse e aktiviteteve. Në këtë drejtim, deri në fund të vitit 2015 pritej hartimi i disa dokumenteve të tjera strategjike për periudhën 2016-2020, e që janë: *Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës; Plani Strategjik për të Drejtat e Fëmijëve; Plani Strategjik për mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet në internet; dhe Plani i Veprimit për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas*.

Aktualisht janë në zbatim e sipër gjashtë (6) strategji, tri prej të cilave përfundojnë sivjet, si: *Strategjia për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas në Republikën e Kosovës (2009-2015); Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas në Republikën e Kosovës (2009-2015); dhe Plani i veprimit për zbatimin e Strategjisë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (2013-2015).*

Ndërkaq, tri dokumente të tjera janë në zbatim e sipër, si: *Programi Kombëtar për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave dhe personat e shurdhër në Republikën e Kosovës (2013-2016); Strategjia Qeveritare dhe Plani i Veprimit për bashkëpunim me shoqërinë civile (2013-2017); dhe Strategjia Nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës (2013-2023).*

Nga të paraqiturat më lart shihet se Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht ZQM e ZKM-së është e angazhuar në politikat për avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, duke hartuar dokumente strategjike të fushave të caktuara, gjë që është për t'u vlerësuar, por shtrohet çështja e koordinimit të mirëfilltë të strategjive, duke pasur parasysh faktin se ekzistojnë disa dokumente strategjike dhe mekanizma të veçantë, që merren me koordinimin e zbatimit dhe të monitorimit të këtyre dokumenteve. Avokati i Popullit vëren se ZQM ka

---

(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;

(3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;

(4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;

(5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;

(6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;

(7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;

(8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese. "

hartuar disa dokumente strategjike për të drejtat e njeriut, prandaj duke u nisur nga fakti se të drejtat e njeriut janë unike dhe të patjetërsueshme ka rekomanduar që në nivel qendror të hartohet një strategji për të drejtat dhe liritë e njeriut, e cila do të përfshinte të gjitha strategjitë nga fushat e të drejtave të njeriut. Hartimi i një dokumenti unik strategjik për të drejtat e njeriut, do t'i shërbejë Qeverisë së Republikës së Kosovës si orientues në krijimin e politikave më efikase, të qëndrueshme dhe të bashkërenduara në fushën e të drejtave dhe liritë të njeriut, i cili do të ishte shumë më praktik e më i lehtë për monitorim, nga organizatat vendore e ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhe se procesi i zbatimit të tij do të mund të monitorohej nga një mekanizëm i vetëm qeveritar.

Nga praktika e deritanishme, është vërejtur se mekanizmat e nivelit politik të emëruar nga Qeveria janë organe përgjegjëse për të monitoruar progresin dhe vështirësitë e zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit për të drejtat e njeriut dhe për t'i raportuar Qeverisë së Republikës së Kosovës, në baza vjetore, për zbatimin e përgjithshëm të tyre. Nga të gjeturat e theksuara më lart, gjithashtu është vërejtur se raportimet për zbatimin e strategjive i janë paraqitur Qeverisë së Republikës së Kosovës nga mekanizmat e themeluar nga Qeveria, pra faktikisht hartimi i dokumenteve strategjike për të drejtat e njeriut dhe raportimi për zbatimin e tyre kryhet në të njëjtin institucion - në Qeveri. Prandaj, Avokati i Popullit ka rekomanduar që në kuadër të raportimeve vjetore të Kryeministrit para Kuvendit të Republikës së Kosovës të raportohet edhe për të drejtat e njeriut lidhur me zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit, në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione (dhe jo vetëm kur kërkohet nga ky Komision).

Sidoqoftë, Avokati i Popullit konsideron se autoritetet publike do duhej të mbaheshin përgjegjëse për moszbatim adekuat të ligjit dhe gjithashtu t'i bartin pasojat e veprimeve të shkaktuara mbi interpretimin diskrecional të ligjit dhe kurrësi që pasojat të barten nga qytetarët të cilëve mund t'iu shkaktohen shpenzime të panevojshme për realizimin e të drejtave në procedurat tjera gjyqësore, si rezultat i dështimit të organeve administrative për të ofruar mjete juridike efektive në dispozicion.

### **1.3.1. Mbrojtja e të drejtave pronësore në Kosovë**

Gjatë vitit raportues IAP ka pranuar një numër ankesash lidhur me të drejtën pronësore dhe ka lëshuar një numër rekomandimesh lidhur me shkeljet e të drejtave pronësore nga autoritetet shtetërore. Një numër i konsiderueshëm i ankesave ka të bëjë me kontestet pronësore të stërzgjatura nga gjykatat që pa dyshim përpos shkeljes së të drejtës në gjykim të drejtë dhe ta paanshëm përbën edhe pengim në gëzimin e qetë të pronës. Proceset e stërzgjatura nga ana e gjykatave, ndonjëherë edhe hezitimi për të gjykuar rastet e veçanta, jo vetëm që cenon të drejtën pronësore por pengon edhe ekonomizimin e pronave, transaksionet potenciale të tyre duke ndikuar negativisht edhe në ekonominë e vendit dhe në sigurinë juridike të qytetarëve.

Mbrojtja e të drejtave pronësore është parakusht për funksionimin e një sistemi ligjor dhe demokratik. Autoritetet e shtetit kanë një rrugë të gjatë përpara për të arritur një standard për mbrojtjen e të drejtave pronësore.

### 1.3.2. Shpronësimi

Ligji Nr. 03/L-139 (i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 03/L-205) për shpronësimin e pronës së paluajtshme, përcakton një procedurë të veçantë për ankesat gjyqësore kundër vendimeve preliminare për shpronësim të nxjerra nga Qeveria ose komuna. Sipas kësaj procedure, me rastin e paraqitjes së një ankese kundër vendimit preliminar për shpronësim e cila paraqitet në Gjykatën Themelore të Prishtinës, gjykata nxjerr aktgjykimin mbi rastin brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të përgjigjes së Organit Shpronësues, ndaj ankesës së paraqitur dhe, nëse gjykata nuk e nxjerr aktgjykimin brenda periudhës tridhjetë (30) ditore, konsiderohet se ajo përfundimisht ka nxjerrë aktgjykim për refuzimin e ankesës në tërësi menjëherë pas skadimit të kësaj periudhe.

Avokati i Popullit kishte hapur hetime *ex officio* dhe gjatë hetimeve ka konstatuar se:

Ligji Nr.03/L-139 (i ndryshuar dhe i plotësuar nga Ligji Nr.3/L-205) për shpronësimin e pronës së paluajtshme, paraqet shkelje të së drejtës së pronës, sipas nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 1 të Protokollit të Parë të KEDNJ-së; dhe shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sipas nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Avokati i Popullit më 16 tetor 2015, ka publikuar Raportin me Rekomandime nr.517/2015 për Kuvendin e Republikës së Kosovës (për më shumë shih te pjesa e Raporteve me Rekomandime të këtij Raporti).

Komisioni për Legjislacion, Mandate dhe Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit i Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2015 e shqyrtoi Raportin me Rekomandime të Avokatit të Popullit dhe ka rekomanduar që Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të koordinohen që me rastin e përgatitjes së programit legjislativ për vitin 2016, të merret nisma për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 (të ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 03/L-205) për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Avokati i Popullit përshëndet iniciativën e Kuvendit për përcjelljen e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në komisionet përkatëse të Kuvendit lidhur me ndryshimin e dispozitave të ligjit të cilat parashohin një afat tejet të shkurtër për shqyrtimin e ankesave të pronarëve ndaj vendimeve preliminare për shpronësim, prona e të cilëve i nënshtrohet shpronësimit.

### **1.3.3. Agjencia Kosovare e Pronës (AKPr)**

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesat e një numri qytetarësh pronat e të cilëve gjenden në pjesën veriore të Mitrovicës mbi cilat ata nuk janë në gjendje ta rikthejnë posedimin e humbur si pasojë e luftës të vitit 1999. Komisioni për Çështje Pronësore Banesore i Drejtorisë për Çështje Pronësore Banesore atyre u ka njohur të drejtën të cilën ata e kanë pasur mbi këto prona para vitit 1999. Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore, paraardhëse AKPr-së, i kishte vënë pronat nën administrimin e saj, për shkak të pamundësisë së pronarëve/poseduesve që të kthehen në pronat e tyre duke i lëshuar ato me qira. Mirëpo, qiramarrësit ishin shndërruar në shfrytëzues të paautorizuar pasi që refuzonin të paguajnë qiranë e përcaktuar nga drejtoria dhe po ashtu refuzonin t'i lirojnë pronat. Gjatë trajtimit të rastit Avokati i Popullit është njoftuar nga AKPr-ja se ajo ka nën administrim gjithsej 390 prona, ndërsa janë ekzekutuar rreth 27 dëbime. Avokati i Popullit më 12 mars 2015, pas hetimit të ankesave të pranuar jo vetëm përgjatë vitit raportues por edhe të viteve të mëparshme, ka lëshuar Raportin me Rekomandime nr. 48/2012; nr. 176/2012; nr. 125/2013; nr.36/2015; nr.49/2015 për AKPr dhe për Qeverinë e Republikës së Kosovës (për më shumë shih te pjesa e Raporteve me Rekomandime të këtij Raporti).

Rekomandimet e Avokatit të Popullit të paraqitura në këtë raport vlejné jo vetëm për pjesën veriore të Mitrovicës por për të gjitha situatat e ngjashme në territorin e Republikës së Kosovës. Përderisa, AKPr vazhdon përpjekjet e saj në përmbushjen e obligimeve të veta, brenda mundësive të saj, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk i ka ofruar përkrahjen e duhur AKPr-së në përmbushjen e obligimeve të saj ligjore.

Më 15 qershor 2015 USAID (Programi për të Drejtat Pronësore) kishte organizuar një tryezë lidhur me zbatimin e vendimeve të lëshuara nga Komisioni i Kosovës për Kërkesa Pronësore (KKKP) e AKPr në të cilën ishte ftuar edhe IAP-i. AKPr kishte paraqitur sfidat me të cilat ballafaqohet në zbatimin e vendimeve të KKKP-së. AKPr-ja ka paraqitur gjithashtu edhe disa nga sfidat lidhur me përfundimin e plotë të mandatit të AKPr-së e që janë: Implementimi i Skemës së Kompensimit (143 raste); Implementimi i shkatërrimit të strukturave të paligjshme (28 raste); Procesi i dëbimeve në pjesën Veriore të Mitrovicës; Ri-uzurpimet e pronave, etj.

AKPr-ja ka sqaruar se shumica e sfidave të përmendura kanë implikime financiare dhe se përmbushja e tyre varet nga mbështetja financiare e Qeverisë dhe donatorëve eventual.

#### ***1.3.3.1. Rastet e riuzurpimit të pronave të liruara nga AKPr-ja***

Në përgjithësi rastet e uzurpimit të pronave në Kosovë janë një dukuri mjaft e shprehur. Në veçanti është e shprehur dukuria e riuzurpimit të kundërligjshëm të pronave nën

administrimin e AKPr-së. Sipas një raporti të Misionit të OSBE-së në Kosovë,<sup>41</sup> ndërmjet viteve 2008 dhe 2013, AKPr ka referuar 326 raste të tilla të riuzurpimit në prokurori, të cilat kishin të bënin me prona nën administrimin e saj dhe numri i riuzurpimeve të paligjshme në të gjithë Kosovën me gjasë është më i lartë kur përfshihen edhe pronat që nuk janë nën administrimin e AKPr-së.

Sikur në rastet kur bëhet fjalë për pronat e uzurpuara që janë nën administrimin e AKPr-së ashtu edhe uzurpimeve tjera të paligjshme të pronave në përgjithësi bëhet fjalë për veprë penale, dhe se rastet e uzurpimeve të kundërligjshme procedohen ose do të duhej të procedoheshin në prokurori dhe më tutje në gjykata. Vonesat në trajtimin e rasteve nga autoritetet publike, prokuroritë dhe gjykatat, të cilat zënë vend në shumë raporte të Avokatit të Popullit, ndikojnë drejtpërdrejtë në të drejtën pronësore.

### **1.3.3.2. Regjistrimi i të drejtës pronësore të vërtetuar nga KKKP-ja.**

Avokati i Popullit gjatë vitit raportues ka pranuar ankesë lidhur me refuzimin e kërkesës për regjistrimin e të drejtës pronësore të vërtetuar me vendim të plotfuqishëm të KKKP-së.<sup>42</sup> Me gjithë faktin që ankuesi ka paraqitur vendimin e KKKP-së pranë Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Lipjanit, ai është dashur ti nënshtrohet procedurës administrative e cila ka përfunduar me inicimin e konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, e cila më 22 maj 2015 ka nxjerrë një aktgjykim për miratimin e kërkesës për regjistrimin e të drejtës pronësore. Edhe pas nxjerrjes së aktgjykimit nga GJTHP ankuesi nuk ka arritur të regjistrojë të drejtën pronësore për shkak të refuzimit nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Lipjanit.

Dështimi për të regjistruar të drejtën pronësore në përgjithësi, e në veçanti te rastet e vendosura nga KKKP-ja, do të thotë se e drejta pronësore nuk është rivendosur plotësisht. Dështimi për të regjistruar të drejtën pronësore krijon hapësirë për falsifikim të regjistrimeve gjë që e cenon të drejtën pronësore të individëve.<sup>43</sup>

### **1.3.4. Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK)**

Në IAP janë paraqitur ankesa nga qytetarët me pretendime se ka mospërputhje të pikave të ngastrave kadastrale të cilat sigurohen nga regjistrat e ri në zyra kadastrale komunale (ZKK) me gjendjen reale në terren. Sipas pretendimeve të qytetarëve të cilët kanë paraqitur ankesa

<sup>41</sup> SHQYRTIM I RASTEVE TË RIUZURPIMIT NË KOSOVË, Misioni i OSBE-së në Kosovë, janar 2015  
<http://www.osce.org/sq/kosovo/141136?download=true>

<sup>42</sup> IAP, rasti A. nr. 508/2015, Ankesë kundër Kuvendit Komunal të Lipjanit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

<sup>43</sup> Shih Challenges in the Resolution of Conflict-Related Property Claims in Kosovo, OSCE Mission in Kosovo June 2011, <http://www.osce.org/kosovo/80435?download=true>

në IAP,<sup>44</sup> mospërputhjet janë shkaktuar si rezultat i gabimeve që janë bërë me rastin e krijimit të data bazave elektronike nga kompania e kontraktuar nga AKK-ja. Avokati i Popullit i është drejtuar me shkrim Kryeshefit Ekzekutiv të AKK-së lidhur me pretendimet për mospërputhje të të dhënave elektronike me situatën në terren. Zyra Ekzekutive e AKK-së ka kthyer përgjigje IAP-it, ku në mes tjerash, ka pohuar se ka një prag tolerance të gabimeve gjatë vektorizimit të hartave kadastrale e cila është caktuar me Kornizën për Matjen Kadastrale në Kosovë Nr. AKK 2005/1-Niveli i Tolerancës.

Avokati i Popullit, nuk ka kapacitete teknike dhe as mandat ligjor për të vërtetuar pretendimet e palëve ankuese, të cilat pohojnë se mospërputhjet tejkalojnë nivelin e tolerancës dhe as vërtetësinë e pohimeve të AKK-së, Avokati i Popullit vlerëson se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në koordinim me komisionin përkatës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, do të duhej të vlerësonte punën e AKK-së në krijimin e data bazave elektronike, duke mos paragjykuar rezultatin e ndonjë procesi gjyqësor të iniciuar nga qytetarët pranë gjykatave kompetente.

### **1.3.5. Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKPv)**

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka pranuar ankesa nga qytetarët, ish punëtorë të ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara, lidhur me vonesat në shpërndarjen e mjeteve nga AKPv. Pas hetimit të ankesave dhe komunikimit me Agjencinë Kosovare të Privatizimit është konstatuar se mungesa e emërimit të Bordit të Drejtorëve të AKPv-së ka shkaktuar vonesën në shpërndarjen e mjeteve nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore.

Lidhur me këtë Avokati i Popullit më 30 tetor 2015, ka publikuar Raportin me Rekomandime lidhur me rastet nr. 23/2014 dhe nr. 473/2014, për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Kuvendin të Republikës së Kosovës (për më shumë shih te pjesa e Raporteve me Rekomandime te këtij Raporti).

Kuvendi i Republikës së Kosovës në seancën plenare të mbajtur më 14 dhe 17 dhjetor ka emëruar tetë anëtarët e Bordit të Drejtorëve të AKPv-së, të propozuar nga Qeveria e Kosovës.

Avokati i Popullit gjatë vitit 2015 ka pranuar dy ankesa nga pronarët e rinj të pronave të privatizuara lidhur me uzurpimin e këtyre pronave dhe pamundësimin e lirim të tyre nga AKPv-ja, Policia e Kosovës dhe Gjykata Themelore e Prishtinës. Gjatë hetimit të rastit Avokati i Popullit ka konstatuar se ka hezitim nga organet e rendit për të liruar pronat e uzurpuara. Po ashtu, Avokati i Popullit ka konstatuar se Gjykata Themelore e Prishtinës, ku ankuesit kishin paraqitur padi për lirim të pronave, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për vendosje lidhur me paditë e pronarëve të ri. Avokati i Popullit mbetet i shqetësuar me mosveprimin e organeve të rendit dhe Gjykatës Themelore të Prishtinës në lirim të pronave

---

<sup>44</sup>IAP, rastet A.nr.362/2015 dhe A.nr.385/2015

duke marrë parasysh që uzurpimi i pronës paraqet veprë penale. Sidoqoftë, Avokati i Popullit i kishte fokusuar hetimet në përgjegjësitë e AKPv-së për lirimin e këtyre pronave, para se të lëshohet në hezitimin për të zgjidhur këto raste nga organet e rendit dhe Gjykatës Themelore të Prishtinës. Avokati i Popullit ka mësuar se AKPv-ja në nëntor të vitit 2014 kishte nxjerrë Vendimin nr. 270/2014 dhe Udhëzuesin për Lirimin e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpuesit (Shfrytëzuesit e Paligjshëm) që vlen për pronat që aktualisht janë nën juridiksionin e AKPv-së dhe veprimet që AKPv-ja i ka ndërmarrë për lirimin e pronave që janë në shitje, por të cilët nuk vlejné edhe për pronat që janë shitur para nëntorit të vitit 2014. Me gjithë faktin që vendimi i AKPv-së paraqet një iniciativë të mirë për të siguruar se AKPv-ja do të garantojë shitje të pronave të liruara nga të metat juridike, në këtë rast uzurpimit të pronave, kjo nuk zgjidh situatën e pronave të shitura nga AKPv-ja duke mos i liruuar ato nga uzurpatorët dhe shfrytëzuesit e kundërligjshëm. Lidhur me këtë Avokati i Popullit është duke e përpiluar një raport me rekomandime për AKPv-në dhe Policinë e Kosovës.

Sikur edhe vitin e kaluar edhe këtë vit Avokati i Popullit vazhdon të pranojë ankesa kundër AKPv-së lidhur me mos përfshirje në listat e ish-punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara si dhe me privatizimin e pronave të ndërmarrjeve shoqërore pa u rishqyrtuar rikthimi i pronave të cilat në forma të ndryshme ishin marrë nga pronarët me qëllim të themelimit të ndërmarrjeve shoqërore.

Sa i përket çështjes së përfshirjes në listat e 20%, sipas Rregullores së e UNMIK-ut Nr. 2003/13, neni 10, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/45, neni 10, e cila është akoma në fuqi dhe me të cilën rregullohet shpërndarja e vlerës prej 20% nga shitja e ndërmarrjeve shoqërore, personi duhet të ketë së paku tre vjet pune në ndërmarrje shoqërore dhe të jetë në listën e pagave në kohën e privatizimit. Sidoqoftë, DHPGJS në bazë të rregullores dhe interpretimit të saj në raport me nenin 8 të Ligjit Kundër Diskriminimit (atëherë në fuqi) nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, ka marrë qëndrim që personi mund të parashtrojë deklaratë standarde për diskriminim, faktet nga të cilat mund të prezumohet se ka pasur diskriminim si dhe një kopje të certifikuar të bllokut të shënimeve që tregon për përkushtimin në ndërmarrje shoqërore për më shumë se tre vjet, që tregon se ende është e hapur, do të konsiderohet punëtor legjitim për të përfituar nga vlera 20% e shitjes së ndërmarrjes shoqërore.<sup>45</sup> Avokati i Popullit, në bazë të gjetjeve të veta gjatë intervistave të ankuesve lidhur me çështjen e shpërndarjes së vlerës prej 20%, konsideron se punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore të cilët nuk kanë pasur mundësi të gjenden në listat e punonjësve të ndërmarrjes shoqërore në kohën e privatizimit si pasojë e largimit nga puna në baza diskriminuuese, nuk e kanë shfrytëzuar në mënyrë të duhur qëndrimin e DHPGJS, nuk kanë qenë të informuar sa duhet ose nuk kanë pasur përfaqësim adekuat ligjor pranë DHPGJS. Ndërsa, në shumë raste ish-punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore nuk e kanë shfrytëzuar asnjë mjet juridik.

---

<sup>45</sup> *Shih Shqyrtim Juridik i Çështjeve të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme në <http://www.osce.org/sq/kosovo/32013?download=true>*

Sa i përket çështjes së privatizimit të pronave pa u shqyrtuar paraprakisht rikthimi i tyre pronarëve privat, Avokati i Popullit ka marrë qëndrim edhe në raportin vjetor të vitit paraprak, duke u pajtuar me gjetjet dhe rekomandimet e Misionit të OSBE-së në Kosovë, të *Shqyrtimit Juridik të Çështjeve të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme* (maj 2008), se Kuvendi i Republikës së Kosovës do të duhej të miratonte ligjin për rikthimin e pronave, i cili përpos rikthimit të pronave pronarëve legjitim, do të kujdesej edhe për vendosjen e balancit në mes të pronarëve të cilit nuk ishin në gjendje që të rikthejnë pronën e tyre si pasojë e mungesës së ligjit për restituimin e pronave dhe pronarëve legjitim të cilët do të përfitonin nga ligji për restituim.

### **1.3.6. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DPGJSK)**

Çështja e punës dhe efikasitetit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK) mbetet çështje shqetësuese edhe për këtë periudhë raportuese. Përkundër të gjitha nismave për përmirësimin e efikasitetit të punës së kësaj gjykate ekziston ende një problem në grumbullimin e lëndëve, si dhe një numër i madh i rasteve që edhe më tutje vazhdojnë të mbeten të pa zgjidhura pranë kësaj Gjykate.

DHPGJSK si pjesë e Gjykatës Supreme vepron në rastet që kanë të bëjnë me çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (ish Agjencia Kosovare e Mirëbesimit), në të cilat mblidhen kolegje të përziera, të përbëra nga gjyqtarë vendorë dhe ndërkombëtarë (të emëruar nga EULEX-i). Këshilli Gjyqësor i DHPGJSK shqyrton rastet që lidhen me procesin e privatizimit, lista e punëtorëve që kanë të drejtë në pjesën e 20% të privatizimit të ndërmarrjeve ish shoqërore, paditë pronësore ligjore, paditë që kanë të bëjnë me procesin e likuidimit të kompanive shoqërore, si dhe në lidhje me riorganizimin e tyre. Dhoma e Apelit shqyrton ankesat kundër vendimeve të DHPGJSK, si dhe ankesat kundër vendimeve të gjykatave të tjera.

Gjatë vitit 2015 ka pasur një rritje të numrit të lëndëve të pazgjidhura pranë kësaj gjykate. Sipas informatave zyrtare të DHPGJSK deri në mes të dhjetorit të vitit 2015, Gjykata kishte në procedurë një total prej 23,327 rasteve. Raste të pazgjidhura nga viti i kaluar kanë qenë 19.210, ndërsa deri më 16 dhjetor 2015, ka marrë edhe 4,117 raste të reja. Këto të dhëna janë alarmante për faktin se në këtë gjykatë kontestet nuk trajtohen për shumë vite. Një nga arsyet kryesore pse kjo ndodh është se në këtë gjykatë numri i gjyqtarëve dhe stafit ndihmës është i kufizuar, si dhe se puna në këtë gjykatë varet edhe nga emërimi i gjyqtarëve ndërkombëtar nga EULEX-i, të cilët emërohen për një afat relativisht të shkurtër. Nga informatat e siguruar del se gjatë vitit 2015 janë zgjidhur vetëm 1,797 raste në të gjitha fushat në të dy shkallët e DHPGJSK në pesë Panele të specializuara dhe në Gjykatën e Apelit. Pritet që kjo gjykatë në vitin 2016 të ketë 21,530 raste të pazgjidhura, dhe numri i ankesave që do të vijnë do të jetë më i lartë se në vitin e kaluar.



Gjatë kësaj periudhe raportuese, IAP ka pranuar 43 ankesa në të cilat pala përgjegjëse ishte DHPGJSK, duke përfshirë ankesë grupore të 73 ankuesve, ish-punonjës të NSH "Trepça".<sup>46</sup> IAP ka nisur një hetim për 25 ankesa, ndërsa 18 janë refuzuar si të papranueshme. Ankesat të cilat janë paraqitur kundër DHPGJSK ishin të lidhura kryesisht me tejzgjatjen e proceseve gjyqësore në rastet që kanë të bëjnë me të drejtat e ish-punëtorëve të cilët kanë të drejtë në pjesën e 20% të privatizimit të kompanive publike, të cilat në të kaluarën ishin në pronësisë gjatë privatizimit të pronës publike, çështjet pronësore gjatë privatizimit të pasurisë shoqërore, të cilat në të kaluarën ishin në pronësi të individëve privatë, në lidhje me mospagesën e pagave të të punësuarve në kompanitë e privatizuara, si dhe lëndët që lidhen me kërkesat për blerjen e banesave shoqërore dhe ku janë plotësuar kushtet që dalin nga të drejtat banesore dhe të qiramarrjes.

Në lidhje me një prej ankesave të paraqitura pranë IAP në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës pranë DHPGJSK, IAP më 23 mars 2015, ka dërguar në gjykatë një raport me rekomandime për të ndërmarrë pa vonesë të mëtejshme të gjitha masat e nevojshme në shqyrtimin dhe vendimin në rastin e ankuesit.<sup>47</sup> Duhet të theksohet se rastin kundër DHPGJSK, IAP e ka pranuar qysh në vitin 2012, por deri më sot kjo gjykatë nuk ka vendosur për çështjen e mësipërme, nuk është caktuar asnjë seancë, ndërsa as ankuesit nuk kanë ndonjë informacion në lidhje me veprimet e ndërmarra në të njëjtën gjykatë. Fakti shqetësues është se IAP rregullisht merr përgjigjet nga DHPGJSK përgjigje me përmbajtje të ngjashme, dhe kjo është se rastet janë në procedurë por nuk specifikohet se në cilën fazë, pastaj se në të shumtën e rasteve ka pasur një delegim të gjyqtarit të ri në procedurë, dhe për këtë arsye vonesa në punë, si dhe përgjigjet shumë të shpeshta se deri te vonesa në procedurë ka ardhur për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve që veprojnë në këtë gjykatë. Përveç kësaj, duhet theksuar bashkëpunimin e mirë dhe të drejtë të IAP me DHPGJSK në disa raste, për sa i përket marrjes së veprimeve procedurale pas ndërhyrjes së IAP dhe në këto raste lëndët e ankuesve ishin zgjidhur në kohë të shkurtër dhe të arsyeshme.<sup>48</sup>

Duke marrë parasysh numrin aktual të rasteve në pritje pranë DHPGJSK, situata e përmendur mund të konsiderohet si kritike dhe duhet seriozisht të merret parasysh nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës, kur të vendoset për domosdoshmërinë e rritjes së numrit të gjyqtarëve, si dhe dhënien e rekomandimeve EULEX-it në lidhje me kohën e mandateve të gjyqtarëve ndërkombëtarë. Në përputhje me rritjen e numrit të lëndëve të pazgjidhura dhe rritjen e vazhdueshme të rasteve në këtë gjykatë nga viti në vit, Avokati i Popullit konsideron se puna dhe joefikasiteti në zgjidhjen e lëndëve paraqet një dështim të Gjykatës për të marrë masat e duhura për të zgjidhur rastet e qytetarëve brenda një kohe të arsyeshme, dhe pret që situata do të ndryshojë për të mirë në një të ardhme të afërt.

---

<sup>46</sup>Ankesa nr.601/2015

<sup>47</sup>Ankesa 302/2012, Raporti drejtuar DHPGJSK 23.mars 2015.

<sup>48</sup>IAP lëndët: Ankesa nr. 279/2015, 272/2015, 265/2015 i 241/2015

### 1.3.7. Të drejtat lidhur me mjedisin jetësor

Mbrojtja e të drejtës për në një mjedis të shëndetshëm jetësor, ndotja e ajrit, tokës dhe ujërave, humbja e tokave bujqësore, qasja e vështirësuar e publikut në informatat mjedisore dhe pjesëmarrja e pakët e qytetarëve në vendim marrje, trajtimi pa prioritet i rasteve mjedisore nga ana e gjykatave, mos respektimi i normave bazë të ndërtimit, qasja e vështirësuar në rrugë, shkatërrimi i sipërfaqeve pyjore, mosmenaxhimi i duhur i mbeturinave, zhurma, mungesa e sistemeve të mjaftueshme monitoruese, mosbashkëpunimi i inspektorateve mjedisore të nivelit qendror dhe lokal janë problemet që e kanë përcjellë edhe vitin 2015.

Gjithashtu, çështje shqetësuese mbetet zvogëlimi i buxhetit për realizimin e obligimeve lidhur me mbrojtjen e mjedisit, ngase krahasuar me vitet paraprake buxheti i Ministrisë së Mjedisit ka pësuar rënie. Në anën tjetër, taksa ekologjike e mbledhur nga qytetarët gjatë regjistrimit të veturave ende nuk ka filluar të ndahet për fushën e mjedisit.

Gjithashtu edhe bashkëpunimi ndërinstytucional në kuptimin e shkëmbimit të informacioneve në mes të institucioneve qendrore dhe lokale sa i përket çështjeve mjedisore nuk është në nivelin e duhur.

Obligimi ligjor i shtetit për sigurimin e zhvillimit dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve ujore, si të domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit publik, mbrojtjes së mjedisit dhe për zhvillimin social-ekonomik<sup>49</sup>, ka mbetur vetëm dispozitë ligjore e pa zbatueshme.

E drejta e qytetarëve për ujë të pijshëm kualitativ, qasja në sisteme të ujësjellësit<sup>50</sup>, përmirësimi i mungesës së furnizimit me ujë, nuk ka shënuar ndonjë përmirësim të dukshëm.

Alarmuese mund të cilësohet eksplorimi i pakontrolluar dhe i pa kriter i rërës dhe zhavorrit nga lumenjtë, gërmimi i gropave shumë të thella pranë lumenjve, ndërtimi pranë lumenjve, ndërtimi i rrugëve mbi shtratin e lumenjve, etj. Lumenjtë më të eksploruar kanë vazhduar të jenë Drini i Bardhë, Lumëbardhi i Pejës, Ereniku, Desivojci, Krivareka dhe Ibri.

Vlen të theksohet se në shumicën e rasteve vërshimet dhe përmytjet janë shkaktuar jo vetëm nga eksploatimi i pa kriter i inerteve të lumenjve, por edhe për shkak të mos mirëmbajtjes së shtretërve, hedhjes së mbeturinave inerte, ndërtimit pranë shtretërve të lumenjve, etj. Ndërsa jo të rralla janë edhe vërshimet për shkak të ndërtimeve në kundërshtim me përqindjen e përcaktuar të sipërfaqes së përgjithshme të gjelbërimit për absorbim të reshjeve atmosferike në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale<sup>51</sup>, si dhe për shkak të problemeve me infrastrukturën ujore.

<sup>49</sup>Ligji Nr. 04/L-147, për Ujërat e Kosovës, neni 1.2.

<sup>50</sup> Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Raport për Gjendjen e Ujërave në Republikën e Kosovës

<sup>51</sup> Ligji Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, neni 21, paragrafi 5.8.

Ujërat e zeza dhe industriale kanë vazhduar të shkarkohen drejtpërdrejt në lumenjtë. Kjo për shkak se vetëm 60% e qytetarëve kanë qasje në rrjetin publik të ujërave të zeza. Ndërsa i vetmi impiant për trajtimin e ujërave të zeza mbetet ai në Llaushë të Skenderajt.

Avokati i Popullit vlerëson se çështja e mungesës së rrjetit të kanalizimeve përbën cenim të së drejtës në një mjedis të shëndetshëm dhe rrjedhimisht edhe të drejtës në banim për çka ai ka pranuar një numër ankesash.

E drejta e qytetarëve për mjedis të shëndetshëm ka vazhduar të cenohet edhe nga ndotja e ajrit e shkaktuar nga veprimtaritë industriale, përdorimi i mjeteve të vjetra të transportit, përdorimi i karburanteve të cilësisë së ulët, pluhuri i liruar nga ndërtimi i rrugëve dhe objekteve, ushtrimi i veprimtarive të gurthyesve dhe guroreve, djegia e hamulloreve, mosmenaxhimi i duhur i deponive, mbeturinave urbane dhe industriale.

Bazuar në raporte të organeve kompetente është regjistruar tejkalimi i parametrave të lejuara, sidomos në periudhën e dimrit. Ndotësit kryesorë kanë vazhduar të jenë KEK-u, komplekset industriale Trepça, Ferronikeli, emisionet nga ngrohtoret e Gjakovës dhe Mitrovicës.

Me gjithë shqetësimin ka një përmirësim të qasjes së qytetarëve në informata lidhur me cilësinë e ajrit, mirëpo ka nevojë për ndërmarrjen e veprimeve përkatëse për funksionalizimin e plotë të sistemit për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe shqiptimin e masave ndëshkuese apo inicimin e procedurave ligjore.

Degradimi i sipërfaqeve tokësore nga ndikimi i aktiviteteve të njeriut mbetet shqetësues. Parcializimi i tokës bujqësore, ndryshimi i pakontrolluar i destinimit të tokës nga bujqësore në ndërtimore, mosmenaxhimi i duhur i mbeturinave, deponitë e egra me mbeturina, eksploatimi i zhavorrit, erozioni i tokës, mbeten problematike edhe gjatë vitit raportues.

Ndryshimi i pa autorizuar nga organet kompetente komunale të tokës bujqësore në tokë jo bujqësore për vitin 2015, ka pësuar rënie krahasuar me vitet paraprake por nuk është ndaluar plotësisht, pasi që disa prej komunave nuk i respektojnë procedurat ligjore lidhur me ndryshimin e destinimit të tokës bujqësore-pyjore në tokë jo bujqësore-pyjore<sup>52</sup>.

Prerja e pyjeve ka vazhduar dhe janë regjistruar prerje edhe brenda parqeve kombëtare. Prerja e pyjeve rrezikon menaxhimin e qëndrueshëm të tyre si dhe erozionin e tokave.

Sa i përket menaxhimit të mbeturinave nuk janë ndërmarrë aktivitete për përpunimin e tyre, trajtimin dhe reciklimin, të cilat dukshëm do të ndihmonin përmirësimin e gjendjes me mbeturina, dhe ndikimin e tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut. Menaxhimi i duhur i mbeturinave komunale dhe inerte vazhdon të mos shënojë përmirësim madje as në mjediset urbane.

Në dy rastet e hetuara nga Avokati i Popullit, është vërejtur që organet komunale nuk kanë plane të veprimit, si dhe nuk kanë qendër për trajtimin e mbeturinave inerte dhe ndërtimore.

---

<sup>52</sup> *Informatë zyrtare e pranuar nga Ministrina e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 14 janar 2016.*

Qytetarët e Kosovës kanë vazhduar të ballafaqohen me probleme të mungesës së planifikimit racional urban të trotuareve/shtigjeve të këmbësorëve, i cili do t'u mundësonte mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. Trotuarët kanë vazhduar të ngelin me gjerësinë e pamjaftueshme në krahasim me numrin e qytetarëve, dhe shpeshherë të përcjella me lartësi larg normave të parapara, me mungesë të elementeve qasës, rampave të cilat pengojnë lidhjen pa ndërprerje në mes të niveleve të ndryshme të trotuarit, lidhjen me sipërfaqet publike pa pengesë, dhe qasjen në rrugët e qarkullimit kryesor. Pengesat e tilla, e vështirësojnë lëvizjen e qytetarëve në përgjithësi ndërsa pengojnë lëvizjen e personave me aftësi të kufizuar, në veçanti.

Jo rrallë janë vërejtur, gropat e paparashikuara, pusetat e dëmtuara, zënia e trotuareve me mallra të ekspozuara, si dhe me material ndërtimor pa asnjë masë mbrojtëse, apo shenjë paralajmërimi, të cilat pengojnë lëvizjen e sigurt të qytetarëve.

Ndërsa çështje në vete është cenimi i jetës, shëndetit dhe sigurisë së fëmijëve, që në shumë raste rrezikohet nga mungesa e rrethojave adekuate, madje edhe asaj të gjelbër, në shtigjet e këmbësorëve pranë çerdheve, kopshteve dhe shkollave.

Problematike është gjithashtu edhe mungesa e nënkalimeve dhe mbikalimeve, në rrugët magjistrale, autostradë dhe ato rajonale. Problemit i kontribuon, mos përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje, para fillimit të ndërtimit të rrugëve, e cila do të përfshinte interesat e qytetarëve, dhe do të jepte zgjedhje më efektive dhe racionale.

E drejta e qytetarëve për mjedis të shëndetshëm, dhe privatësia e tyre, kanë vazhduar të cenohen edhe nga zhurma. Përkundër përpjekjeve dhe iniciativës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për hartimin e ligjit të ri për mbrojtje nga zhurma akoma nuk është miratuar.

Edhe pse parim bazë i legjislacionit mjedisor është parimi i transparencës dhe i informimit, informimi i publikut për çështjet mjedisore mbetet sfidë. Informatat mjedisore, përkundër interesit të përgjithshëm vazhduan të mbeten në listën e informatave të kufizuara sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Statistikat për mbeturinat dhe ujin tashmë mbledhen, mirëpo statistikat për shpenzimet për mbrojtjen e mjedisit, bilancet e qarkullimit të materialeve dhe për llogaritë e emetimeve të ajrit ende nuk prodhohen. Kosovës i mungon një sistem kombëtar për raportim mjedisor. Niveli i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje nuk ka qenë në nivelin e duhur. Ministria e Mjedisit këtë vit ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ-Nr.18/2015 për Informim, Pjesëmarrje të Publikut dhe Palëve të Interesuara në Procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis me të cilin pritet që kjo gjendje të përmirësohet.

Me gjithë problemet mjedisore me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës, mbetet shqetësues fakti se gjykatat ende nuk i kushtojnë rëndësinë e duhur trajtimit të lëndëve të inicuar nga inspektoratet mjedisore, dhe qytetarët lidhur me çështjet mjedisore në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

### 1.3.8. E drejta e Qasjes në Dokumente Publike

Qarkullimi i lirë i informacionit është mjet i rëndësishëm për ndërtimin e besimit mes institucioneve dhe qytetarëve, për të krijuar transparencë të veprimeve, efikasitet dhe efektivitet të administratës publike, për ndërgjegjësim të qytetarëve dhe administratës për shërbimet e pritura përkatësisht për detyrimet për ofrimin e shërbimeve përkatëse.

Edhe pse e drejta e qasjes në dokumente publike, është e drejtë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e shkrirë dhe e konkretizuar në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), respektimi i kësaj të drejte, si dhe zbatimi i ligjit vazhdon të mbetet sfidues qoftë për shkak të paqartësive të vet ligjit, qoftë për shkak të neglizhencës së zyrtarëve përgjegjës në trajtimin e kërkesave për qasje në këtë të drejtë apo edhe për shkak të mungesës së informacioneve të mjaftueshme të qytetarëve në lidhje me këtë të drejtë.

Vazhdon të mbetet dekurajuese për qytetarët që t'i drejtohen gjykatës për të realizuar të drejtën e tyre për qasje në dokumente publike, për shkak të zvarritjes së procedurave gjyqësore. Që nga hyrja në fuqi e Ligjit e deri më tani është nxjerrë vetëm një vendim gjykate në lidhje me këtë çështje, e ngritur nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese - BIRN që i njeh atij të drejtën në qasje në dokumentet e kërkuara në lidhje me shpenzimet e bëra nga zyrtarët qeveritarë, por që ende nuk ka gjetur zbatim. Përcaktimi i Institucionit të Avokatit të Popullit si organ vetëm me fuqi rekomanduese, duket të mos jetë mjaft efektiv. Sipas ligjit, kërkuesi i dokumentit mund të fillojë procedurën edhe para gjykatës kompetente, por nuk specifikon se në cilën gjykatë dhe në cilin institucion.<sup>53</sup>

Për ta bërë të zbatueshëm këtë ligj ndryshimet janë më se të nevojshme. Në këtë drejtim Zyra e Kryeministrit ka hartuar një koncept dokument me të cilin janë identifikuar disa nga mangësitë në zbatimin e ligjit, por që plotësimi dhe ndryshimi i ligjit nuk është përfshirë në Strategjinë Legjislative të Qeverisë për vitin 2016, që do të thotë se nuk priten të bëhen ndryshime në ligj as edhe gjatë vitit 2016.

Në shumicën e vendeve të Bashkimit Evropian mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të kësaj natyre e bën Komisionari për Informim, të cilit i janë deleguar edhe përgjegjësi me fuqi ekzekutive, aplikimi i gjobave për mos respektimin e kësaj të drejte, e që duket të jetë një zgjidhje me e pranueshme.

Gjatë vitit 2015, në Institucionin e Avokatit të Popullit, lidhur me kufizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike janë pranuar 33 ankesa. Nga këto ankesa, 23 prej tyre janë pranuar për hetim, ndërsa 10 janë shpallur të papranueshme.

Ndërsa, sa i përket dokumenteve të mbajtura dhe të prodhuara nga IAP janë pranuar gjithsej 8 kërkesa.

---

<sup>53</sup>Refuzimi i kërkesës së kërkuesit, si dhe mos përgjigja e institucionit publik brenda afatit të caktuar konsiderohet si përgjigje negative dhe i jep të drejtë kërkuesit që të fillojë procedurën para Institucionit të Avokatit të Popullit, institucioneve të tjera publike, gjykatës kompetente, në përputhje me ligjin në fuqi.

### 1.3.8.1. Kufizimi i paarsyetuar i së drejtës për Qasje në Dokumente Publike

Lista e gjatë e kufizimeve e përshkruar në nenin 12<sup>54</sup>, të LQDP përbën një kufizim elastik, që i lë hapësirë relativisht të madhe për interpretim arbitrar zyrtarit përgjegjës në institucionin përkatës.

Edhe pse neni 12, paragrafi 2, i LQDP, precizon që: *Qasja në informata të përmbajtura në një dokument mund të refuzohet nëse zbulimi i tyre dëmton apo ka mundësi të dëmtojë, cilindo nga interesat e përmendura në paragrafin 1. ..., përveç nëse nuk ekziston ndonjë interes publik më i lartë për të bërë zbulimin*”, vërehet se përgjegjësit në institucionet publike nuk janë të gatshëm, për të përmbushur obligimin e tyre kushtetues, që të drejtën në fjalë t’i kufizojnë vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme për një shoqëri të hapur dhe demokratike, në mënyrë që të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi, si dhe t’i kushtohet kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet.<sup>55</sup>

Edhe pse të gjitha dokumentet që i mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë, vërehet se qasja në dokumente mbetet në vullnetin e udhëheqësve të institucioneve. Në disa raste përgjigjet e pranuar duken nga më absurdet të llojit si : për arsyen e kufizimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, l “ .... nuk jemi servis i askujt dhe nuk punojmë për teket e askujt ”<sup>56</sup>.

Me gjithë angazhimin e Avokatit të Popullit që të sqaroj pozicionin e tij dhe kompetencat e dhëna me Ligjin për Qasje në Dokumente, në disa raste nuk kuptohet drejtë roli i tij.

Edhe pse, në njërin nga përgjigjet e pranuar nga autoritetet përgjegjëse, Avokati i Popullit, është informuar se arsyeja e kufizimit ka qenë *“keqpërdorimi i dokumentacionit zyrtar”*<sup>57</sup>, e cila përgjigje ishte në përputhje me LQDP, mirëpo sipas saj dokumentet publike të pranuar nga kërkuesi nuk mund të përdoren për qëllime denigrimi, propagandistike dhe komerciale, mirëpo pa ofruar fakte që do të dëshmonin se si dhe kur janë keqpërdorur informatat. Kufizimi i së drejtës, për arsyet e lartcekura në këto raste duhet bërë duke marrë për bazë Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligjin për Klasifikim e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë, i cili ndalon klasifikimin e informacioneve për të fshehur

<sup>54</sup>Neni 12, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike. 1.1. sigurisë kombëtare, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare; 1.2. sigurisë publike; 1.3. parandalimit, hulumtimit dhe ndjekjes së aktiviteteve penale; 1.4. hulumtimeve disiplinore; 1.5. inspektimit, kontrollimit dhe mbikëqyrjes nga institucionet publike; 1.6. privatësisë dhe interesave të tjerë legjitim privat; 1.7. interesave komerciale dhe të tjera ekonomike; 1.8. politikave ekonomike, monetare dhe këmbimore të shtetit; 1.9. barazisë së palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë; 1.10. mjedisit, apo, 1.11. diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje.

<sup>55</sup>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore];

<sup>56</sup>Ankesa nr. 348/2015, A. G, kundër Komunës së Fushë Kosovës;

<sup>57</sup>Ankesa nr. 348/2015, A. G, kundër Komunës së Fushë Kosovës;

shkeljet e ligjit, abuzimin e autoritetit, mos efikasitetin apo gabimin administrativ; parandaluar turpërimin e një personi, autoriteti publik apo organizate; ndaluar konkurrencën; parandaluar apo vonuar publikimin e një informacioni i cili qartazi nuk ka të bëjë me çështje të sigurisë. Asnjëra nga këto arsye nuk u theksua në përgjigjen e pranuar.

Edhe përkundër interesit të qytetarëve për informata mjedisore, si dhe edhe pse në kundërshtim me ligjet mjedisore, parim bazë i të cilave është parimi i transparencës dhe informimit, i integruar nga konventa Aarhus, informatat mjedisore, mbeten në listën e përjashtimeve, në nenin 12, paragrafi 1.10, të LQDP. Kufizimi i informatave në fjalë, duhet bërë vetëm pjesërisht, dhe atë vetëm në masën e domosdoshme dhe atë nëse dokumentet e kërkuara përmbajnë informata që bien brenda një apo më shumë prej këtyre kategorive: sisteme, instalime, infrastruktura, projekte, plane apo shërbime të mbrojtjes që lidhen me interesat e sigurisë të Republikës së Kosovës<sup>58</sup>.

Parimi kryesor i Direktivës së Këshillit të Evropës 2003/4/CE për qasje publike në informata të mjedisit përcakton se publikimi i informatave të mjedisit do të inkurajoj vetëdijesim më të madh të qytetarëve sa i përket mbrojtjes së mjedisit. Vetëdijesimi më i madh ndihmon në rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, i bënë institucionet publike më transparente dhe llogaridhënëse duke ndërtuar mirëbesim tek publiku për institucionet. Burimi i kësaj Direktive është marrëveshja ndërkombëtare e quajtur “Konventa për Qasje në Informata, Pjesëmarrje e Publikut në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi lidhur me çështjet mjedisore”. Është miratuar në Aarhus, Danimarkë më 25 qershor 1998 dhe është e njohur si “Konventa e Aarhus”<sup>59</sup>. Nënshkruesit e kësaj Konvente janë pajtuar që të publikojnë dokumentet që përmbajnë informata mjedisore.

### ***1.3.8.2. Mos klasifikimi i dokumenteve nga institucionet dhe mos respektimi i afateve***

Edhe pse e drejtë kushtetuese, e drejta për qasje në dokumente publike megjithatë nuk është e drejtë absolute. Ajo duhet të jetë e mbrojtur në proporcion dhe duke balancuar me të drejtat tjera, pa i dëmtuar interesat tjera. Gjatë hetimit dhe shqyrtimit të rasteve, përkitazi me kufizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike, Avokati i Popullit, ka vërejtur që Institucionet shtetërore, mbajtëse, hartuese apo pranuese të informacioneve, në shumicën e rasteve nuk kanë klasifikuar me kohë dokumentet, ashtu sikurse e parashohin Ligji Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ligji Nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë.

Mos klasifikimi me kohë, rezulton me mos respektim të afateve për përgjigje me kohë, në kërkesat e qytetarëve për qasje në dokumente publike, përkundër rëndësisë së dhënies me kohë të informacioneve, pasi që vonesat në dhënien e informatës mund t’i heqin në mënyrë të pashmangshme të gjithë vlerën informatës dhe interesimin lidhur me të.

<sup>58</sup>Ligji Nr. 03/L-178 Për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë Neni 4, paragrafi 1.3.5;

<sup>59</sup><http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/documents/cep43e.pdf>

Madje, Avokati i Popullit, si zbatues i LQDP, në asnjë rast nuk ka pranuar përgjigje nga institucionet, nëpërmjet së cilës do të njoftohej se kërkesa për qasje në dokumente publike është refuzuar me arsyen se dokumenti i kërkuar është në listën e dokumenteve të klasifikuara, apo nuk i është prezantuar lista e dokumenteve të klasifikuara, në të cilën do të figuronte dokumenti i kërkuar si dokument i klasifikuar.

Në ankesën e regjistruar nr. 370/2015<sup>60</sup>, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë i refuzoi qasjen ankuesit në dokumentet e parashtruara nga kandidatët që janë pranuar, si dhe në dokumentet që janë bërë gjatë procesit të selektimit/ përzgjedhjes së fëmijëve në një institucion parashkollor, me arsyetimin se “... mund të cenohet jeta private dhe ndershmëria e individit dhe si të tilla nuk mund të ofrohen pa lejen e prindërve”, e që ishte arsyetim i bazuar në ligj, sepse qasja në dokumentet e kërkuara hyn në grupin e të dhënave personale dhe qasja në to bëhet vetëm nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin.

### ***1.3.8.3. Promovimi i të drejtës për Qasje në Dokumente Publike***

Bazuar në situatën ekzistuese dhe problemet e evidentuara lidhur me të drejtën e qasjes në dokumente publike, IAP gjatë kësaj periudhe raportuese, ka organizuar tetë punëtori në qendrat regjionale ku ndodhen zyrat rajonale të IAP-së dhe në Prishtinë. Përfaqësues të institucioneve nga pothuajse të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, të organizatave jo qeveritare që zhvillojnë aktivitetet në nivel lokal, si dhe gazetarë nga mediat lokale diskutuan për rëndësinë e rrjedhjes së lirë të informacioneve dhe qasjes në dokumente publike. Rezultoi se duhet vazhduar me aktivitete ndërgjegjëse.

### **1.3.9. Barazia para ligjit**

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ndalon diskriminimin, garanton barazinë para ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Garanton të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore pa diskriminim.<sup>61</sup>

Diskriminimi përfshinë një gamë të gjerë të bazave si: të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, sipas së cilës një individ trajtohet ndryshe nga individ/ individët tjerë që gjenden në

<sup>60</sup> Ankesa nr. 370/2015 kundër Drejtorisë Komunale të Arsimit në Prishtinë

<sup>61</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 24, faqe.7



situatë të njejtë apo të ngjashme. Për më tepër të gjitha këto baza janë të specifikuara në nenin 1 të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili ka hyrë në fuqi në korrik të këtij viti.

Zbatimi përkatës i këtij ligji duhet të bëhet nga institucionet kompetente në mënyrë që qytetarëve t'u ofrohet mbrojtja adekuate në situatat kur u janë cenuar të drejtat e tyre, përkatësisht kur janë diskriminuar. Megjithatë, mbetet mbi individët që të vendosin se si do të kërkojnë mbrojtje për rastet e diskriminimit ngase ky ligj parasheh që çështjet e diskriminimit të trajtohen në pesë procedura të ndryshme, varësisht nga rrethanat e çdo rasti. Në procedurën penale dhe kundërvajtës mund të ketë paqartësi kur për një rast mund të ngritët edhe procedura penale edhe ajo kundërvajtëse.

Ligji për kundërvajtje i vitit 1979, që ende është në fuqi, nuk përmend diskriminimin, nuk përmban dispozita materiale, Kodi Penal i Republikës së Kosovës (KPRK), gjithashtu nuk e ka paraparë diskriminimin, ndërsa Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka paraparë mundësinë e zhvillimit të procedurës penale për diskriminim. Këto janë vetëm disa shkaqe që ngrenë shqetësimin se sa do të jetë funksional dhe i zbatueshëm në praktikë Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Përveç çështjes së funksionalitetit dhe zbatueshmërisë së këtij ligji, pas analizimit të neneve të tij, mbetet të diskutohet edhe përputhshmëria e tij me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Avokatin e Popullit.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>62</sup>, Avokatin e Popullit e përcakton si mekanizmin e vetëm për barazi që do të trajtoj rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin. Neni 12.1 i këtij Ligji i jep të drejtë çdo personi ose grupi të personave që në bazën e nenit 1 të këtij ligji të parashtrajnë ankesë tek Avokati i Popullit.

Neni 12.2 i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i jep mandat Avokatit të Popullit që ankesat t'i trajtoj në përputhje me procedurat e specifikuara të ligjit përkatës për Avokatin e Popullit, kurse neni 9.2.2 i jep kompetencë që t'u ofroj asistencë viktimave të diskriminimit në bërjen e ankesave kundër diskriminimit.

Zbatimi i këtyre neneve nga Avokati i Popullit shihet si sfidues duke pas parasysh faktin se këto nene nuk janë në përputhje me njëra tjetrën dhe me legjislacionin në fuqi që e përcakton mandatin e Avokatit të Popullit.

Mandati i Avokatit të Popullit është mbikëqyrja dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike prandaj, ofrimi i asistencës viktimave të diskriminimit në bërjen e ankesave për diskriminim e tejkalon mandatin kushtetues dhe ligjor të tij.

Avokati i Popullit më 2 nëntor 2015, ka organizuar një punëtori me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), me temën "Zbatimi i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi-Procedurat dhe Autoritetet përgjegjëse - Avokati i Popullit, Gjyqësori dhe akterët e tjerë - Sfidat dhe Mundësitë", ku është diskutuar rreth sfidave në zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Pjesëmarrësit kanë konfirmuar se ky ligj do të paraqet

---

<sup>62</sup> *Shih Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 05/L-021*

sfidë të rëndë për zbatim adekuat të pjesës materiale të tij, por gjithashtu edhe e drejta procedurale në formën si është përcaktuar në ligj. Gjithashtu, ata janë pajtuar se duhet të ofrohen trajnime edhe për gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë, si dhe të punohet në sensibilizimin e publikut.

Gjatë këtij viti raportues në Institucionin e Avokatit të Popullit janë trajtuar ankesa të parashtruara, me bazë diskriminimi në lidhje me marrëdhëniet e punës. Në shumicën e rasteve ankesat kanë qenë të drejtuara kundër institucioneve publike të Kosovës. Kryesisht ato kanë pasur të bëjnë me shkëputje të marrëdhënies së punës përveç tjerash edhe për shkak të aftësisë së kufizuar, shtatzënisë, mbi bazën ekonomiko-sociale etj<sup>63</sup>.

Çështjet e Personave me Aftësi të kufizuara përfshihen në një numër të ligjeve bazike por aftësinë e kufizuar në mënyrë konkrete e rregullojnë: Ligji për Skemat Pensionale që Financohen nga Shteti nr. 04/L-131, Ligji për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme, nr.03/L-022, Ligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara nr.03/L-019, Ligji për ndërtim nr.04/L-110, Ligji për personat e verbër nr.04/L-092 si dhe Udhëzimi Administrativ për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasje të personave me aftësi të kufizuara nr.2007/33. Në muajin nëntor të 2015-tës, në Kuvendin e Kosovës ka kaluar në lexim të parë Projektligji për tetraplegjik dhe paraplegjik.

Ligji për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme parasheh që personat me aftësi të kufizuara nën moshën 18 vjeçare të kenë përkrahje materiale në vlerë prej 100 euro. Pas moshës 18 vjeçare ata trajtohen me Ligjin për Skemat Pensionale që Financohen nga Shteti, i cili nuk ka përcaktuar shkallën objektive të aftësisë së kufizuar dhe se shuma e mbështetjes financiare për këta persona është 75 euro. Pra përkundër faktit se me kalimin e kohës, me arritjen e moshës madhore, personave me aftësi të kufizuara u ndryshojnë dhe shtohen nevojat për jetesë dhe mirëqenie, atyre sipas këtij ligji u zvogëlohet mbështetja financiare për 25 euro.

Mbetet shqetësuese edhe më tej çështja e rivlerësimit të personave me aftësi të kufizuara për pensionet e personave me aftësi të kufizuara. Edhe përkundër faktit se personat me aftësi të kufizuara kanë diagnozë të njëjtë, pas rivlerësimit nga ana e komisionit mjekësor largohen nga lista e përfituesve të pensioneve, sepse sipas vlerësimit të komisionit ata nuk i plotësojnë kriteret e kërkuara. Kjo vë në pyetje korrektësinë e punës së komisionit mjekësor, sepse sipas përfaqësuesve të OJQ që punojnë për/dhe me personat me aftësi të kufizuara, komisioni mjekësor me rastin e rivlerësimit nuk i vlerëson aplikuesit sipas diagnozave të mjekëve profesionistë, por sipas perceptimit të tyre subjektiv. Sipas tyre deri më tani numri i shfrytëzuesve të pensioneve të personave me aftësi të kufizuara ka qenë 27.000, ndërsa tani është zvogëluar në 17.000.

Siç është përmendur edhe në pjesën për të drejtat e fëmijëve në fushën e arsimit, ende ka vështirësi të shumta në gjithëpërfshirje. Problem vazhdon të mbetet qasja fizike e personave

---

<sup>63</sup> Nga baza e të dhënave në IAP mes tjerash ankesat A. 630/2015, A.519/2015, A. 294/2015, A.269/2015

me aftësi të kufizuar në shkolla publike dhe sigurimi i transportit. Vetëm tri shkolla në Komunën e Prishtinës i plotësojnë kushtet për qasje të lirë të fëmijëve me aftësi të kufizuar për shkollim ndërsa objektet shkollore tjera përveç qasjes horizontale nuk i plotësojnë kushtet për qasje vertikale.

Institucionet përkatëse, mes tjerash, duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin dhe ngritjen e infrastrukturës fizike, si dhe për ndarjen e një buxheti të veçantë për sigurimin e transportit edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Avokati i Popullit gjithashtu gjatë këtij viti ka pranuar ankesë nga prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët vijojnë mësimin në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim “Përparimi” në Prishtinë<sup>64</sup>. Ankesa e prindërve është drejtuar kundër vendimit të shkollës me të cilën prindërve u është ndaluar qëndrimi në objektet shkollore, gjatë kohës sa fëmijët ndjekin mësimet, përkundër faktit që ata gjatë viteve të mëhershme kanë qëndruar në shkollë. Avokati i Popullit i është drejtuar me letër Drejtorisë së Qendrës Burimore për Mësim dhe Këshillim “Përparimi” në Prishtinë duke kërkuar informata për bazën ligjore mbi të cilën prindërit e nxënësve të Qendrës Burimore “Përparimi”, në Prishtinë, kanë qëndruar përkatësisht u është ndaluar qëndrimi në ambientet shkollore gjatë procesit mësimor, nga fillimi i vitit shkollor 2015/2016.

Më tutje, Avokati i Popullit ka kërkuar informata rreth asaj se a ka staf të mjaftueshëm profesional, psikologë, logopedë dhe ordinancë mjekësore në Qendrën Burimore “Përparimi” në Prishtinë. Drejtoria e Qendrës Burimore për Mësim dhe Këshillim “Përparimi” në nëntor të 2015-tës ka njoftuar IAP-në se ka staf të mjaftueshëm në përputhje me nevojat për përkujdesje të fëmijëve në këtë qendër dhe se prania e prindërve vetëm se e vështirëson procesin mësimor. Pas hetimeve, Avokati i Popullit ka gjetur se veprimet e qendrës në fjalë kanë qenë në pajtim me politikën dhe legjislacionin në fuqi.

Lëvizja e lirë dhe e papenguar e personave me aftësi të kufizuara vazhdon të mbetet problem edhe nëpër hapësira publike, institucione publike duke përfshirë edhe Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës. Këtë shqetësim Avokati i Popullit e ka paraqitur edhe në raportet paraprake vjetore<sup>65</sup>. Qasja e kufizuar për lëvizje mbetet problem më së shumti tek ata/ato pacientë/e me aftësi të kufizuara që mjet ndihmës për lëvizje e përdorin karrocën. Ata/ato çdo herë për lëvizje duhet të jenë të shoqëruar nga ndonjë përcjellës po jo rrallë ndodhë që edhe ndihma mjekësorë tu epet në vende jo adekuate e sidomos në kujdesin parësor shëndetësor në pamundësi që ata/ato të kenë qasje në vendet ku duhet ta pranojnë trajtimin.

Lëvizja e lirë e personave me aftësi të kufizuar është e kufizuar edhe sa i përket qasjes në objektet ku ata jetojnë. Komuna e Prishtinës nga Organizata Joqeveritare “Hendikos” ka kërkuar listën e personave me aftësi të kufizuar të cilët jetojnë nëpër banesa kolektive për të

---

<sup>64</sup> Nga baza e të dhënave në Institucionin e Avokatit të Popullit ankesa nr. A.464/2015

<sup>65</sup> Shih raportin vjetor të IAP 2014.

rregulluar infrastrukturën për qasje të lirë. Mirëpo, fatkeqësisht Komuna e Prishtinës ende nuk ka ndërmarrë veprimet përkatëse për të zgjedhur këtë çështje. Megjithatë, si hap pozitiv mund të përmendet fakti se Komuna e Prishtinës gjatë këtij viti raportues ka filluar me rregullimin e disa hapësirave publike, trotuareve në një pjesë të qendrës së qytetit për t'i përshtatur kushtet për qarkullim të lirë të personave me aftësi të kufizuara.

Ligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e Personave me aftësi të kufizuara në nenin 12 parasheh punësimin në tregun e hapur të punës.

Sipas pikës 1 të këtij ligji *“Organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik si dhe organizatat joqeveritare obligohen që, me kushtet e përshtatshme të punës ti punësojnë personat me aftësi të kufizuara”*. Pika 2 e këtij ligji përcakton se *“Çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtorë”*.

Bazuar në informatat me të cilat IAP disponon, pika 2 e nenit 12 të këtij ligji pothuajse në asnjë rast nuk është duke u zbatuar dhe asnjë person nuk është punësuar mbi bazën e këtij ligji. Personat me aftësi të kufizuara të cilët janë të punësuar kryesisht janë punësuar vetëm mbi bazën e meritave të tyre.

Sa i përket sektorit shëndetësor, personat me aftësi të kufizuara janë të liruar nga pagesa në kontrollë mjekësore, por medikamentet janë të obliguar ti sigurojnë vet me arsyetimin se në listën esenciale nuk ka mjaftueshëm medikamente për personat me aftësi të kufizuara. Lidhur me këtë çështje përfaqësues të Avokatit të Popullit kanë kontaktuar personat përgjegjës në Ministrinë e Shëndetësisë, të cilët kanë deklaruar se ka mjaftueshëm medikamente nga lista esenciale e barnave dhe se furnizimi me medikamente nga lista esenciale në institucionet publike parësore shëndetësore bëhet sipas kërkesës së vet këtyre institucioneve. Lidhur me këtë rast Avokati i Popullit është duke i zhvilluar hetimet me qëllim të vlerësimit të gjendjes reale për të rekomanduar përmirësimin e situatës në furnizim me medikamente në përgjithësi, e në veçanti me ato nga lista esenciale e barërave.

Bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin për Avokatin e Popullit dhe Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, Avokati i Popullit ushtron kompetencat e tij edhe me anë të ndërmjetësimit dhe pajtimit. Duke e vlerësuar si alternativë, jo thjesht për zgjidhjen e rasteve, por edhe për ngritjen e përgjegjshmërisë institucionale, Avokati i Popullit ka vënë në përdorim këtë mundësi ligjore dhe ka ndërmjetësuar midis z. F.R. dhe kryetarit të Komunës së Malishevës. Ankuesi i kishte parashtruar ankesë Avokatit të Popullit lidhur me deklaratën publike të kryetarit të komunës, i cili, në cilësinë e funksionit që kryen, duke aluduar në aftësitë e kufizuara në lëvizje të ankuesit është shprehur se për shkak të problemeve shëndetësore, ankuesi nuk mund ta ushtroj funksionin e nënkryetarit. Kjo deklaratë, është konsideruar diskriminuese nga ankuesi. Avokati i Popullit ka propozuar ndërmjetësimin si mekanizëm juridik për çështjen e ngritur, për të cilën janë pajtuar të dyja palët dhe pas takimit me përfaqësuesit e Avokatit të Popullit është arritur marrëveshja. Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat në të cilat ka ndodhur deklarimi dhe respektin e ndërsjellë që të dyja palët kanë shfaqur për njëra tjetrën në takimet e ndara me ta, është realizuar një

takim i përbashkët, me ç’ rast kryetari i Komunës ka shprehur keqardhje për situatën e krijuar pas deklaratës së tij, të dhënë pa qëllim diskriminimi, për të cilën gjithashtu ka bërë edhe sqarim publik. Ai ka kërkuar falje për shqetësimin e krijuar me këtë rast, gjë që është vlerësuar dhe është mirëpritur nga ankuesi si formë e satisfaksionit moral dhe është përmbyllur me një aktpajtim formal juridik. Kjo formë e zgjidhjes së rasteve është alternativë dhe jep efekte pozitive në edukimin e përgjithshëm shoqëror dhe ndikon në ngritjen e përgjegjësisë institucionale dhe individuale, në raport me trajtimin e barabartë dhe jo diskriminues, ashtu si edhe gjuhës së përdorur në deklaratimet publike.

Gjatë vizitave të realizuara në disa shkolla fillore të mesme të ulëta dhe të larta nëpër Kosovë, në kuadër të fushatës “Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit” përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit kanë pranuar një numër të ankesave, në mënyrë anonime dhe formë të shkruar nga nxënësit e këtyre shkollave.

Nga hetimet fillestare është vërejtur se ato i referohen sigurisë nëpër objektet shkollore, sigurisë në rrugë për qasje nëpër objektet shkollore, trajtimin jo të barabartë dhe cenimit të dinjitetit njerëzor nga personeli arsimor. Avokati i Popullit është në proces të shqyrtimit të tyre për të dalë pastaj me raport lidhur me shkeljet e gjetura. Bazuar në disa nga ankesat e pranuar nga nxënësit e shkollës së mesme “Hoxhë Kadri Prishtina”, në Prishtinë në kuadër të fushatës në fjalë, Institucioni i Avokatit të Popullit ka hapur hetime *ex-officio* përkitazi me shqetësimet e nxënësve lidhur me sigurinë e tyre në komunikacion për qasje të sigurt në objektet shkollore.

Sipas pohimeve të nxënësve ata janë të shqetësuar për shkak të mungesës së sigurisë në komunikacion, sepse nga autobusi urban ku ata zbresin në stacion para kazermës “Adem Jashari”, duhet kaluar rrugën me 6 korsi në njërën anë dhe në anën tjetër, rrugën me 4 korsi për të pasur qasje në objekt të shkollës.

Nxënësit pohojnë se edhe përkundër faktit që është i shënuar vendkalimi, automjetet lëvizin me shpejtësi të madhe gjë që çdo ditë u rrezikohet jeta. Ata kanë kërkuar që në këtë vend të vendosen semafor apo ndonjë kalim i sigurt. Falë ndërmjetësimit të IAP-it dhe bashkëpunimit të mirë të institucioneve përkatëse çështja është zgjedhur pozitivisht, në rrugë është vendosur vendkalimi i sigurt për këmbësorë.

### ***1.3.9.1. E drejta për mbrojtje sociale***

Në raportet paraprake të Avokatit të Popullit si rekomandim për Kuvendin e Republikës së Kosovës ka qenë përfshirja e Konventës Ndërkombëtare për të drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në Kushtetutën e Republikës së Kosovës si instrument ndërkombëtare që do të zbatohet drejtpërdrejt nga institucionet e Republikës së Kosovës, mirëpo edhe sot ky rekomandim ka mbetur i pa zbatuar<sup>66</sup>.

---

<sup>66</sup> Shih raportet paraprake të Institucionit të Avokatit të Popullit

Rastet e strehimeve sociale edhe më tej vazhdojnë të mbesin sfidë si për nivelin lokal ashtu edhe për qytetarët në nevojë. Edhe më tej janë evidente kërkesat për strehim social. Edhe këtë vit raportues nuk është vërejtur ndonjë lëvizje rreth sigurimit të strehimit social për banorët me kërkesa të tilla.

Në institucionin e Avokatit të Popullit janë duke u hetuar ankesat kundër nivelit lokal lidhur me mos sigurim të strehimit social<sup>67</sup>. Në këtë vit raportues, vlen të përmenden si sukses veprimet e ndërmarra të Komunës së Prishtinës lidhur me banorët në “Fushën e Pajtimit” ngase nga 31 dhjetor 2015, gjendja e tyre është përmirësuar. Banorët të cilët me vite kanë jetuar nëpër kontejnerë në “Fushën e Pajtimit”, këtë vit janë strehuar nga Komuna e Prishtinës, për dy vite shpenzimet për strehim u mbulohen nga Komuna e Prishtinës, deri në përfundimin e ndërtimit të banesave kolektive për këto raste. Rrjedhimisht Komuna e Prishtinës edhe këtë vit raportues nuk ka arritur të përfundoj objektet e filluara për ndërtim, për strehim të familjeve në nevojë<sup>68</sup>.

Gjithashtu në Institucionin e Avokatit të Popullit gjatë këtij viti raportues janë parashtruar ankesa kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale lidhur me ndërprerjen e ndihmave sociale. Avokati i Popullit vëren se një numër relativisht i madh i përfituesve të skemës sociale janë larguar nga lista e përfituesve gjë që duket se e ka rënduar gjendjen e tyre sociale. MPMS do të duhej të ndërtonte politika më të qëndrueshme sa i përket kësaj çështje në mënyrë që qytetarët të gëzojnë një standard minimal të jetesës.

#### **1.4. Komunitetet Pakicë**

Çështja e mbrojtjes së komuniteteve pakicë dhe të drejtave të tyre është shumë e rëndësishme, dhe rrjedhimisht IAP është marrë me këtë çështje gjatë vitit 2015. Prandaj, këtu paraqitet një analizë e situatës së përgjithshme lidhur me respektimin dhe zbatimin efektiv të të drejtave të pakicave në territorin e Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit konsideron se as gjatë kësaj periudhe raportuese, nuk ka pasur ndonjë progres të madh dhe të rëndësishëm në përmirësimin e gjendjes në të cilën janë komunitetet pakicë, edhe pse disa institucione kanë filluar, përkatësisht vazhdojnë të bëjnë progres në këtë drejtim, të tjerat ose kanë stagnuar, ose kanë injoruar çështjet dhe problemet me të cilat pjesëtarët e komuniteteve pakicë përballen çdo ditë. Përderisa, vëmendje e veçantë i kushtohet integritetit ekonomik, social dhe arsimor si dhe çështjen e strehimit të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve.

---

<sup>67</sup>Nga baza e të dhënave në IAP mes tjerash ankesat nr A.590/2015, A.523/2015, A.581/2015

<sup>68</sup>Shih raportet paraprake të Institucionit të Avokatit të Popullit

### 1.4.1. Kthimi dhe siguria

Sipas të dhënave të Komisionarit të Lartë të OKB-së për Refugjatët (UNHCR), nga nëntori i vitit 2015, prej 220 000 persona të zhvendosur nga Kosova pas përfundimit të konfliktit të vitit 1999 dhe të trazirave të marsit të vitit 2004, në Kosovë, gjithsej janë kthyer pak më shumë se 11 % (25,458 persona) persona të zhvendosur dhe refugjatë nga komunitetet pakicë.<sup>69</sup> Edhe pse IAP disa ka ngritur çështjen e zgjidhjes urgjente të çështjes së personave të zhvendosur dhe të strehuar në qendra kolektive, dhe që ende ekzistojnë 29 qendra kolektive në të gjithë Kosovën, në të cilat janë vendosur 504 persona, duke përfshirë 14 persona të cilët janë persona të zhvendosur nga veriu i Kosovës, të cilët janë të vendosur përkohësisht në Mitrovicën Jugore.<sup>70</sup> Sipas të dhënave statistikore të UNHCR-it në Kosovë në periudhën nga janari deri në nëntor të vitit 2015 janë kthyer vetëm 726 persona, pjesëtarë të komuniteteve pakicë.<sup>71</sup> Për kthim vazhdojnë të përcaktohen vetëm personat më të vjetër, ndërsa për të rinjtë ky veprim paraqet një sfidë të pasigurt, për shkak të pamundësisë së punësimit dhe perceptimit personal të sigurisë, duke mos injoruar faktin se problem i madh është edhe qasja në arsim për fëmijët dhe të rinjtë, si dhe cilësia e dobët e tij. Në mes tjerash, nuk duhet injoruar incidentet ndëretnike, të cilat në masë të madhe ndikojnë në qëndrueshmërinë e kthimit dhe interesimit të ardhshëm në kthim. Në krahasim me periudhën e kaluar raportuese ka pasur zhvillime pozitive në zbulimin e kryesve nga ana e Policisë së Kosovës, gjë të cilën Avokati i Popullit e përshëndet me këtë rast. Megjithatë, ende nuk është bërë shumë nga autoritetet qendrore dhe lokale për të dekurajuar incidente të tilla. Në këtë kontekst duhet theksuar se një numër i konsiderueshëm i incidenteve kanë ndodhur në zonat e të kthyerve, veçanërisht në gjysmën e parë të vitit 2015. Aso kohe në komunat e Klinës, Pejës dhe të Istogut ka pasur një rritje të incidenteve që përfshijnë vjedhje, hedhje gurësh, paraqitje të mesazheve të urrejtjes në objektet e Kishës Ortodokse Serbe, fyerje verbale, dëmtim të pronës, uzurpim të paligjshëm të pronës dhe frikësime. Në gusht të vitit 2015, në Prizren janë shënuar mesazhe të urrejtjes në shtëpinë e një pjesëtari të komunitetit boshnjak, të cilat ishin drejtuar kundër boshnjakëve dhe goranëve. Gjithashtu, në nëntor dhe dhjetor të vitit 2015 ka pasur një sërë incidentesh, prej të cilave disa më të rënda. Gjegjësisht, në fshatin Gorazhdevc, komuna e Pejës, ka pasur një sulm të armatosur në qendër të fshatit, me të shtëna, me ç ‘rast plumbat goditën shtëpinë në të cilën ndodhej një familje. Ky sulm u dënua publikisht nga Presidentja e Kosovës, kryetari i komunës së Pejës si dhe Ministri për Komunitete dhe Kthim. Përveç kësaj, në fshatin Gojbulja, komuna Vushtrrisë, u hodh një bombë në lokalet ku mbledhen banorët, kryesisht pjesëtarë të komunitetit serb. Incidente ndëretnike janë regjistruar edhe në komunat e Novobërdës, Parteshit dhe të Graçanicës.

<sup>69</sup>Nga viti 2000 deri në 2015 janë kthyer: 11.318 Serb, 6 Turq, 3649 Rom, 16 Malazez, 1454 Goran, 3 Kroat, 1849 Boshnjak dhe 7163 Ashkali dhe Egjiptas, Pasqyra statistikore e UNHCR-it nëntor 2015.

<sup>70</sup>Persona të zhvendosur brenda vendit në qendrat kolektive: Mitrovica e Veriut 26, Leposaviç 92, Zubin Potok 41, Zveçan 33, Mitrovica e Jugut 14, Shtërpçë 247, Graçanicë 40 dhe Obiliq 11.

<sup>71</sup>Të kthyerit në vitin 2015: 388 Serb, 3 Turq, 77 Rom, 3 Malazez, 19 Goran, 15 Boshnjak I 221 Ashkali dhe Egjiptas.

Avokati i Popullit konsideron se në lidhje me çështjen e incidenteve ndëretnike, institucionet duhet të krijojnë praktikën e dënimit publik të incidenteve të tilla në mënyrë që këto dënime publike të arrijnë si te komuniteti shumicë, ashtu dhe te popullsia e cila është prekur nga këto incidente.

#### 1.4.2. Të drejtat pronësore

Çështja e mbrojtjes së pronës dhe respektimin e të drejtave të pronësisë, në kontekstin e të drejtave pronësore të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, edhe më tutje mbetet një sfidë e madhe për autoritetet e Republikës së Kosovës. Një punë të madhe në lidhje me këtë çështje e ka bërë Agjencia Kosovare e Pronës (AKPr), e cila deri në fillim të qershorit 2015 ka zgjidhë të gjitha kërkesat e parashtruara në shkallë të parë (42,749), ndërsa ende të pa zgjidhura kanë mbetur më shumë se 500 raste të cilat ndodhen në procedurë sipas ankesës pranë Kolegjit të Apelit të AKPr-së në Gjykatën Supreme të Kosovës. IAP çështjen e punës dhe mandatit të AKPr-së e ka trajtuar në një seksion të veçantë të këtij raporti i cili lidhet me të drejtat e pronësisë në përgjithësi.

Këtu duhet theksuar problemin e shumë përhapur dhe trendin negativ të ri-uzurpimit të pronës së paluajtshme, si dhe problemet e qytetarëve që përballen me të. Problemi mund të klasifikohet si një dështim i përgjithshëm si i pushtetit ekzekutiv ashtu edhe atij gjyqësor në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Ndonëse ri-uzurpimi i pronës është një vepër penale e përcaktuar në Kodin Penal të Kosovës (neni 332 i KPK-së) dhe për të cilat parashihet një dënim me burgim deri në tre vjet, nuk ka ndonjë rast të organeve gjyqësore se kjo dispozitë është zbatuar në praktikë. Përveç kësaj, pronarët e pronave të ri-uzurpuara janë në pamundësi që të zgjidhin këtë problem, në mënyrë të përhershme, sepse pavarësisht nga paraqitja e kallëzimeve penale dhe raportimin e uzurpimit në PK, të njëjtat procedohen vite me rrallë, ndërsa PK pavarësisht kompetencave të dhëna me Ligjin e Policisë (konkretisht nenin 11.1 i Ligjit për Policinë)<sup>72</sup> refuzon për të intervenuar dhe nga personat e dëmtuar kërkon një urdhër gjyqësor për dënim për të reaguar në raste të tilla, çka për fat të keq është bërë një praktikë e përhapur në përgjithësi në PK. Gjithashtu, PK mundet në raste të tilla të ndërhyjë në bazë të kompetencave të dhëna me Kodin e Procedurës Penale (KPP), sipas të cilit PK-së i lejohet që përkohësisht të arrestojë dhe të ndalojë një person sikurse është personi i cili përsëri në mënyrë të paligjshme e merr apo e uzurpon pronën e huaj, kur kapet në kryerjen e veprës penale, do të thotë në vendin e ngjarjes.<sup>73</sup> Për këto arsye qytetarët e

---

<sup>72</sup>Neni 11.1 Ligji për Policinë nr.04/L-076 ku theksohet se: "Një polic ka autoritetin për të ushtruar kontroll të arsyeshëm mbi personat dhe pronën brenda juridiksionit dhe kompetencave të tij për të nxjerrë dhe zbatuar urdhrat e ligjshme dhe udhëzime për anëtarët e shoqërisë në tërësi për arritjen e objektivave legjitime të policisë", që do të thotë se autoriteti PK ka autoritet të përgjithshëm të hyjë në objekte për të ndaluar kryerjen e një krimi i cili po ndodhë, të tilla si uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga një palë e tretë.

<sup>73</sup>Neni 162 LPP nr.04/L-012 ku theksohet: „Nëse personi është gjetur në kryerjen e një vepre penale ndiqet sipas detyrës zyrtare ose të ndiqet penalisht, policia ose çdo person tjetër i autorizuar mundet përkohësisht të



dëmtuar janë të detyruar të ju drejtohen autoriteteve gjyqësore për të rikonfirmuar dhe vendosur, të drejtat pronësore, të cilat janë të vërtetuara dhe për të ngritur padi për pengimin e posedimit ose dëbimin e personave që janë vendosur në mënyrë të paligjshme, për të cilat presin nga disa vite deri në një vendim përfundimtar dhe të zbatueshëm të gjykatës, ndërsa gjatë kësaj kohe personat që janë vendosur në mënyrë ilegale edhe më tutje disponojnë lirshëm dhe të papenguar me pronën e tjetrit. Fatkeqësisht, këto raste ende përfaqësojnë një nga problemet më të mëdha në lidhje me gëzimin e lirë dhe disponimin e pronës private, e të cilat është e nevojshme të zgjidhen në periudhën e ardhshme. Gjithashtu, duhet theksuar se problemi i uzurpimit të serishëm të pronës së paluajshme deri para pak kohe ka prekur vetëm pjesëtarë të komuniteteve pakicë, por tani me këtë problem përballen edhe pjesëtarët e komunitetit shumicë, që po bëhet një problem i përgjithshëm me gëzimin e lirë dhe disponimin e pasurisë, e që është në kundërshtim me parimet demokratike dhe të përgjithshme të respektimit të të drejtave të njeriut. Situata në të cilën një pjesë e qytetarëve nuk është në gjendje për të disponuar lirisht pronën e tij krijon mosbesim në institucionet si dhe një klimë që justifikon ekzistencën e pasigurisë juridike.

### 1.4.3. Arsimi

Kur bëhet fjalë për sistem unik arsimor, IAP vë në dukje se nuk është bërë asnjë progres në këtë çështje. Ka ende dy sisteme të veçanta të arsimit, njëri sipas planit dhe programit të MASHT-it të Republikës së Kosovës dhe tjetri sipas programit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik të Republikës së Serbisë, për të cilën IAP ka raportuar gjatë të gjitha viteve të mëparshme. Situata është pothuajse e njëjtë si në periudhën e mëparshme raportuese. Bashkëpunimi formal mes dy sistemeve të cekura pothuajse nuk ekziston. Pjesëtarët e komuniteteve pakicë zgjedhin një nga dy sistemet e arsimit në varësi të vendit dhe lokacionit ku ata jetojnë, si dhe gjuhës të cilën e flasin. MASHT i Republikës së Kosovës siguron kurrikula për mësim në gjuhën shqipe, turke dhe boshnjake, ndërsa sistemi arsimor i Republikës së Serbisë siguron kurrikula për mësim në gjuhën serbe, ndërsa mësimi në gjuhën rome zhvillohet në disa shkolla në kuadër të të dy sistemeve të arsimit.

Pjesëtarët e komunitetit turk dhe boshnjak pohojnë se ka ende një problem me mungesën e teksteve në këto dy gjuhë, gjë të cilën edhe IAP e ka theksuar në periudhat e mëparshme raportuese. Mungesa e teksteve shkollore në veçanti prek nxënësit e shkollave të mesme, të cilët mbështeten kryesisht në tekstet e importuara nga Turqia dhe Bosnja dhe Hercegovina. Duke pasur parasysh se ky problem nuk është zgjidhur që disa vite, Avokati i Popullit konsideron se MASHT-i duhet të shqyrtoj seriozisht gjendjen e përshkruar më sipër në lidhje me tekstet shkollore dhe që problemi të zgjidhet deri në fillim të vitit të ardhshëm shkollor. Duke pasur parasysh se arsimi universitar në gjuhët e komuniteteve pakicë, është

---

*arrestojë atë person edhe pa urdhër të gjykatës, "dhe gjithashtu, neni 69. LPP i jep autonomi policisë për të hetuar veprat penale.*

po ashtu i kufizuar, një numër i studentëve të komuniteteve boshnjake dhe turke zgjedhin të ndjekin arsimin universitar në Turqi, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Serbi. Këtu duhet theksuar edhe problemin i cili ka shkaktuar vëmendjen dhe mosmiratimin e komuniteteve pakicë, që ka të bëjë me vitin akademik 2015/2016, lidhur me vendet e rezervuara për pakicat në Universitetin Shtetëror, për çka ka raportuar ECMI në raportin "Komunitetet pakicë në arsimin e lartë të Kosovës: A është keqpërdorur sistemi i rezervuar i kuotave?" Që prej 15 tetorit të vitit 2015?<sup>74</sup> Në mënyrë të veçantë, në këtë raport thuhet se gjatë këtij viti ishin të rezervuara 382 vende për studentë nga komunitetet pakicë në Universitetin Shtetëror, megjithatë, vetëm 30% nga këto vende janë plotësuar nga minoritetet, ndërsa 70% e vendeve të rezervuara janë plotësuar nga komuniteti shumicë nëpërmes keqpërdorimeve të ndryshme. Për këtë problem në mesin e muajit tetor është prononcuar edhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak se një sistem i tillë i kuotave ishte veçanërisht i përshtatshëm për anëtarët e komunitetit turk, boshnjak, rom, ashkali dhe egjiptias, në mënyrë që të sigurojë integrim më të mirë për këto komunitete, si dhe mundësi për të fituar arsimim të lartë dhe për të kontribuar në zhvillimin e komuniteteve të tyre. Deri te keqpërdorimet ka ardhur si pasojë e procesit të verifikimit dhe konstatimit të përkatësisë etnike, i cili është i dobët dhe i papërshtatshëm. Prandaj, është e nevojshme që i njëjti të ndryshohet urgjentisht dhe të futet një mekanizëm i verifikimit që do të zvogëlonte mundësitë e abuzimeve e tilla në minimum. Në këtë drejtim, ka ekzistuar një iniciativë nga Komisioni Parlamentar gjegjës për të mundësuar hapjen e një afati të tretë të regjistrimit për nxënësit e komuniteteve pakicë të cilët do të kishin mundësi që në kuadër të sistemit të kuotave të regjistrohen në këtë vit akademik por për fat të keq deri në realizimin e kësaj iniciative nuk ka ardhur.

Kur flasim për njohjen e diplomave universitare nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, mund të thuhet se në këtë drejtim ka pasur zhvillime pozitive. Me iniciativën e Zyrës për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit, është punuar për të zgjidhur këtë çështje të rëndësishme.

Me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.05/53 i datës 16 tetor 2015 është themeluar Komisioni Ndër-ministorë për Çështje të Komuniteteve, i cili është mandatuara për të shqyrtuar të gjitha çështjet që lidhen me të drejtat e komuniteteve në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, legjislacionin në fuqi dhe Strategjinë për Komunitete dhe kthim 2014-2018. Në lidhje me këtë, u formua një grup teknik i punës i cili paraqet një mekanizëm për vendimmarrje dhe një trup koordinues i punës. Duke pasur parasysh se mandati themelor i Zyrës për Çështje të Komuniteteve, është integrimi i plotë i të gjitha komuniteteve pakicë, një nga çështjet në të cilat janë të angazhuar në mënyrë aktive është zgjidhja e çështjes së diplomave nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, sepse në rrethanat e tanishme me diploma të fituara në këtë Universitet ishte e pamundur për të aplikuar për punë në institucionet e Republikës së Kosovës.

---

<sup>74</sup><http://www.ecmikosovo.org/wp-content/uploads/2015/10/Minority-Community-Students-SRB.pdf>

Për shkak të faktit se gjatë dialogut të Brukselit mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, u arrit një marrëveshje në lidhje me çështjen e njohjes reciproke të diplomave, i cili në thelb nuk është zbatuar plotësisht, dhe duke marrë parasysh se nuk ka asnjë udhëzim të shkruar për mos pranimin e diplomave nga Universiteti i Mitrovicës Veriore, ishte e nevojshme për të ndërmarrë veprime të caktuara në mënyrë që të arrihet një zgjidhje përfundimtare të kësaj çështjeje. Me iniciativën e Grupit Punues Qeveritar për Komunitete, si dhe bazuar në rekomandimet teknike të grupit punues, në lidhje me zgjidhjen e mungesës së tanishme të njohjes së diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, Qeveria e Kosovës në nëntor të vitit 2015, ka miratuar Rregulloren për verifikimin e diplomave nga viti 2001 deri në 2015, në bazë të marrëveshjes së nënshkruar për njohjen e certifikatave të arsimit dhe barazimin e kualifikimeve që do të kontribuojë në përmirësimin e procedurës së njohjes së diplomave - certifikatave të kualifikimeve arsimore dhe barazimit, dhe kështu mobilitetit më të madh të fuqisë punëtore. Njohja e diplomave është procedurë e pranimit të dokumenteve për përfundimin e arsimit, për arsye të vazhdimin të studimeve apo punësimit në Kosovë. Procedura e njohjes së diplomave fillon me kërkesë të poseduesve të dokumentit pranë Drejtorive Komunale të Arsimit. Gjatë procesit të njohjes së dokumenteve arsimore, së pari duhet të përcaktohet kohëzgjatja dhe niveli i arsimimit, kredibiliteti i dokumenteve arsimore, si dhe rrethana të tjera që janë të rëndësishme për njohje të diplomave. Afati për zgjidhjen e procesit të njohjes së diplomave është 30 ditë nga dita e aplikimit. Certifikatat arsimore të lëshuara në Republikën e Serbisë nuk do të jenë objekt i procesit të njohjes së dokumenteve, por të nostrifikimit të diplomave, në bazë të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it UA Nr.9/2015.<sup>75</sup> Në lidhje me këtë çështje IAP ka pranuar dy ankesa të cilat janë zgjidhur gjatë vitit 2015.<sup>76</sup> Megjithatë, problemi qëndron me njohjen e diplomave të universiteteve private jashtë vendit. MASHT-i nuk mund të vërtetojë (nostrifikoj) diplomat në qoftë se universitetet private nuk janë anëtarë të Agjencisë Evropiane të universiteteve private. Kosova është anëtare e kësaj agjencie, por vendet e rajonit si Bosnja dhe Hercegovina nuk janë, çka paraqet problem të madh për ata qytetarë të cilët kanë fituar një titull arsimor të lartë në këto dhe universitete të ngjashme në rajon.

#### **1.4.4. Lëvizja e lirë**

Kur flasim për lirinë e lëvizjes, situata është kryesisht më e mirë dhe në përgjithësi nuk ka probleme të mëdha në raport me periudhën e mëparshme raportuese, pavarësisht tensioneve etnike, veçanërisht në veri të Kosovës, dhe incidenteve në perëndim të vendit. Në veri të Kosovës ende janë vazhdimisht të pranishme tensionet ndëretnike, incidente, shpesh të armatosura, për të cilat në detaje ka raportuar IAP-i në raportin e kaluar vjetor. Për fat të keq, edhe pas një viti, Avokati i Popullit mund vetëm të konstatojë se situata në lidhje me

<sup>75</sup>Udhëzimi Administrativ MASHT UA nr. 9/2015 parimet dhe procedurat për njohjen e diplomave të shkollave të larta dhe profesionale dhe gradave universitare të fituara në Republikën e Serbisë nga 10 gusht 2015.

<sup>76</sup>Ankesa nr. 159/2015 dhe Ankesa nr.200/2015

këtë çështje nuk është përmirësuar aspak. Në lidhje me lirinë e lëvizjes IAP ka publikuar një raport *ex officio*<sup>77</sup> i cili ka të bëjë me ndërtimin e "Parkut të Paqes", "Sheshi Car Llazarit", "Sheshi i UÇK-së" dhe "Sheshi Adem Jashari" në Komunën e Mitrovicës veriore, e cila është trajtuar gjerësisht në pjesën që ka të bëjë me raportet e IAP.

Gjatë periudhës raportuese ka pasur një progres lidhur me zbatimin e marrëveshjes për lirinë e lëvizjes në mes të Kosovës dhe Serbisë (e cila është arritur që nga viti 2011). Qytetarët kanë mundur të lëvizin lirisht brenda Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, duke përdorur vetëm me letërnjoftime. Gjithashtu, është zbatuar deri në fund Memorandumi i sigurimit të automjeteve nga gushti 2015, sipas të cilit të gjitha automjetet me targa dhe polisa të sigurimit të Republikës së Serbisë, si dhe automjete të cilat janë siguruar në Republikën Kosovës me targa të vjetra "KS", janë të përjashtuar nga pagesa e taksave shtesë. Ky vendim i ri është përmirësuar në krahasim me vendimin e mëparshëm, për shkak se nuk paguhen taksa shtesë gjatë qarkullimit të një automjeti nga Republika e Kosovës në Republikën e Serbisë dhe anasjelltas, e që në të kaluarën nuk ishte ashtu. Megjithatë, automjetet me targa "RKS" ende nuk mund të qarkullojnë nëpër Republikën e Serbisë pa tabela të përkohshme që marrin në kalimet kufitare, për të cilat tani nuk është e nevojshme të paguhet tarifa shtesë, siç ishte më herët.

Në lidhje me lirinë e lëvizjes së qytetarëve, duhet theksuar se IAP, në fund të vitit 2015, ka regjistruar një ankesë që ka të bëjë me kufizim individual të lirisë së lëvizjes të ankuesit. Në ankesë<sup>78</sup> e cila është paraqitur në IAP është theksuar se ankuesit në pikën kufitare "Jarinje" në veri të Kosovës i është penguar lëvizja e mëtejshme pa shpjegim dhe pa bazë ligjore të kufizimit të lirisë së lëvizjes. Rasti është në fazën hetimore para IAP-it në të cilën verifikohen pretendimet e ankesës, si dhe kërkohet edhe deklaratat e palëve përgjegjëse në këtë çështje.

#### **1.4.5. Situata e komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptas**

Edhe në këtë periudhë raportuese, sikurse në të kaluarën vëmendje e veçantë i është kushtuar gjendjes së romëve, ashkali dhe egjiptas, të cilët, si në të gjitha vitet e kaluara përballen me një situatë të vështirë në të gjitha aspektet e jetës dhe shoqërisë.

Në bazë të të dhënave të marra nga vizitat në terren të IAP, në parim, gjendja e sigurisë e romëve, ashkali dhe egjiptas gjatë kësaj periudhe raportuese ka qenë e qëndrueshme, ndërsa janë regjistruar disa incidente në Gjakovë dhe Mitrovicë, ku viktimat ishin ashkali, egjiptas dhe romët. Kur flitet për aspektin socio-ekonomik, gjendja e këtyre komuniteteve vazhdon

---

<sup>77</sup>*Ex Officio 498/2014, Raporti drejtuar Kuvendit të R.Kosovës, Qeverisë së Kosovës dhe Komunës Mitrovica e Veriut, 29.05.2015.*

<sup>78</sup>*Ankesa nr. 660/2015*

të jetë e vështirë. Futja e kriterëve më të rrepta në Ligjin për Ndhimën Sociale<sup>79</sup> për familjet që marrin ndihmë sociale vetëm sa ka përkeqësuar situatën e rëndë të këtyre komuniteteve. Në këtë drejtim duhet theksuar se dispozita e kontestuar se një fëmijë mund të jetë përfitues i ndihmës sociale deri në moshën 5 vjeçare, dhe më pas kjo ndihmë ndërpritet. Për shkak të kriterëve të reja, një numër i madh i këtyre familjeve ka humbur të drejtën e ndihmës sociale, çka ndikon në rritjen e varfërisë ekstreme në mesin e romëve, ashkali dhe egjiptas. Kjo gjithashtu krijon mundësinë e diskriminimit indirekt ndaj anëtarëve të këtyre komuniteteve sa i përket miratimit të kërkesave për ndihmë sociale.

Në bazë të informatave që disponon IAP-i çështja e riatdhesimit të romëve, ashkali dhe egjiptas vazhdon, sikur në vitet e mëparshme, të jetë një temë shqetësuese. Problemi më i madh është në përkujdesjen e familjeve dhe përfshirjen e tyre në skemën e ndihmës sociale. Përveç kësaj, problemi ende ekziston me përfshirjen e fëmijëve të riatdhesuar në arsimin e rregullt. Mbështetjen e vetme këta persona e marrin nga organizatat joqeveritare të cilat ofrojnë ndihmë për personat e riatdhesuar në përfshirjen e fëmijëve në sistemin arsimor, si dhe duke siguruar informacione dhe ndihmë në lidhje me ushtrimin e të drejtave dhe marrjen e ndihmës nga institucioni kompetent.

Në këtë drejtim duhet theksuar si pozitiv faktin se për të zbatuar politika e re-integrimit është botuar një udhëzues për të ndihmuar dhe për të mbështetur re-integrimin e personave të riatdhesuar në kuptimin e riintegrit të qëndrueshëm, si dhe një manual për re-integrim të qëndrueshëm në aspektin e ofrimit të udhëzimeve për monitorimin e procedurave për riintegrim të cilin e ka hartuar dhe e ka publikuar Qeveria e Kosovës.

Lidhur me procesin e kthimit të romëve, ashkali dhe egjiptas, strehimi i përkohshëm i familjeve që i përkasin këtyre komuniteteve sigurohet nga institucionet shtetërore për një periudhë 6 mujore me mundësi vazhdimi edhe për 6 muaj tjerë. Megjithatë, pyetja është se çfarë të bëhet pas kësaj, sepse edhe pse të kthyerit kanë pasur pronën në posedim të tyre para konfliktit të armatosur në vitin 1999, shpesh nuk kanë dokumentacion për të provuar këtë, apo për shkak të perceptimit personal të sigurisë ata nuk kthehen në vendet prej të cilave kanë ikur gjatë konfliktit por vendosen në komunitat tjera, që paraqet një tjetër pengesë për arritjen e të drejtave të caktuara.

Progres i rëndësishëm është bërë në drejtim të rritjes së regjistrimit civil në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas për faktin se institucionet kompetente kanë vazhduar me praktikën që një muaj në vit për këto komunitete të ofrohen shërbime falas të regjistrimit të qytetarëve dhe të përjashtimit nga taksat që paguhen për regjistrim të vonuar për një periudhë prej një viti për të dyja shërbimet.

Megjithatë, nuk është bërë asnjë lëvizje në adresimin e përqindjes së lartë të analfabetizimit në mesin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve. Gjatë periudhës raportuese IAP ka kryer vizita në komunitat e banuara nga romët, ashkali dhe egjiptas, dhe me këtë rast edhe prindërit

---

<sup>79</sup>Ligji nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për programin e ndihmës sociale në Kosovë

edhe OJQ-të të cilat mbështesin këto komunitete kanë paraqitur një numër të madh të ankesave dhe problemeve që lidhen me arsimimin e fëmijëve të këtyre komuniteteve. Numri i nxënësve që ndjekin arsimin fillor dhe të mesëm ende nuk është i kënaqshëm, ndërsa mungon edhe mbështetje për punësim dhe mundësi të qëndrueshme të punësimit për pjesëtarët e këtyre komuniteteve. Si një nxitje për arsimim të mëtejshëm, duhet theksuar se MASHT-i në bazë të donacioneve të huaja, në bashkëpunim me OJQ-në "*Zëri i Romëve Ashkali dhe Egjiptas*" ka ndarë 500 bursa për nxënësit e shkollave të mesme nga këto komunitete, të cilat do ti vazhdojë edhe në të ardhmen. Gjithashtu, duhet të theksohet se romët, ashkali dhe egjiptas që fitojnë arsimin universitar shumë me vështirësi gjejnë punë në profesion.

Për shkak të kushteve të dobëta të jetesës mungesës së punësimit dhe mungesës së mbështetjes sociale një numër i madh i romëve, ashkali dhe egjiptas vendosin për të emigruar në shtetet e Bashkimit Evropian (BE), që është një fakt shumë shqetësues. Migrimi i këtyre komuniteteve ka çuar në një rritje të numrit të fëmijëve që kanë braktisur shkollën, e cila ishte regjistruar në pothuajse të gjitha komunat e Kosovës. Në bazë të informacioneve të marra nga terreni, arsyeja kryesore për migrimin e këtyre komuniteteve është mungesa e perspektivës, e cila është e lidhur me pamundësinë e punësimit. Përveç angazhimit të këtyre komuniteteve në punësim sezonal, autoritetet nuk kanë mundur për të krijuar mundësi të qëndrueshme të punësimit.

#### **1.4.6. Përfaqësimi gjatë punësimit në organet qendrore dhe lokale**

IAP edhe në këtë periudhë raportuese ka përcjellë situatën në lidhje me përfaqësimin e komuniteteve pakicë në punësim në organet qendrore dhe lokale. Bazuar në informacionin e Ministrisë së Administratës Publike, duke analizuar pjesëmarrjen e komuniteteve pakicë në institucione, edhe në këtë periudhë raportuese del përqindje e pamjaftueshme e përfaqësimit të tyre. Në fakt, për të folur për përfaqësimin proporcional të komuniteteve prania e tyre duhet të jenë adekuate në institucione të veçanta. Megjithatë, përfaqësimi më i madh i komuniteteve pakicë është në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, Ministrinë e Administratës dhe Pushtetit Lokal, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Punëve të Brendshme (Policia e Kosovës) dhe institucionet që direkt apo indirekt merren me çështjet e komuniteteve pakicë, dhe se përfaqësimi i komuniteteve pakicë në nivelin qendror është 8.43% nga 10% të garantuara.

Gjithashtu, duhet të theksohet se ende është një numër shumë i vogël i të punësuarve në organet e nivelit qendror të komunitetit rom (0.55%), ashkali (0.16%), egjiptas (0%), dhe goran (0.15%). Në këtë drejtim, shikuar në përgjithësi, fitohet përshtypja se situata nuk ka ndryshuar shumë në krahasim me periudhën e mëparshme raportuese. Është e qartë se dispozitat e Kushtetutës që garantojnë "përfaqësim të drejtë dhe proporcional" nga autoritetet qendrore interpretohen në kuptimin e nivelit qendror dhe jo nga ministrinë

individuale. Avokati i Popullit është i mendimit se këto dispozita duhet të interpretohen në mënyrë të tillë sikurse janë përcaktuar, që do të thotë se përfaqësimi duhet të jetë i përshtatshëm në çdo ministri dhe institucion të nivelit qendror, që të mund të flasim për përfaqësimin proporcional të komuniteteve në nivel qendror, përndryshe nuk bëhet fjalë për përfaqësim proporcional.

Në lidhje me të dhënat e mësipërme, Zyra për Çështje të Komuniteteve, pranë Kabinetit të Kryeministrit informoi IAP-in se ka kryer hulumtime lidhur me përfaqësimin aktual të komuniteteve pakicë në shërbimet publike dhe ndërmarrjet publike në Kosovë, e që kanë treguar se duhet kushtuar më shumë vëmendje dhe që investimet të përqendrohen në punësimin e këtyre komuniteteve, si dhe që ka nevojë për të futur programe të praktikës dhe zhvillimit të strategjive afatgjate në këtë fushë, për të mbështetur integrimin e komuniteteve pakicë. Në këtë drejtim, kjo zyrë, në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Norvegjisë, ka shpallur një konkurs për "programin e praktikës në institucionet publike në nivel qendror dhe lokal," për 100 studentë dhe të diplomuar nga komunitetet pakicë, për të ndihmuar në zhvillimin profesional të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve në Kosovë. Me këtë rast, IAP e përshëndet këtë si një hap pozitiv në integrimin e mëtejshëm të komuniteteve pakicë në shoqërinë kosovare.

#### **1.4.7. Përdorimi i gjuhës**

Avokati i Popullit në këtë pjesë të raportit paraqet vërejtjet e tij dhe vlerësimin lidhur me zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve<sup>80</sup> gjatë periudhës raportuese, në të cilën përveç procedurave për të vepruar sipas ankesave të qytetarëve lidhur me shkeljen e të drejtave gjuhësore, ka mbikëqyrur dhe monitoruar situatën në zbatimin dhe respektimin e të drejtave gjuhësore të komuniteteve në nivel qendror dhe lokal. Gjatë periudhës raportuese, përfaqësues të IAP-it me qëllim të vëzhgimit të tërë situatës në aplikimin dhe zbatimin e të drejtave gjuhësore, kanë pasur biseda me përfaqësues të autoriteteve përkatëse qendrore dhe lokale, gjykatat, komunitetet pakicë, etj.

Megjithëse korniza ligjore e Kosovës si Kushtetuta<sup>81</sup>, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre<sup>82</sup> si dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale<sup>83</sup>, garanton status të barabartë të gjuhës shqipe dhe asaj serbe në përdorimin zyrtarë, si në nivel qendror dhe lokal dhe siguron përdorimin e duhur të gjuhëve zyrtare dhe gjuhëve të komuniteteve të tjera në Kosovë, të cilat konsiderohen zyrtare në nivel komunal sipas kushteve të parapara me ligj, si dhe përcakton mekanizma mbrojtës për të monitoruar dhe për të siguruar mbrojtjen e të drejtave gjuhësore, kjo

<sup>80</sup>Ligji për përdorimin e gjuhëve nr. 02/L-37

<sup>81</sup>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 5, neni .58 dhe neni 59.

<sup>82</sup>Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre nr .03/L-047, čl.4.1.

<sup>83</sup>Ligji për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040

padyschim ende nuk është e mjaftueshme dhe nuk ofron zbatim adekuat të tyre me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes së identitetit gjuhësor të komuniteteve.

Edhe pse nga viti në vit vërehen ndryshime të caktuara në këtë drejtim, ende është një rrugë e gjatë deri në respektim të plotë të kornizës ligjore që ka të bëjë me të drejtat gjuhësore. Duke analizuar situatën aktuale, është evidente se problemet me zbatimin e përdorimit të barabartë të gjuhëve zyrtare, janë ende të pranishme edhe pas gati një dekade që nga miratimi i Ligjit për Gjuhët, dhe se ende nuk është siguruar plotësisht përdorimi i barabartë zyrtar i gjuhëve.

Kur flasim për nivelin qendror, si në vitet e kaluara, ende në fokus është problemi rreth procesit dhe cilësisë së përkthimit të ligjeve në gjuhët zyrtare, për të cilin Avokati i Popullit, për vite, vazhdimisht e ka paraqitur në raportet e tij vjetore. Shkaqet e këtyre problemeve nuk janë eliminuar edhe gjatë vitit 2015. Praktika e përkthimit të dobët të ligjeve dhe mospërputhjeve të mëdha në mes të versioneve të ndryshme gjuhësore të ligjeve është ende e pranishme. Duke marrë parasysh statusin e barabartë të gjuhëve zyrtare, kjo praktikë çon në pasiguri ligjore dhe shkel parimin e barazisë para ligjit dhe parimin e mos-diskriminimit, pasi korniza ligjore përcakton se të gjitha versionet e ligjit për gjuhët zyrtare, shqip dhe serbisht, janë njëloj të obligueshme. Prandaj, në procesin e hartimit të legjisllacionit, është absolutisht thelbësore të sigurohet si përdorimi i barabartë i gjuhëve zyrtare në procesin legjisllativ ashtu dhe besueshmëria e plotë e versioneve të ndryshme gjuhësore të legjisllacionit si dhe kualiteti i lartë gjuhësor që nga fazat fillestare deri në botimin në Gazetën Zyrtare.

Avokati i Popullit është i mendimit se dispozitat që rregullojnë përkthimin e projektligjeve dhe akteve nënligjore nuk janë mjaft të qarta dhe duhet të qartësohen më tej, pasi kjo çështje pengon përfshirjen e komuniteteve në procesin legjisllativ. Kjo procedurë nuk është e kënaqshme as në nivelin qendror as në atë lokal. Ky është shpesh rasti edhe me cilësinë e dokumenteve të përkthyer në gjuhën turke dhe boshnjake, të cilat janë gjuhët zyrtare ose gjuhët në përdorim zyrtar në shumë komuna të Kosovës.

Çështjet kyçe të identifikuara të praktikave të tilla janë të njëjta për vite me rrallë dhe nuk vërehet progres në zgjidhjen e tyre. Edhe më tutje kemi burime të kufizuara financiare, teknike dhe njerëzore të shërbimeve gjuhësore, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal; mungesa e përkthyesve profesional, gjuha amtare e të cilëve është gjuha serbe; mungesa e lektorëve për gjuhën serbe; afati i shkurtër për përkthim; ngarkesa të mëdha në shërbimet e përkthimit; mungesa e lektorimit dhe korrigjimit qoftë i legjisllacionit primar ashtu dhe sekondar; vështirësi në punësimin e profesionistëve të kualifikuar në çështjet e gjuhës si dhe mekanizma joadekuat për të siguruar cilësinë e gjuhës para miratimit të akteve ligjore.

Rrjedhimisht, Avokati i Popullit është i mendimit se këto fakte tregojnë për nevojën e futjes së praktikave të kontrollit gjegjësisht të lektorimit sistematik dhe korrigjimi i përkthimit të legjisllacionit në nivel të institucioneve legjisllative, me qëllim të zbulimit në kohë dhe eliminimit të gabimeve në përkthim në krahasim me tekstin origjinal, për të parandaluar mospërputhjet në versionet në gjuhë të ndryshme, përpara se akti ligjor të miratohet dhe



publikohet. Është e nevojshme që ky lloj i kontrolleve të kryhet nga ekspertë të gjuhës për tekste ligjore, të cilët e njohin gramatikën, drejtshkrimin dhe normat gjuhësore.

Si përparim në përdorimin e gjuhëve zyrtare në nivel qendror, duhet të theksohet se Ministria e Punëve të Brendshme në korrik të vitit 2015 ka futur një softver të ri që lejon komunat të lëshojë një dokument nga sistemi amë i të dhënave dhe formularë në gjuhën boshnjake dhe turke dhe në gjuhën serbe në shkrimin cirilik.

Në bazë të monitorimit të të drejtave gjuhësore në nivelin lokal Avokati i Popullit vjen në përfundimin se problemet janë pak a shumë të njëjta si në vitet e mëparshme ndonëse ka ndonjë përmirësim në ofrimin e përkthimit gjatë seancave të kuvendeve komunale, në komunat multietnike, përkthimi me gojë dhe me shkrim në të gjitha gjuhët zyrtare vazhdon të jetë një problem për shkak të numrit të pamjaftueshëm të përkthyesve dhe cilësisë së dobët e përkthimeve, duke përfshirë mungesën e shërbimet komunale me ç' rast dokumentet e lëshuara nuk janë në gjuhën e tyre.

Mbishkrimet në gjuhët zyrtare, të cilat paraqesin emrat zyrtarë të institucioneve komunale ende respektohen pjesërisht, gjithashtu ende është e pranishme praktika që brenda objektit emrat e shërbimeve komunale janë të shkruara vetëm në një gjuhë, dhe se njoftimet dhe shpalljet në tabelën për njoftime jepen vetëm në gjuhën e komunitetit shumicë në komunat përkatëse. Ka një përparim të rëndësishëm në ngritjen e tabelave me emrat e komunave, fshatrave, rrugëve dhe rrugëve komunale në gjuhët zyrtare, por mbishkrimet e shkruara gabimisht dhe dëmtimi apo shkatërrimi i shenjave edhe më tutje paraqesin problem.

Kërkimet e Komisionerit të Gjuhëve në vitin 2015<sup>84</sup> kanë konstatuar se më shumë se një e treta e komunave nuk i përkthejnë draft - rregulloret dhe legjislacionin e aprovuar në gjuhët zyrtare.

Sa i përket ueb faqeve zyrtare të komunave, asnjëra prej tyre as gjatë kësaj periudhe raportuese nuk ka kryer harmonizimin në përputhje me ligjin, pavarësisht nga rekomandimet e Avokatit të Popullit të paraqitura tre vjet më parë në raportin e tij *ex-officio*<sup>85</sup> në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare në ueb faqen zyrtare të komunave.

Avokati i Popullit konsideron se Qeveria e Kosovës duhet të marrë masat e duhura për të siguruar zbatim të plotë, të barabartë dhe kualitativ të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në të gjitha komunat e Kosovës, që është thelbësore për ruajtjen e statusit të barabartë për të gjitha gjuhët zyrtare si dhe të sigurojë të drejta të barabarta të gjuhëve të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Gjithashtu, në kontekstin e rolit të saj mbikëqyrës, MAPL duhet të shtojë monitorimin dhe sigurimin e qasjes së të gjitha akteve komunale në të gjitha gjuhët zyrtare të komunave të caktuara dhe të ofroj këshilla dhe udhëzime për komunat në lidhje me përgjegjësitë e tyre për të aplikuar statusin e njëjtë dhe përdorimin e barabartë të gjuhëve zyrtare në punën e tyre, si dhe MAP, në bashkëpunim me komunat duhet të sigurojë dhe

---

<sup>84</sup>Raporti i Zyrës së Komisionerit për Gjuhët "Monitorimi dhe vlerësimi i të drejtave gjuhësore në Kosovë", mars 2015

<sup>85</sup>Ankesa nr.275/2012

monitorojë që ueb faqet komunale të përmbajnë informacionet në të gjitha gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur asnjë progres të dukshëm në punën e Qeverisë, në lidhje me rekomandimin e Avokatit të Popullit të dhënë në raportet vjetore të të mëhershme, i cili i referohet ngritjes së vetëdijes për rëndësinë e krijimit të kushteve dhe klimës së favorshme për mësimin e gjuhëve zyrtare dhe futja e tyre në sistemin e arsimit në Kosovë. Kjo tashmë paraqet vështirësi të mëdha kurse në të ardhmen e afërt kjo do të krijojë vështirësi të pakapërcyeshme në zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

Avokati i Popullit thekson se kjo çështje nuk duhet të vazhdojë të injorohet dhe të shtyhet dhe se sistemi arsimor i Kosovës duhet të inkurajoj përafrimet gjuhësore dhe rithekson se çështja e gjuhës është absolutisht thelbësore për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve në Kosovë, sepse ajo ndikon në të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe është e rëndësishë së veçantë për komunitetet. Gjithashtu respektimi i politikave të gjuhës dhe të drejtat gjuhësore, si një nga parimet e një shoqërie demokratike kanë një rol të rëndësishëm në procesin e integritimit evropian.

Edhe pse në vitin 2012, Qeveria e Kosovës në zbatimin e reformave të politikave gjuhësore, si një mekanizëm që do të sigurojë mbrojtjen e të drejtave gjuhësore, ka themeluar Zyrën e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ) me staf të përherëshëm dhe burime financiare, ajo nuk ofron mbështetje të mjaftueshme politike në zbatimin e mandatit të Komisionerit. Gjatë periudhës së raportimit, vërehet angazhimi dhe vendosmëria e ZKGJ-së, në ushtrimin e mandatit të besuar dhe në vendosjen e praktikave më të mira të cilat do të jenë të qëndrueshme në përdorimin e plotë të gjuhëve zyrtare dhe alfabetin të tyre, në përputhje me Ligjin. ZKGJ në mars të vitit 2015, paraqiti hulumtimin për respektimin e të drejtave gjuhësore në Kosovë, përmes një raporti gjithëpërfshirës ku paraqiten gjetjet kryesore në zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në Kosovë. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij në fund të periudhës raportuese kanë mbajtur dy takime me Komisionerin për Gjuhët në lidhje me ankesat që qytetarët kanë paraqitur në IAP, që kanë lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë dhe implementimin e Ligjit për Gjuhët dhe për mënyrën e bashkëpunimit në këtë fushë.

Gjatë periudhës së raportimit, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, në krahasim me vitin e kaluar, janë parashtruar një numër më i vogël i ankesave lidhur me shkeljen e të drejtave gjuhësore. Avokati i Popullit konsideron se pavarësisht nga numri i vogël i ankesave lidhur me të drejtat gjuhësore, nuk mund të interpretohet se përdorimi i gjuhës është në një nivel të kënaqshëm, por anëtarët e komunitetit ende janë të njoftuar shumë pak në lidhje me të drejtat e tyre gjuhësore.

Ankesa e parashtruara Avokatit të Popullit kanë të bëjnë me shkelje të së drejtës për përdorimin e gjuhës serbe në procedurat para organeve kompetente, në lidhje me të cilat Avokati i Popullit, pas kryerjes së hetimeve në rastet individuale në bazë të fakteve relevante ka gjetur se ka mosrespektim të ligjit dhe shkelje të së drejtës për përdorimin e

gjuhëve (për më shumë informacion shih raportin kundër MPB IAP nr. 290 / 2015 në pjesën që ka të bëjë me raportet e rasteve të IAP).<sup>86</sup>

Në rastin e dytë kundër Doganës së Kosovës Avokati i Popullit i ka dërguar letër me rekomandim organit kompetent<sup>87</sup> që ka të bëjë me shkelje të të drejtave të ankuesit në përdorimin e gjuhës serbe, në aspektin e shkeljes së Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Avokati i Popullit në letër theksoi se Dogana e Kosovës në procedurë për kundërvajtje doganore, ishte i detyruar të respektojë përdorimin e gjuhës, të cilën personi përgjegjës në proces e kupton, sepse çdo sjellje tjetër paraqet shkelje të drejtpërdrejtë të së drejtës për përdorim të gjuhës së palës në procedurë. Sipas kuptimit të këtyre dispozitave të Ligjit, Avokati i Popullit rekomandoi se është e nevojshme që Dogana e Kosovës, gjatë kryerjes së çfarëdo autorizimi në zbatimin e legjislacionit doganor, të sigurojnë respektimin e të drejtave gjuhësore të palëve në procedurë, si dhe, në rastin konkret, të gjitha aktet në proces të ja dorëzojë personit përgjegjës në gjuhën serbe.

Në të dy rastet, palët janë përgjigjur brenda afatit të caktuar për pranimin dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

## **1.5. Të Drejtat e Fëmijëve**

Më 14 janar 2015, Qeveria e Republikës së Kosovës kishte miratuar programin legjislativ për vitin 2015, me të cilën kishte përcaktuar listën e ligjeve që do të nxirreshin dhe të atyre që do të ndryshoheshin dhe plotësoheshin për të rregulluar fusha të caktuara shoqërore. Në kuadër të këtij programi ishte paraparë edhe hartimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, i cili sipas këtij programi do të përfundonte më 30 tetor 2015, i cili konsiderohej si një nga prioritetet e Qeverisë.

Hartimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijës kishte qenë pjesë e programeve legjislative qeveritare që nga viti 2013. Si duket do të mbetet pjesë e programit legjislativ edhe për vitin 2016. Deri kah fundi i nëntorit ai nuk është finalizuar për t'u përcjell për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Zvarritja e hartimit dhe miratimit të tij lënë për të konsideruar se pohimet e përfaqësuesve qeveritar se hartimi i tij përbën një nga prioritetet e qeverisë në krijimin e një kornize përkatëse ligjore, është vetëm deklarativ. Institucionet përkatëse shtetërore do të duhej me seriozitet dhe përkushtim më të madh të ndërmarrin veprimet e nevojshme që procesi i hartimit dhe miratimit të tij të bëhet pa vonesa të mëtejme. Në relacion me këtë do të duhej të vazhdohet edhe me procesin e hartimit dhe të miratimit më të shpejtë edhe të strategjisë dhe planit të veprimit për të drejtat e Fëmijëve 2016-2020. Prosesi i hartimit të këtyre dokumenteve është filluar pas vlerësimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve (2009 - 2013), të përfunduar nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) në pjesën e parë të vitit 2015.

<sup>86</sup>Raporti IAP nr.290/2015, i dt. 25.11.2015.

<sup>87</sup>Letër me rekomandim A. Nr. 67/2015, 16 shkurt 2015,

Nuk ka dyshim se miratimi i ligjit në fjalë dhe dokumenteve të tjera përkatëse do të lehtësojnë dhe plotësojnë kornizën ligjore për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në Kosovë. Mirëpo hartimi dhe miratimi i ligjeve, përfshirë këtu edhe atë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, nuk është i mjaftueshëm nëse ligjet nuk zbatohen në mënyrë adekuate, zbatohen pjesërisht apo nuk zbatohen fare. Realizimi praktik i të drejtave të fëmijëve, mbrojtja dhe respektimi i tyre, mbeten sfida për institucionet e Kosovës. Institucionet e Kosovës duhet të bashkërendisin dhe shtojnë përpjekjet dhe veprimet në drejtim të respektimit, mbrojtjes dhe zbatimit përkatës të të drejtave të fëmijëve përfshirë këtu edhe ndarjen e buxhetit të mjaftueshëm për mbrojtjen dhe promovimin e tyre në gjithë nivelet. Qeveria e Republikës së Kosovës realisht duhet t'i vë ato në ballë të agjendës së saj të punës.

### **1.5.1. Ankesat e parashtruara lidhur me të drejtat e fëmijëve**

IAP gjatë këtij viti raportues ka pranuar 33 ankesa, të parashtruara kryesisht nga prindër të fëmijëve. Nga ky numër, 22 janë pranuar për t'u hetuar, ndërsa të tjerat janë shpallur të papranueshme, ngase çështjet me të cilat kanë pasur të bëjnë ato kanë qenë jashtë juridiksionit të IAP-it, nuk ka shkelje të drejtave të njeriut, apo ankuesit kanë pasur mundësi t'i shfrytëzojnë ose kanë qenë në shfrytëzim të mjeteve juridike.

### **1.5.2. Të drejtat e fëmijëve në procedurat pranë organeve administrative dhe gjyqësore**

IAP edhe gjatë kësaj periudhe të raportimit, ka pranuar një numër të ankesave, kundër gjykatave që kanë të bëjnë me zvarritje të procedurës gjyqësore, lidhur me kompensim dëmi për lëndimet e pësuar në aksident komunikacioni, i nevojshëm për trajtim dhe shërim të fëmijës së aksidentuar,<sup>88</sup> lidhur me kërkesën për njohjen e së drejtës për përkrahje materiale, familjeve që në përkujdesje kanë fëmijë me aftësi të kufizuar të përhershme,<sup>89</sup> si dhe për moszbatim të vendimeve të plotfuqishme, lidhur me mosrealizimin e kontakteve personale të fëmijëve me prindin.<sup>90</sup> Lidhur me mosrealizimin e kontakteve apo pamundësinë e realizimit të kontakteve të rregullta me fëmijë,<sup>91</sup> IAP ka pranuar ankesa edhe kundër qendrave për punë sociale.

Në të dy situatat, IAP u është drejtuar institucioneve përkatëse duke kërkuar nga to ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme, në mënyrë që fëmijët të mund t'i realizojnë të drejtat e tyre, të garantuara edhe me Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Gjykatat

---

<sup>88</sup>IAP, rasti A. nr. 284/2014.

<sup>89</sup>IAP, rasti A. nr. 231/2015.

<sup>90</sup>IAP, rasti A. nr. 156/2015.

<sup>91</sup>IAP, rasti A. nr. 180/2015.

përkatësisht qendrat për punë sociale do të duhej të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme që rastet që kanë të bëjnë me fëmijë apo prekin të drejtat e fëmijëve të vendosen pa vonesa, brenda afateve të përcaktuara ligjore, në mënyrë që të mos dëmtohet apo rrezikohet shëndeti i fëmijëve, mirëqenia apo edhe jeta e tyre. Ato gjithashtu do të duhej të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme që interesi më i mirë i fëmijëve të jetë parësor gjatë punës së tyre, përfshirë këtu edhe punën në çështjet që kanë të bëjnë me besimin e fëmijëve, apo me realizimin/mosrealizimin e kontaktit të fëmijëve me prindin.

### **1.5.3. E drejta e fëmijëve për shkollim**

Ofrimi i arsimit cilësor për të gjithë, përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim, sigurimi i infrastrukturës përkatëse shkollore, si dhe parandalimi dhe luftimi i dhunës në shkolla, mbeten qëllime për realizimin e të cilave kërkohet angazhim i vazhdueshëm i institucioneve të Republikës së Kosovës.

Nga numri i ankesave të pranuar që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve tetë nga to i referohen të drejtës për arsimim. Në dy nga këto ankesa, pas përfundimit të hetimeve, është konstatuar se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut, dy të tjera janë zgjidhur sipas kërkesës së ankuesve dhe të tjerat janë duke u hetuar.

Nga ankesat e pranuar një i referohet çështjes së sigurimit të transportit, për të vijuar mësimet në shkollë për fëmijët e një lagjeje të Prishtinës, prindërit e se cilëve për shkak të rrugës së papërshtatshme dhe të pasigurt, mendonin që tu ndërprerin shkollimin. Me ndërmjetësimin e IAP-it, dhe me përkushtimin e autoriteteve komunale këtyre nxënësve u është siguruar transporti dhe ata vazhdojnë shkollimin. Sigurimi i transportit ishte problematik edhe vitin e kaluar, edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara. Edhe sivjet IAP-i ka ndërmjetësuar tek autoritetet përkatëse komunale, përkatësisht të komunës së Gjakovës, që të kryhet pagesat e shpenzimeve të transportit në rastin e një nxënësi me aftësi të kufizuara, i cili kishte ndjekur mësimet në shkollën përkatëse në Prizren.<sup>92</sup>

Gjithashtu, lidhur me gëzimin e së drejtës për arsimim pa pengesa, përkitazi me vështirësitë dhe rreziqet nga automjetet me rastin e kalimit të rrugës për në shkollë, për fëmijë të disa shkollave të mesme të larta në kryeqytet, IAP-i ka filluar hetime *ex-officio*.<sup>93</sup> Në bashkëpunim me institucione relevante ka kërkuar që gjendja e sigurisë në komunikacion të vlerësohet dhe të ndërmerren veprimet përkatëse që fëmijëve t'u ofrohet qasje e sigurt në objektet shkollore.

---

<sup>92</sup>IAP, rasti A.nr.118/2015

<sup>93</sup>IAP, rasti A. nr. 577/2015.

#### 1.5.4. Të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara

Gjendja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Kosovë është shumë e rëndë. Mungesa e transportit për të ndjekur mësimin nuk është e vetmja barrierë me të cilën përballen ata. Nga ankesat e hetuara gjatë viteve dhe informatat e siguruara nga përfaqësues të institucioneve dhe organizatave joqeveritare<sup>94</sup> del se ata përballen me vështirësi dhe barrierë të shumta në të gjitha fushat e jetës.

Në fushën e arsimit, përkatësisht, në shkollë përballen edhe me infrastrukturë joadekuate shkollore, mungesë të asistentëve personal, mësuesve mbështetës e shumë herë edhe të planeve individuale arsimore, gjë që u mohon atyre gëzimin e plotë të së drejtës për arsim cilësor, gjithëpërfshirës, ashtu si është përcaktuar me ligj.

Në fushën e shëndetësisë hasin në vështirësi edhe sa i përket realizimit të së drejtës për shërbime shëndetësore cilësore dhe pa pagesë ngase jo gjithëherë kanë mundësi të sigurojnë barnat falas dhe pajisje të tjera që do u mundësonin përmirësimin e shëndetit, lëvizjen e lirë dhe jetë me dinjitet.

Përfshirja e tyre dhe sigurimi i shërbimeve sociale në komunitet gjithashtu është i mangët. Ka mungesë të qendrave ditore ku ata do të mund të trajtoheshin, ndihmoheshin apo ri-integroheshin si pjesë e barabartë e shoqërisë. Me qëllim të përmirësimit të gjendjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat e jetës institucionet përkatëse kompetente do të duhej të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme përfshirë këtu edhe mbështetje materiale dhe ndarjen e buxhetit përkatës që ata t'i gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre, në pajtim edhe me Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF).<sup>95</sup>

#### 1.5.5. Dhuna dhe gjendja e sigurisë në shkollë

Dhuna mbetet e pranishme në shkollat publike të Kosovës. Nga informatat me të cilat posedon IAP del se numri i rasteve të raportuara në Policinë e Kosovës<sup>96</sup> nuk ka ndryshuar shumë krahasuar me vitin e kaluar përveç faktit se gjatë këtij viti, fatmirësisht, nuk kanë ndodhur incidente që kanë përfunduar tragjikisht me humbjen e jetës së nxënësve, si viteve të kaluara.

---

<sup>94</sup> *Informatat e siguruara nga përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe jo shtetërorë, në tryezën e rrumbullakët, të mbajtur më 3 dhjetor 2015, lidhur me gjendjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.*

<sup>95</sup> *Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) është një nga aktet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare në fushën e të drejtave të fëmijëve e cila zbatohet drejtpërdrejt nga institucionet e Kosovës sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*

<sup>96</sup> *Informatat e siguruara përveç tjerash, nga përfaqësuesi i Policisë së Kosovës në konferencën “Çka ka bërë apo duhet të bëjë shteti në mbrojtjen e fëmijëve” e organizuar nga OJQ “Syri i Vizionit” në bashkëpunim me Save the Children e mbajtur më 22 tetor 2015 në Prishtinë.*

Nuk është përmirësuar dukshëm gjendja e mbrojtjes dhe sigurisë në shkolla me gjithë përpjekjet e bëra nga MASHT-i. Edhe këtë vit MASHT-i në partneritet me Zyrën për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit dhe Qendrën Kosovare për Arsim, në kuadër të detyrimeve për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, ka vazhduar aktivitetet informuese lidhur me zbatimin e Protokollit për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar, nr. 21/2013.<sup>97</sup>

Edhe fëmijët, nxënës të shkollave të mesme të ulëta dhe të mesme të larta në takimet me përfaqësuesit e IAP-it janë shprehur se janë të pakënaqur me situatën e sigurisë në shkollat e tyre, përdorimin e dhunës nga arsimtarë të caktuar në shkollat e tyre, por edhe me faktin se rrugës për në shkollë dhe anasjelltas rrezikohen nga qentë endacakë, si dhe nga makinat që lëvizin me shpejtësi të madhe. Të dhënat e mbledhura nga përfaqësues të disa shkollave të vizituara, të Kosovës tregojnë gjithashtu për nevojën që të vazhdohet me aktivitete informuese, ngase del se shumë përfaqësues të këtyre shkollave nuk janë në dijeni për rolin dhe përgjegjësitë e tyre në parandalimin dhe referimin e rasteve të dhunës në institucionet parauniversitare. Këtë gjë e konfirmojnë edhe hetimet e zhvilluara nga IAP-i lidhur me një rast të abuzimit të një fëmije. Është më se e domosdoshme që institucionet e Kosovës të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme që fëmijëve t'u ofrohet mbrojtje dhe siguri adekuate jo vetëm në ambientet shkollore por edhe rrugës për në shkollë dhe anasjelltas. Aq më tepër në rastet kur dyshohet se fëmijët mund të kenë qenë viktimat e dhunës dhe keqtrajtimit, duhet të ndërmerren të gjitha veprimet që ndaj kryesve të mundshëm, të zhvillohen procedurat disiplinore përkatësisht procedurat përkatëse gjyqësore. Fëmijët kanë të drejtë të rriten pa dhunë.

#### **1.5.6. E drejta shëndetësore e fëmijëve**

Realizimi i drejtave të fëmijëve, pozita dhe mirëqenia e tyre është e kushtëzuar edhe me situatën e përgjithshme sociale dhe ekonomike të vendit, e cila është e rëndë për shumicën e qytetarëve të Kosovës, një pjesë e të cilëve jeton në varfëri. Nga varfëria nuk janë të kursyer as fëmijët, një numër i tyre përballen me varfëri e rrjedhimisht edhe me probleme që lidhen me mirëqenien dhe shëndetin. Në sektorin e shëndetësisë ka mungesë të shërbimeve shëndetësore dhe të trajtimit adekuat shëndetësor, gjë që u cenon atyre të drejtat për shërbime cilësore shëndetësore. Sektori shëndetësor është një nga sektorët më pak të financuar në Republikën e Kosovës, gjë që ndikon jo vetëm në mosdhënien e shërbimeve kualitative por edhe në shtyrjen e zbatimit të reformave institucionale dhe ligjore, të

---

<sup>97</sup> Në kuadër të detyrimeve për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës, Qeveria e Republikës së Kosovës, më 6 shtator 2013, ka miratuar Rregulloren QRK - nr. 21/20013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar. Me këtë protokoll janë përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve edukativo-arsimore dhe institucioneve të tjera në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve në institucionet parauniversitare. Gjithashtu, protokollin përcakton edhe procedurat për adresimin e dhunës ndaj fëmijëve në institucionet e arsimit para-universitar.

miratuara nga Qeveria e Kosovës. Qytetarët bartin shpenzime të larta për shërim, konsiderohet se ato përfshijnë diku 40-60% të shërbimeve shëndetësore. Më së shumti dëmtohen qytetarët e varfër dhe grupet tjera të cënueshme, si fëmijët. Përkundër faktit se sipas legjislacionit në fuqi të gjitha shërbimet shëndetësore për fëmijë janë pa pagesë, në praktikë kjo nuk ndodhë. Pacientët, familjarët e fëmijëve kur flasim për fëmijët, në shumicën e rasteve detyrohen të heqin shpenzimet e furnizimit me barna apo material mjekësor, që në shumicën e rasteve mungojnë në spitale, dhe të vuajnë pasojat e mosdhënies së shërbimeve dhe ndihmës përkatëse mjekësore. Lidhur me cenimin e kësaj të drejte Avokati i Popullit *ex-officio* ka hetuar edhe rastin e publikuar në shkrimet e gazetave ditore, "Kosova Sot" dhe "Koha Ditore", përkitazi me pretendimet për neglizhencë të personelit Gjinekologjik në QKUK në rastin e lindjes së foshnjës, në korridorin e Klinikës Gjinekologjike.

Një gjendje e tillë në sektorin shëndetësor vazhdon të dëmtoj përmbushjen e nevojave bazë për shëndet të mirë për nëna dhe fëmijë, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin në fuqi. Qeveria e Kosovës, përveç tjerash, përmes mekanizmave përgjegjës për institucionet shëndetësore publike, duhet të bëjë furnizimin me medikamente nga lista esenciale e barnave si dhe me material tjetër të nevojshëm gjatë gjithë kohës, të shtojë kontrollin në institucionet shëndetësore të të gjitha niveleve në mënyrë që fëmijëve, përveç të tjerëve, t'u mos u mohohet e drejta për kujdes adekuat shëndetësor.

### **1.5.7. Fëmijët në situatë rruge**

Siç e kemi përmendur edhe më lart ekzistimi i kornizës ligjore nuk është i mjaftueshëm nëse ligjet përkatëse nuk zbatohen në mënyrë adekuate dhe mjaftueshëm. S'ka dyshim se edhe sa i përket çështjes së fëmijëve në situatë rruge, ekziston legjislacioni përkatës, janë krijuar mekanizma përkatës, janë hartuar plane dhe dokumente të ndryshme për të parandaluar punët e rënda të fëmijëve si kërkim lëmshën, trafikimin e fëmijëve etj. Institucionet flasin për punën e kryer në këtë aspekt.<sup>98</sup> Mirëpo, fatkeqësisht sikur të tëra këto vihen në pikëpyetje ngase çdo ditë nëpër rrugët e qyteteve tona shohim fëmijë që punojnë punë që rrezikojnë shëndetin e tyre, fëmijë që mbledhin kanaçe nëpër kontejnerë, fëmijë që pastrojnë xhamat e automjeteve, fëmijë që shesin çamçakëz dhe gjësende tjera në rrugë dhe kafene, pra edhe fëmijë që kërkojnë lëmshë. Aq më tepër nga i tërë ky vëzhgim i përditshëm krijohet përshtypja se numri i fëmijëve që punojnë po rritet, gjë që ngritë shqetësimin nëse është duke u bërë mjaftueshëm për këta fëmijë. Prandaj, pavarësisht të gjithave, institucionet e Kosovës duhet të shtojnë përpjekjet dhe të ndërmarrin veprimet përkatëse që këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre, varësisht nga nevojat, rrethanat dhe gjendja e tyre reale, tu

---

<sup>98</sup>Informatat e siguruar përveç tjerash, nga përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe jo shtetërore, në konferencën rajonale për fëmijët në situatë rruge, të organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, në bashkëpunim me Terre des Hommes dhe Policinë e Kosovës, e mbajtur më 14 tetor 2015 në Prishtinë.



jepet përkrahja dhe ndihma adekuate, përfshirë këtu edhe atë materiale që ata të jetojnë fëmijërinë, të jetojnë një jetë të dinjitetshme.

Pra mbrojtja e fëmijëve, përmirësimi i jetës së tyre duhet të bëhet me një angazhim maksimal të institucioneve shtetërore dhe akterëve të tjerë që punojnë në këtë drejtim, por edhe me angazhimin e tërë shoqërisë kosovare në përgjithësi.

## **1.6. Liria e besimit në Kosovë**

Pozita juridike e bashkësive fetare në Kosovë edhe gjatë vitit 2015 mbetet e parregulluar, për shkak se ende nuk është miratuar Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Liritë Fetare në Kosovë, edhe pse miratimi i këtij ligji ishte planifikuar me Programin legjislativ të Qeverisë së Kosovës për vitin 2015. Çështjen e domosdoshmërisë së miratimit të këtij ligji, Institucioni i Avokatit të Popullit e ka ngritur edhe në raportet e tij vjetore për vitin 2012, 2013 dhe 2014.<sup>99</sup>

Një nga problemet që e kanë theksuar komunitetet fetare në vitet e fundit është çështja e kthimit të pronës së bashkësive fetare, të cilat në dekadat e fundit, me procesin e shtetëzimit ose shpronësimit janë tjetërsuar, të cilat tani i nënshtrohen procesit të privatizimit. Korniza ligjore lidhur me privatizimin është miratuar në mungesë të një ligji për restituim të pronave.

Vitin 2015 e karakterizon një bashkëpunim i mirë ndërfaqetor i të gjitha komuniteteve fetare në Kosovë. Në Prishtinë nga data 27 deri më 30 maj 2015 është mbajtur konferenca e katërt ndërfaqetore ndërkombëtare, në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve fetare në Kosovë, e cila kishte për qëllim përmirësimin e dialogut ndërfaqetor global.

Si sfidë e veçantë e cila e ka përcjellë BIK vazhdon të mbetet mungesa e dispozitave ligjore që e rregullojnë regjistrimin e bashkësive fetare. Ligji për Liritë Fetare i vitit 2006 nuk përmban pjesë të dispozitave të cilat e rregullojnë regjistrimin e bashkësive fetare në Kosovë. Del se bashkësitë tjera fetare në Kosovë konsiderohen si degë të bashkësive fetare të regjistruara jashtë territorit të Kosovës, BIK që konsiderohet të jetë bashkësi autonome brenda Kosovës është në pamundësi që të regjistrohet si bashkësi në mungesë të dispozitave të lartpërmendura. Mungesa e regjistrimit si person juridik sjell vështirësi praktike si ato lidhur me çështjet pronësore, menaxhimit të pasurisë, donacioneve etj.

Derisa ushtrimi i lirive fetare të besimit islam përkatësisht bartja e shamisë në Kosovë vazhdon të mbetet temë e debateve mediale, nuk ka pasur ndonjë nismë për trajtim meritore të kësaj çështjeje, përkundër opinioneve të Institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me të njëjtën.

---

<sup>99</sup>IAP, *Raporti Vjetor për vitin 2012 fq. 40, për vitin 2013 fq. 63 dhe për vitin 2014 fq. 57.*

Shkas i debateve kanë qenë në vazhdimësi dispozitat e ligjeve sekondare të cilat lënë hapësirë të gjerë të interpretimeve derisa standardet ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejtë në Kosovë, e theksojnë se çështja e ushtrimit të kësaj të drejte është në kuadrin e të drejtave diskrecionale të shteteve në kuptimin e Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Gjegjësisht e vetmja kërkesë e këtyre standardeve është që kjo çështje të rregullohet me ligj. Prandaj për të ofruar siguri juridike lidhur me çështjen e lartpërmendur është e nevojshme që Kuvendi i Kosovës përmes përfaqësuesve të popullit të shprehin vullnetin e shumicës duke nxjerrë ligj të veçantë dhe i cili do të ofronte përgjigje të përshtatshme për evitimin e debateve të deritanishme.

Problemet e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë gjatë vitit 2015 ishin të një natyre të ngjashme sikurse në vitet e mëparshme. Në mesin e problemeve më të theksuara është mungesa e ligjeve për rregullimin e pozitës juridike të bashkësive fetare, dhe problemi i dëmtimit të objekteve fetare të KOS. Megjithatë, në krahasim me vitin e kaluar, numri i këtyre ngjarjeve dhe dëmeve të shkaktuara është zvogëluar.

Megjithatë, duhet theksuar se Tempulli i Krishtit Shpëtimtar në qendër të Prishtinës është përdorur për të kryer ushtrime alpinistike më 15 qershor 2015 e që është plotësisht në kundërshtim me qëllimin e tempullit dhe fyen ndjenjat e besimtarëve.<sup>100</sup> Në fshatin Dresnik në komunën e Klinës më 14 korrik 2015 ishte thyer Kisha Shën Petka, ku janë marrë paratë dhe janë përdhosur ikonat. Në fshatin Bablak, komuna e Ferizajit më 8 shtator 2015 kishte tentativë vjedhje të kishës së Trinisë së Shenjtë. Në Rahovec më 15 tetor 2015 u gjuajt me gurë porta e Kishës së Zonjës. Kisha e Lindjes së Virgjëreshës në fshatin Softoviq në komunën e Ferizajt dhe Kisha Shën Elias në Kaçanik, janë thyer më 29 tetor 2015, por përveç derës dhe dritareve të thyera nuk është shkaktuar dëm më i madh material. Një lëvizje pozitive është vizita e besimtarëve të KOS me rastin e shënimit të ritit fetar “Zadushnice” më 7 dhjetor 2015 në varrezat dhe kishën lokale në Gjakovë e cila kaloi pa incidente, por me një prani të fortë të PK. Janë evidentuar rastet e kërcënimeve dhe frikësimit të murgeshave dhe priftërinjve të KOS (kërcënimet telefonike drejtuar murgeshave në manastirin Gorioc të Komunës së Istogut, si dhe kërcënimet priftërinjve të KOS-it në Istog dhe Prishtinë), hedhja e gurëve në famulli, si dhe përpjekjet për të parandaluar shkuarjen për lutje në objektet fetare (Gjakovë, Pejë, Rahovec, Vushtrri, Mushtisht).

Edhe për Ipeshkvinë e Kosovës, çështja më e rëndësishme është miratimi i një ligji të ri për liritë fetare dhe zhvillimi i bashkëpunimit të dialogut ndër fetar. Duhet theksuar se ka pasur kërkesa të shqiptarëve të besimit katolik në komunën e Prishtinës për të zgjerim dhe përcaktim të kufijve për varrezat katolike, por deri më tani nuk ka pasur përgjigje nga komuna për të përmbushur këto kërkesa. Gjithashtu, duhet të përmendim mosmarrëveshjet ndërmjet banorëve të fshatit Llapushnik, komuna e Drenasit rreth fillimit të ndërtimit të

---

<sup>100</sup>Ministria për Komunitete dhe Kthim, 15 qershor 2015, <http://www.mkk-ks.org/?page=3,12,865>, qasur më 9.12.2015

kishës dhe varrezave katolike në tokën të cilën Komuna e Drenasit e kishte ndarë për këtë qëllim. Gjatë kontaktit me zyrtarët e Ispeshkvisë së Kosovës kemi marrë informata se kjo çështje pritet të zgjidhet së shpejti.

Mos rregullimi i pozitës juridike të bashkësive fetare gjatë vitit 2015 është po ashtu një nga problemet kryesore të Kishës Protestante në Kosovë. Si problemi më i madh me të cilin përballen pjesëtarët e kësaj bashkësie fetare është mungesa e një parcele për varreza në qytet dhe vende ku jetojnë anëtarët e Kishës Protestante, si dhe mos marrja e një parcele dhe lejes për ndërtimin e Kishës Protestante në Prishtinë.

Disa vjet më parë, nga 3 deri në 10 dhjetor mbahet manifestimi "Java Hebraike" që zhvillohet në mjedise të veçanta dhe të ndryshme përmes manifestimit të trashëgimisë kulturore të popullit hebre në Kosovë. Komuniteti hebraik në Kosovë është i pakët, por shumë aktiv në dialogun ndërfaqor. Një ndryshim pozitiv këtë vit është shënimi i festës hebraike fetare Hanukkah.

## **1.7. Barazia Gjinore**

Barazia gjinore e nënkupton parimin e barazisë para ligjit për njerëz të gjinive të ndryshme. Arritja e barazisë gjinore është një nga objektivat kryesore dhe është prioritet për zhvillimin e çdo shoqërie demokratike, në të cilën të gjithë anëtarët e saj do të trajtohen në mënyrë të barabartë, në të gjitha situatat pa diskriminim. Gjithashtu, barazia gjinore është parakusht themelor i demokracisë për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të bazuar në gjini.

Koncepti i diskriminimit në bazë të gjinisë do të thotë dallim në trajtim, përjashtim apo kufizim në bazë të gjinisë, që me atë rast rrezikon apo parandalon gëzimin ose ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në shoqëri, politikë, kulturë apo fusha tjera. Çfarëdo dallimi në trajtim është diskriminues vetëm atëherë kur nuk ka ndonjë arsye të objektive apo të bazuar.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e garanton të drejtën e mbrojtjes ligjore pa diskriminim dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit, pa marrë parasysh gjininë, gjuhën, përkatësinë etnike, politike, religjioze, kulturore, statusin ekonomik, orientimin seksual apo ndonjë status tjetër të qytetarëve.<sup>101</sup>

Edhe pse Republika e Kosovës në vitin 2004 ka miratuar Ligjin për Barazi Gjinore, gjatë zbatimit të tij është hasur në probleme të ndryshme. Në vitin 2015, pas procesit të plotësimit dhe ndryshimit të këtij ligji, ka hyrë në fuqi Ligji për Barazi Gjinore nr.05/L-020. Po ashtu, ka hyrë në fuqi edhe Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr.05/L-021 dhe Ligji për Avokatin e Popullit nr.05/L-019.

---

<sup>101</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 3 dhe neni 24.

Për shkak të statusit të saj, Republika e Kosovës nuk është nënshkruese e instrumenteve ndërkombëtare siç është Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas (CEDAW). Kushtetuta e Kosovës obligon të gjithë institucionet në Kosovë që të zbatojnë instrumentet për të drejtat e njeriut, përfshirë këtu edhe Konventën mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas, e cila ka përparësi zbatimi në raport me të drejtën e brendshme juridike.

### **1.7.1. Ligji për Barazi Gjinore nr.05/L-020**

Qëllimi i përgjithshëm i Ligjit për Barazi Gjinore nr.05/L-020 është promovimi dhe sigurimi i barazisë së grave dhe burrave dhe garantimi i mundësive të barabarta në të gjitha fushat e jetës. Ligji i ri përcakton parime të reja udhëheqëse si harmonizimi gjinor, buxhetimi i përgjegjshëm gjinor dhe identiteti gjinor. Ai gjithashtu jep një përkufizim gjithëpërfshirës të diskriminimit gjinor.

Në Ligjin për Barazi Gjinore është korrigjuar deri në një masë paqartësia e ligjit paraprak për ndarjen e kompetencave, organeve të ndryshme. Sipas këtij ligji institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Agjencia për Barazi Gjinore i cili bën hartimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, siguron harmonizimin gjinor dhe buxhetimin gjinor. Ndërsa IAP tani është organi kompetent jo gjyqësor që menaxhon rastet e diskriminimit gjinor. Neni 13 i Ligjit për Barazi Gjinore përcakton Avokatin e Popullit si institucion të barazisë i cili trajton rastet që lidhen me diskriminimin gjinor në përputhje me procedurat e parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit. Ndërsa në nivel të ministrive dhe komunave ky ligj i përcakton zyrtarët për barazi gjinore si akterë kryesor për sigurimin e zbatimit të ligjit në fjalë.

Gjithashtu, me Ligjin e ri për Barazi Gjinore është zbatuar edhe rekomandimi i Avokatit të Popullit, i dhënë në raportet vjetore të mëparshme, me të cilin është kërkuar mbrojtja juridike dhe përcaktimi i organit kompetent (administrativ dhe gjyqësor) për trajtimin e rasteve të diskriminimit në bazë të gjinisë. Ky rekomandim është zbatuar me Nenin 22 të Ligjit për Barazi Gjinore, ku theksohet se lidhur me mbrojtjen juridike të së drejtës së trajtimit të barabartë të femrave dhe meshkujve, personat të cilët konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, mund të iniciojnë procedurën dhe të paraqesin provat, para organit administrativ apo Gjykatës kompetente në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.<sup>102</sup>

### **1.7.2. E drejta në punë**

---

<sup>102</sup>Ligji për Barazi Gjinore nr.05/L-020, Neni 22

Niveli i lartë i papunësisë, rolet tradicionale gjinore, faktorët ekonomik në Republikën e Kosovës i vështirësojnë mundësitë e gjinisë femërore për të konkurruar në tregun e punës. Për barazinë gjinore është shumë e rëndësishme pozita e gruas në tregun e punës. Më të mëdha janë gjasat që të punësohen burrat, posaçërisht për pozita të larta, edhe në rastet kur ka kandidatë gra me kualifikime të njëjta. Në eliminimin e pabarazisë ndërmjet grave dhe burrave rol të rëndësishëm luajnë parashikimi i masave të posaçme në legjislacion, më saktësisht përcaktimi i kuotës për gjininë më pak të përfaqësuar, që ka për qëllim eliminimin e diskriminimit gjinor. Me Ligjin e mëparshëm për Barazi Gjinore përfaqësimi i pabarabartë ka ekzistuar atëherë kur përfaqësimi i njërës gjini ka qenë më i ulët se 40%. Me Ligjin e ri për Barazi Gjinore, kuota gjinore është rritur në 50%. Kuota e përfaqësimit, në thelb fillimisht mundëson krijimin e kulturës së pjesëmarrjes së barabartë të grave e burrave e cila pas një intervali kohor do të zëvendësohet me konkurrencën reale. Aspektet të tjera të diskriminimit në fushën e punës paraqesin edhe largimet joligjore të grave nga puna, pengimet e përparimit në punë dhe mos dhënia e mundësive për aftësim profesional dhe avancimi në punësim..

Duhet të theksohet se ka raste kur diskriminimi fillon që me rastin e shpalljes së konkurseve për vende të punës ku një nga kriteret për punësim përcaktohet gjinia.

E tërë kjo flet shumë qartë se ende ka shumë punë për tu bërë që sistemi juridik me mekanizmat e ndërtuar mbrojtës të fuqizohet në parandalimin dhe ndaljen e diskriminimit në fushën e punës dhe punësimi.

### **1.7.3. E drejta e pronës dhe trashëgimisë**

Një tjetër pengesë për jetën e pavarur të shumë grave në Republikën e Kosovës është edhe fakti që ato në të shumtën e rasteve nuk posedojnë ndonjë pronë private apo patundshmëri. Ligjet në fuqi u japin grave dhe burrave të drejta të barabarta në lidhje me trashëgiminë e pronës, mirëpo zakonisht në Kosovë prona familjare trashëgohet nga burrat. Kjo dukuri është më shumë e shprehur në zonat rurale.

Mohimi i pronës për gratë, arsimimi i pamjaftueshëm, dhe përparësia e anëtarëve meshkuj të familjes për tu shkolluar janë tipare të së drejtës zakonore e cila në një masë vazhdon të ketë ndikim në shoqërinë kosovare. Në mesin e rasteve kur gratë kanë kërkuar një pjesë të pronës familjare ka pasur raste kur ato janë kërcënuar nga bashkëshortët apo burrat tjerë të familjes.<sup>103</sup>

Sa i përket pozitës së gruas në shoqërinë tonë, ende ka dallime të konsiderueshme mes zonave rurale dhe urbane. Në zonat rurale, për shkak të traditave dhe zakoneve, pozita

---

<sup>103</sup> Ankesa është e ripërsëritur për monitorimin gjyqësor në vitin 2015. Parashtruesja ka përsëritur të njëjtën ankesë sepse axha i saj e pamundësoi që të bëhet pronare e shtëpisë të cilën baba i saj ka ndërtuar në oborrin e përbashkët familjar. Procedura është duke u zhvilluar në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

sociale e gruas është më pak e favorshme, jo e barabartë me atë të burrit dhe shoqëria është shumë pak e vetëdijshme për konceptin e barazisë gjinore. Në zonat urbane shoqëria është më e vetëdijshme për çështjet gjinore ndonëse ende jo në nivelin e kënaqshëm.

#### **1.7.4. E drejta për mbrojtjen shëndetësore**

Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas (CEDAW) në nenin 12, njih të drejtën për sigurim shëndetësor. Kjo nënkupton obligimin pozitiv të shteteve që të ndërmarrin veprimet me qëllim të eliminimit të gjitha formave të diskriminimit sa i përket sigurimit shëndetësor. Konventa CEDAW, sipas Kushtetutës ka prioritet ndaj ligjeve të brendshme. Avokati i Popullit në raportet vjetore në vazhdimësi ka rekomanduar miratimin e Ligjit për Mbrojtje Shëndetësore dhe Sigurinë Sociale<sup>104</sup> por ky rekomandim ende nuk është zbatuar. Pa marrë parasysh arsyetimet e Qeverisë së Kosovës, mosekzistimi i këtij ligji përbën një ndër shkeljet më të rënda të të drejtave të njeriut në Kosovë. Zbatimi i këtij ligji në masë të konsiderueshme do të sigurojë financimin e shëndetësisë dhe përmirësimin e kualitetit të shërbimeve.

Një prej rasteve të cilat janë hetuar në IAP lidhur me të drejtën shëndetësore ishte edhe rasti i hapur *ex officio* nga Avokati i Popullit, sipas artikullit në njërin nga gazetatat ditore më 9 mars 2015. Rasti ka të bëjë me pretendimet për neglizhencën e personelit të Klinikës së Gjinekologjisë në QKUK, ku sipas deklaratës së ankueses ajo ka lindur foshnjën e saj në korridorin e kësaj klinike, pa mundur të arrijë tek salla e lindjeve. Pas hetimit të rastit nga ana e Avokatit të Popullit është konstatuar se Klinika e Gjinekologjisë ka ndërmarrë të gjitha veprimet për ndëshkimin e personelit i cili ka qenë i përfshirë në rastin e ankueses.<sup>105</sup>

#### **1.7.5. Dhuna në familje**

Dhuna në familje është e pranishme në shoqërinë kosovare. Ajo paraqet shkelje të të drejtave të njeriut, është bazë e diskriminimit të grave dhe gjithashtu vazhdon të jetë problem i madh i të gjitha komuniteteve në Kosovë. Vetëm një numër i vogël i tyre i raportohet autoriteteve kompetente. Në rastet e raportuara, reagimi dhe veprimet e organeve kompetente vazhdojnë të mos jenë në nivelin e duhur. Në të shumtën e rasteve gratë mbeten viktima jo vetëm të dhunës së ushtruar nga bashkëshortët, por edhe të vet mosveprimeve dhe neglizhencës së institucioneve që për mandat kanë ofrimin e mbrojtjes dhe ndihmës atyre. Lidhur me mosndërmarrjen e veprimeve të nevojshme, për mbrojtje nga dhuna në familje nga institucionet përkatëse, IAP më 3 nëntor 2015, ka filluar hetimet *ex officio*,

<sup>104</sup>Raporti i dhjetë vjetor të IAP-it, Raporti i njëmbëdhjetë vjetor i IAP-it, Raporti i dymbëdhjetë vjetor, Raporti i trembëdhjetë vjetor, Raporti i katërbëdhjetë vjetor i IAP-it, Barazia gjinore

<sup>105</sup>Rasti A.nr.104/2015

bazuar në artikullin e gazetës „Koha Ditore”, sipas së cilit një grua është privuar nga jeta nga ana e bashkëshortit të saj edhe pse ajo para ngjarjes disa herë e ka denoncuar dhunën në institucionet përgjegjëse.<sup>106</sup>

Faktorë të ndryshëm social, ekonomik dhe kulturor kanë ndikuar që niveli i dhunës në Kosovë të mbetet i pandryshueshëm. Papunësia dhe varfëria nuk arsyetojnë dhunën në familje. Një ndër problemet kryesore që e vështirëson pozitën e viktimave është varësia ekonomike, por gjithashtu edhe faktori social ka shumë rëndësi në rastet e dhunës familjare.

Pengesë për paraqitjen e rastit është edhe presioni dhe paragjykimet shoqërore ku dhuna në familje shihet si turp dhe si çështje private e cila nuk duhet të paraqitet jashtë rrethit familjar.

IAP shumë herë ka monitoruar proceset gjyqësore ku viktimat e dhunës kanë kërkuar ndihmë dhe monitorim të këtyre proceseve pranë gjykatave.

Edhe pse ekziston një bazë solide ligjore për mbrojtjen nga dhuna në familje, duhet theksuar se zbatimi i ligjit nuk është në nivelin e duhur. Vlen të theksohet se zvarritja e procedurave gjyqësore në rastet e trajtimit të rasteve që kanë të bëjnë me dhunën në familje është mjaft dekurajuese që raste e tilla të paraqiten.

#### **1.7.6. Gratë të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës**

Gratë të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës janë një kategori e cila nuk ka qenë e trajtuar ligjërisht nga ana e shoqërisë kosovare. Në Republikën e Kosovës është polemizuar shumë për këtë pjesë të shoqërisë. Po ashtu, fare pak ose hiç nuk diskutohet rreth të mbijetuarve burra të dhunës seksuale gjatë luftës.

Në raportin e mëparshëm Avokati i Popullit ka kërkuar jo vetëm përkrahjen ligjore por edhe mbështetje financiare dhe shëndetësore për viktimat e dhunës gjatë luftës.

Grave viktima të luftës në Kosovë, duhet t’u sigurohet përkrahja institucionale dhe infrastrukturë përkatëse ligjore, me fokus të veçantë në heqjen e paragjykimeve për këtë pjesë të shoqërisë. Shoqëria kosovare duhet të angazhohet më shumë në zhvillimin, edukimin, arsimimin dhe emancipimin e tyre me qëllim që t’u jepet atyre më shumë mundësi për dinjitet dhe prosperitet. Edhe pse Kuvendi i Kosovës, më 20 mars 2014, ka miratuar Ligjin Nr.04/L-172 për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/1-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre lidhur me dëmshpërblimin e viktimave të dhunës seksuale, ende nuk është punuar shumë në zbatimin e këtij ligji, nga institucionet përgjegjëse.

---

<sup>106</sup> Rasti A.nr.533/2015

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke mbështetur sundimin e ligjit në Kosovë gjithashtu mbështet edhe çështjen e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, që të gëzojnë të drejtat e tyre si viktima civile të luftës. Lidhur me këtë çështjen në IAP është regjistruar rasti i parashtruar nga ana e viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës.<sup>107</sup>

### **1.7.7. Pozita e popullatës LGBT në Kosovë**

Anëtarët e popullatës LGBT në Kosovë edhe më tutje përfaqësojë një nga komunitetet më të rrezikuara. Të drejtat e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve janë ende në nivel të ulët, edhe pse tanimë ekziston një bazë solide ligjore për mbrojtjen e tyre.

Problemet me të cilat është ballafaquar popullata LGBT gjatë vitit 2015 janë të njëjta si në vitet e mëparshme. Refuzimi, stigmatizimi dhe paragjykimet të cilave ata u ekspozohen në shoqëri dhe brenda familjeve të tyre, pamundësia për t'u mbledhur lirshëm, për të shprehur pikëpamjet e tyre dhe prania e vazhdueshme e frikës nga reagimi i mjedisit janë pjesë e jetës së përditshme të popullatës LGBT në Kosovë. Institucioni i Avokatit të Popullit, edhe pse ka vendosur kontakte me përfaqësues të organizatave që merren me çështjet e popullatës LGBT dhe inkurajon anëtarët e komunitetit për të raportuar rastet e shkeljes së të drejtave me të cilat ata ballafaqohen, gjatë vitit 2015 ka pranuar vetëm një ankesë të këtij lloji.<sup>108</sup>

Vlen të theksohet se popullata LGBT në Kosovë mund të kërkojë mbështetje edhe nga Zyra për Qeverisje të Mirë, si dhe Grupit Këshillues, i cili shërben si një mekanizëm për koordinimin dhe këshillimin e institucioneve në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të popullatës LGBT.

Gjatë vitit 2015, ishte shumë i rëndësishëm zbatimi i projektit EU TWINING i cili si objektiva bazë kishte punën dhe monitorimin e miratimit të ligjeve të reja për mbrojtjen e të drejtave të personave LGBT, rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të popullatës për gjendjen e tyre, si dhe këshillimin e tyre psikologjik dhe fuqizimin, si dhe ndërlidhjen e organizatave të ndryshme që mund të kontribuojnë në mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT.

Gjithashtu, me miratimin e pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut synohet avancimi i të drejtave të popullatës LGTB. Ligji për Barazinë Gjinore në nenin 14.3, në mënyrë shumë të qartë ndalon shfaqjen publike të çdo individi në mënyrë ofenduese, përçmuese apo poshtëruese sa i përket gjinisë apo orientimit seksual<sup>109</sup>, me çka sigurohet mundësia për të sanksionuar personat që në çfarëdo mënyre ofendojnë personat LGBT në bazë të orientimit të tyre seksual.

Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur një sërë aktiviteteve me qëllim të promovimit të të drejtave të personave LGBT. Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Kabinetit të Kryeministrit, në

---

<sup>107</sup> Rasti A.nr 27/2015

<sup>108</sup> Rasti A.nr.529/2015

<sup>109</sup> Ligji për Barazi Gjinore, neni 14.3



bashkëpunim me OJQ-të të cilat merren me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të LGBT, më 17 maj 2015 për të shënuar Ditën Ndërkombëtare kundër homofobisë dhe transfobisë në Kosovë, organizoi një konferencë me temë "Realizimi i të drejtave të komunitetit LGBT në Kosovë"<sup>110</sup>. Po ashtu, me të njëjtin rast, më 17 maj 2015, në qendër të Prishtinës është mbajtur një shëtitje e komunitetit LGBT, si dhe atyre që mbështesin orientimin e tyre seksual.

Në kuadër të projektit EU TWINING "Normally different" u mbajt trajnimi për 15 persona nga institucione të ndryshme shtetërore të cilët janë të specializuar për nxitjen e promovimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë.

Edukimi i popullatës për ekzistimin e të drejtave të minoriteteve seksuale është një nga problemet kryesore në Kosovë, pasi që në përgjithësi nuk ka as informim elementar të qytetarëve për ekzistimin e të drejtave të personave LGBT. Arsimimi jo vetëm që do të pengonte përhapjen e të gjitha keqkuptimeve të pranishme dhe paragjytimeve ndaj këtij grupi njerëzish, por është një nga parakushtet themelore për pranimin dhe përfshirjen në komunitet dhe në shoqëri në përgjithësi të këtij grupi të izoluar minoritar. Suksesi i integritimit të tyre në shoqëri do të përfaqësoj pa dyshim suksesin jo vetëm të vendit por edhe të shoqërisë e cila personat e tillë mund t'i pranojë ashtu si janë, por për fat të keq në Kosovë ende nuk është rasti ashtu.

## **1.8. Ndalimi i Torturës**

### **1.8.1. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT)**

Me ligjin e ri për Avokatin e Popullit, për herë të parë është bërë njohja ligjore e Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, si një strukturë e veçantë pranë Avokatit të Popullit. Në përputhje me këtë dhe ashtu siç e parasheh Ligji, me vendim të veçant Avokati i Popullit në kuadër të Institucionit të Avokati të Popullit themeloi Mekanizmin Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Qëllimi i veprimtarisë së MKPT është zbatimi i vizitave të rregullta në të gjitha hapësirat e institucioneve publike ku liria e individit është e kufizuar. Problemet e identifikuar gjatë monitorimeve do të përcillen me raporte periodike kombëtare dhe ndërkombëtare, në mënyrë që të promovohet respektimi i vazhdueshëm dhe përmirësimi i standardeve të trajtimit të personave të privuar nga liria. Gjithashtu, do të promovohet përmirësimi i standardeve të trajnimit të personelit që shërben në këto institucione.

---

<sup>110</sup> Konferenca e dates 17 maj 2015 me temen Normally Different

Institucioni i Avokatit të Popullit duke qenë një institucion i pavarur me mandat mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut do të ishte autoriteti që do të garantonte më së miri funksionimin profesional dhe të pavarur të detyrimeve të MKPT, siç parasheh OPCAT-i.

Gjatë veprimtarisë së tyre, MKPT do të bashkëpunojë dhe koordinojë veprimet e tyre me departamentet e tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Duke qenë se roli dhe aktiviteti i MKPT është shumë i rëndësishëm Avokati i Popullit në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) dhe Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ), të cilët edhe kanë vepruar si Grup Punues nga viti 2011, kanë organizuar dhe zhvilluar takime, konferenca, seminare, vizita studimore, etj. për të promovuar rolin e MKPT.<sup>111</sup>

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në realizim të funksioneve të tij ligjore, do të bashkëpunojë ngushtë me Organizata të Shoqërisë Civile aktive dhe të specializuara të fushës. Ky bashkëpunim do të konsistoi në ofrimin e ekspertizës nga profesionistë nga fusha të ndryshme se mjekë, psikologë, sociolog, etj., sipas standardeve të OPCAT – it.

Në fushën e bashkëpunimit dhe promovimit të punës së MKPT në arenën ndërkombëtare, anëtarët e MKPT kanë marrë pjesë edhe në takimet e Rrjetit të Mekanizmave të Evropës Jug-Lindore me rrjetin e Evropës NPM (SEE Rrjeti i MKPT).

Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) ka vizituar Kosovën në prill, anëtarët e të cilës janë takuar edhe me Avokatin e Popullit. Në të ardhmen do të jetë obligim që edhe Avokati i Popullit në rolin e MKPT të raportojë, ashtu si edhe shtetet e tjera që tashmë kanë themeluar MKPT sipas OPCAT-it.

Për shkak të ndjeshmërisë së punës dhe problematikave që trajton, parandalimit të torturës dhe trajtimit çnjerëzor, MKPT mund të përballet me sfida dhe vështirësi, në kuptimin e mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare. Por shpresojmë që bashkëpunimi i ndërtuar ndër vite, me institucionet shtetërore, do të lehtësoj punën e MKPT, për një raportim sa më të drejtë.

AP do të vazhdojë bashkëpunimin me MD, MPB, MSH, MPMS, etj. për një funksionim dhe bashkërendim sa më të mirë të aktiviteteve. Në anën tjetër, do të vazhdojë ngritja profesionale e stafit të MKPT, me qëllim të fitimit të njohurive për të zhvilluar veprimtarinë e vet.

Gjatë vizitave të rregullta dhe pa paralajmërim, me ç‘rast është bërë edhe hapja e kutive të ankesave, AP ka pranuar ankesa për keqtrajtim apo tejkallim të detyrës nga ana e oficerëve të burgut, në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan<sup>112</sup> dhe në Burgun e Sigurisë së Lartë<sup>113</sup> të cilat

---

<sup>111</sup> IAP, QKRMT dhe KMDLNJ, më 10 maj 2011, kanë nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit, me të cilën parashihet krijimi i Task Forcës – Grup Punues, i cili ka lobuar për krijimin e Mekanizmit për Parandalimin e Torturës në Kosovë dhe ka vepruar deri në njohjen ligjore të MKPT, që është paraparë me Ligjin e ri për AP , Nr. 05/L-019.

<sup>112</sup> IAP, rasti A. nr. 134/2015, P.D.F. kundër Qendrës së Paraburgimit në Gjilan;

<sup>113</sup> IAP, rasti A. nr.228/2015, Sh.A. kundër Burgut të Sigurisë së Lartë;

ankesa janë hapur për hetim dhe janë në procedim. AP nuk ka pranuar ndonjë ankesë se ka pasur mohim të drejtës për të informuar menjëherë familjen, të drejtën e vizitës nga mjeku dhe të drejtës për të pasur avokat. Ankesat janë drejtuar kryesisht kundër vendimeve të gjykatave, Panelit për Lirim me Kusht (PLK), trajtimit shëndetësor jo adekuat, lejimin e vizitave në familje gjatë vikendeve, transferimeve, ekstradimeve, etj. Ankesa janë adresuar edhe ndaj fenomenit të korrupsionit dhe favorizimeve, jo vetëm ndaj stafit të burgjeve por edhe ndaj stafit mjekësor.

AP ka vizituar edhe Institucionet e shëndetit mendor dhe të kujdesit social, si dhe Qendrën e Azilit, të cilat vende nuk paraqesin vende të privimit nga liria në kuptimin klasik, por që AP këto vende i viziton në përputhje me kompetencat që dalin nga neni 4 dhe 20 i Protokollit Fakultativ të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.<sup>114</sup>

Vizitat në këto institucione janë realizuar në bashkëpunim të plotë me Administratën e Burgjeve dhe Shërbimin Korrektues, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Shëndetësisë. Gjithashtu, ka vazhduar bashkëpunimi me qëllim të promovimit të mbrojtjes së të drejtave të të burgosurve.<sup>115</sup>

### **1.8.2. Ankesat e personave të privuar nga liria**

Gjatë vitit 2015 IAP ka realizuar çdo muaj vizita monitoruese në burgje dhe qendra të paraburgimit. Gjatë këtyre vizitave janë intervistuar 174 persona dhe prej tyre 64 ankesa janë hapur për hetime të mëtejme.

AP gjithashtu, ka realizuar vizita në qendrat e ndalimit (stacionet policore) në shtatë drejtoritë rajonale. Nga vizitat e këtyre qendrave, ku ka të vendosura kutitë e ankesave, AP nuk ka pranuar ndonjë ankesë nga personat që kanë qenë në mbajtje, për shkelje të të drejtave të njeriut nga ana e oficerëve të qendrave, por ka pranuar ankesa të përdorimit të forcës nga ana e policisë në fazën e intervistimit, në rastet më të shpeshta janë përmendur shuplaka, shkelma, grushte me qëllim të pranimit të veprës. Përdorimi i forcës nga ana e policisë ka ndodhur në disa raste edhe pas vënies nën kontroll apo arrestimit të personit, në disa raste të pjesëmarrësve të protestës përmes formave tjera të animimit. AP ka pranuar 101 ankesa kundër PK, prej tyre 40 janë hapur raste për hetim, 59 janë shpallë të papranueshme.

116

---

<sup>114</sup> OPCAT është adoptuar më 18 dhjetor 2002 në seancën e 57 të Asamblesë së Përgjithshme të UN, me Rezolutën A/RES/57/199 dhe ka hyrë në fuqi më 22 qershor 2006.

<sup>115</sup> Projekti I Komitetit të Helsinkut të Holandës, "Përmirësimi I kushteve dhe trajtimit të të miturve, me qëllim riintegrimin në institucionet korrektuese".

<sup>116</sup> Raport me Rekomandime, A. nr. 89/2015, Sh. J. kundër Policisë së Kosovës. Publikuar në faqen zyrtare të IAP, më 3 nëntor 2015;

Gjatë vitit 2015 janë vizituar dhe institucionet tjera, ku liria e lëvizjes është e kufizuar, siç janë Institucionet e Shëndetit Mendor. Vërehet se ka pasur përmirësime në rregullimin e infrastrukturës në përgjithësi por vazhdojnë të ballafaqohen me mungesën e stafit profesional për t`ju ofruar trajtimin e nevojshëm personave që mbahen në këto qendra.

Këtë vit janë realizuar vizita në të gjitha Institucionet e Shëndetit Mendor, të menaxhuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), ku trajtohen personat me prapambetje mendore dhe ngecje në zhvillim. Këto vizita janë realizuar me qëllim të ekzaminimit të kushteve në të cilat mbahen personat e sëmurë mendor, trajtimi i tyre si dhe kushtet në të cilat realizon detyrat stafi . Të gjeturat nga kjo vizitë janë diskutuar në një tryezë të përbashkët me akterët kryesor të kësaj fushe dhe janë nxjerrë rekomandime konkrete të cilat do të publikohen në raport të veçantë.<sup>117</sup> Po me këtë temë planifikohet të mbahet edhe një tryezë tjetër diskutimi, ku do të prezantohen të gjeturat nga vizita edhe të atyre institucioneve që menaxhohen nga Ministria e Shëndetësisë (MSH), e ku trajtohen personat me sëmundje kronike psikiatrike.

### 1.8.3. Lirimi me kusht

Paneli për Lirim me Kusht ka vazhduar punën në shqyrtimin e rasteve që kanë aplikuar për të fituar këtë të drejtë, duke mbajtur nga tri seanca, për çdo muaj duke shqyrtuar 12-13 e deri në 15 raste për seancë. Gjatë vitit 2015 kanë aplikuar për lirim me kusht 418 persona, ndërsa lirim me kusht e kanë fituar 115 të dënuar, numër ky që dukshëm është më i lartë se sa në vitet paraprake.<sup>118</sup>

Nga numri i përgjithshëm i të liruarve, katër kanë qenë të mitur. Të gjithë personat e liruar nga PLK, kanë qenë në mbikëqyrje të Shërbimit Sprovues të Kosovës (SHSK). SHSK ka pasur në mbikëqyrje edhe raste të trashëguara nga vitet paraprake, dyzeteshtatë (47) persona. Pra, në mbikëqyrje të SHSK për vitin 2015, në total, kanë qenë 162 persona të liruar me kusht. Mbikëqyrjen nga SHSK e kanë përfunduar me sukses shtatëdhjetë (70) persona dhe nuk ka pasur asnjë rast të revokimit të lirit me kusht.<sup>119</sup>

Gjatë këtij viti raportues, AP ka monitoruar seancat e PLK, pasi që në vazhdimësi ka pranuar ankesa kundër PLK, për shkak të numrit të vogël të të liruarve, mos informimit me kohë për vendimin e marrë, arsyetimit të vendimeve që shpesh herë nuk janë sa duhet të argumentuar . AP ka hapur për hetim pesë raste kundër PLK të cilat janë duke u proceduar. Në vazhden e promovimit të të drejtave të personave të privuar nga liria dhe diskutimin e gjetjeve, sfidat me të cilat ballafaqohet PLK dhe Shërbimi Korrektues, në rastet e trajtimit të

<sup>117</sup> Tryeza e mbajtur me 23 dhjetor 2015, me temë, "Heqja zotësisë së veprimit për persona me aftësi të kufizuara mendore – ngecje në zhvillimin mendorë organizuar nga IAP e në mbështetur të OSBE-së;

<sup>118</sup> AP statistikat I ka siguruar nga Koordinatori I PLK, z. Bedri Duraku, përmes telefonit, datë 29 dhjetor 2015;

<sup>119</sup> AP statistikat I ka siguruar përmes emailit nga znj. Metije Ademi, Udhëheqëse e Divizionit për Lirim me Kusht dhe Programe, datë 11 janar 2016;

aplikimeve për këtë t`iu njohur kjo e drejtë AP ka mbajtur një tryezë diskutimi me anëtarët e Panelit për Lirim me Kusht si dhe akterët e tjerë relevant. Rekomandimet e dala nga tryeza u janë përcjellë edhe pjesëmarrësve të tryezës e të cilat do të shërbejnë për përmirësimin e punës në të ardhmen.<sup>120</sup>

#### **1.8.4. Monitorimi dhe vizitat në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria**

Në vitin 2015, Avokati i Popullit, në përputhje me mandatin kushtetues dhe ligjor ka vazhduar me realizimin e vizitave të rregullta mujore në të gjitha vendet ku liria e lëvizjes është e kufizuar, për të siguruar një mbulim të plotë monitorimi të situatës, mbi të drejtat e njeriut në institucione të tilla, parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe prezantimit të një gjendje reale mbi situatën në teren.<sup>121</sup>

AP ka monitoruar edhe trajtimin e personave të dënuar me probleme mendore, kryes të veprave penale dhe të cilët, dënimin e mbajnë në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK)<sup>122</sup>. Hapja e këtij Instituti konsiderohet si një e arritur e madhe, ku krahas ekspertizës psikiatrike-forenzike bëhet njëkohësisht edhe trajtimi i detyrueshëm që e ka lehtësuar dukshëm mbipopullimin e burgjeve.

AP ka pranuar një numër të ankesave në lidhje me kujdesin shëndetësor në institucionet korrektuese, për mungesë ilaçesh, trajtim jo adekuat, për favorizime të personave të caktuar nga stafi mjekësor, si dhe çështje tjera të ndërlydhura me shëndetësinë.

---

<sup>120</sup> Tryeza e mbajtur më 21 dhjetor 2015, me temë: "Trajtimi i rasteve në procedurën e liritimit me kusht", e organizuar nga AP, e në mbështetje të IAP;

<sup>121</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 27 "Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës".

<sup>122</sup> Më 13 maj 2014, është bërë hapja e IPFK;

## II. PËRMBLEDHJA E RAPORTEVE ME REKOMANDIME

Bazuar në autorizimet e dhënë Institucionit të Avokatit të Popullit me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 16, paragrafi 8 dhe nenin 27 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05 / L-019, Avokati i Popullit ka publikuar raportet e mëposhtme gjatë vitit 2015:

### **2.1. Rastet A.nr: 48/2012 Xhevdet Kalludra; A.nr.176/2012 Mexhit Balijs; A.nr.125/2013 Abdylqerim Mripa; A.nr. 36/2015 Hajrullah Bahtiri; A.nr.49/2015 Muhamed Sherifi kundër Agjencisë Kosovare të Pronës**

Avokati i Popullit me 12 mars 2015, ka publikuar Raportin me Rekomandime lidhur me rastin. Çështja e rastit është ngritur ndarazi nga një numër qytetarësh, pronat e të cilëve gjenden në pjesën veriore të Mitrovicës. Pronat në fjalë janë nën administrimin e AKPr-së, në bazë të vendimeve të plotfuqishme Komisionit për Çështje Pronësore Banesore të Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore. Pronat janë të përfshira në skemën e qirasë të AKPr-së për të cilat ankuesit do të duhej të merrnin qiranë mujore apo në të kundërtën AKPr-ja do të duhej t'i lironte ato nga shfrytëzuesit e kundërligjshëm, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës. Mirëpo për shkak të refuzimit të shfrytëzuesve aktual të pronave për të paguar qiranë apo për t'i liruar ato, në njërin anë, dhe për shkak të mos ofrimit të përkrahjes së duhur AKPr-së nga ana e Policisë së Kosovës, në anën tjetër, praktikisht vendimet e plotfuqishme lidhur me këto prona kanë mbetur të pazbatuara.

Lidhur me këtë Avokati i Popullit ka identifikuar shkelje të së drejtës pronësore, shkelje të së drejtës në një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si dhe shkelje të së drejtës së privatësisë, dhe ka rekomanduar që : Agjencia Kosovare e Pronës të zbatojë vendimet e plotfuqishme të Komisionit për Çështje Pronësore Banesore; Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Punëve të Brendshme, respektivisht Policia e Kosovës, t'i ofrojë mbështetje Agjencisë Kosovare të Pronës dhe të ndërmarrë të gjitha masat, për krijimin e kushteve për rikthimin e posedimit për personat e zhvendosur, si e vetmja zgjidhje ligjore dhe e qëndrueshme; Qeveria e Republikës së Kosovës të krijojë një fond për kompensim në emër të qirasë për pronat banesore të personave të zhvendosur, të cilat janë nën administrim të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe për të cilat dëshkohet se janë shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar, ku agjencia nuk ka mundur të zbatojë skemën e qirasë.

Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga AKPr-ja e cila ka pohuar se mungon mbështetja e organeve të rendit në zbatimin e vendimeve të plotfuqishme, ndërsa nuk ka pranuar përgjigje nga Qeveria e Kosovës lidhur me raportin brenda afatit të përcaktuar me raport dhe as pas një shkresë përkujtuese dërguar kryeministrit, në fund të vitit 2015.

## **2.2. Rasti Ex officio nr. 517/2015, në lidhje me procedurën gjyqësore për ankesat kundër vendimeve preliminare për shpronësimin e pronës së paluajtshme**

Avokati i Popullit më 16 tetor 2015, publikoi Raportin me rekomandime për Kuvendin e Republikës së Kosovës lidhur me rastin e sipërpërmendur. Avokati i Popullit ka vërejtur se Ligji Nr. 03/L-139 (i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 03/L-205) për shpronësimin e pronës së paluajtshme, përcakton një procedurë të veçantë për ankesat gjyqësore kundër vendimeve preliminare për shpronësim të nxjerra nga Qeveria ose komuna. Sipas kësaj procedure, me rastin e paraqitjes së një ankese kundër vendimit preliminar, “gjykata . . . nxjerr aktgjykimin mbi rastin brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të përgjigjes së Organit Shpronësues [ndaj ankesës së paraqitur]” (*id.*, neni 35, par. 6, nënpar. 3) dhe, “[n]ëse gjykata nuk e nxjerr aktgjykimin brenda periudhës tridhjetë (30) ditore . . . , gjykata konsiderohet përfundimisht se ka nxjerrë aktgjykim për refuzimin e ankesës në tërësi menjëherë pas skadimit të kësaj periudhe tridhjetë (30) ditore” (*id.*, neni 35, par. 8).

Avokati i Popullit ka rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës që: Të hiqet në tërësi neni 35, par. 6, nën-paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme: “Menjëherë pas pranimit të përgjigjes së Organit Shpronësues, gjykata . . . nxjerr aktgjykimin mbi rastin brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të përgjigjes së Organit Shpronësues; dhe i cakton afatet për zhvillimin e procedurës mbi rastin në mënyrë që t’i mundësojë nxjerrjen e aktgjykimit brenda periudhës së lartpërmendur prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike”; Të hiqet në tërësi neni 35, par. 8 i Ligjit Nr. 03/L-139 (të ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 03/L-205) për shpronësimin e pronës së paluajtshme: “Nëse gjykata nuk e nxjerr aktgjykimin brenda periudhës tridhjetë (30) ditore të përcaktuar në nën-paragrafin 6.3 paragrafi 6 i këtij neni, gjykata konsiderohet përfundimisht se ka nxjerrë aktgjykim për refuzimin e ankesës në tërësi menjëherë pas skadimit të kësaj periudhe tridhjetë (30) ditore”.; Të hiqet në tërësi neni 35, par. 13, nën-paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit Nr. 03/L-139 (të ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 03/L-205) për shpronësimin e pronës së paluajtshme: “Pas pranimit të apelit, gjykata e apelit . . . nxjerr aktgjykimin e saj mbi apelin brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas datës në të cilën ka pranuar përgjigjen e palës tjetër ose pas datës së skadimit të periudhës pesëmbëdhjetë (15) ditore për dorëzimin e përgjigjeve, cilado që ndodh më herët; dhe i cakton afatet për zhvillimin e procedurës në mënyrë që t’i mundësojë nxjerrjen e aktgjykimit brenda periudhës së lartpërmendur tridhjetë (30) ditore”.

Komisioni për Legjislacion, Mandate dhe Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit i Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2015 e shqyrtoi Raportin me Rekomandime të Avokatit të Popullit dhe ka rekomanduar që Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të koordinohen që me rastin e përgatitjes së programit legjislativ për vitin 2016, të merret

nisma për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 (të ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 03/L-205) për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

### **2.3. Rasti A. nr. 201/2015 Behram Krasniqi kundër Komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, apo të internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës**

Avokati i Popullit më 23 tetor 2015, publikoi Raportin me Rekomandime lidhur me rastin. Çështja e rastit është ngritur nga z. Behram Krasniqi, anëtar i Komisionit të Familjeve të Dëshmorëve të Kombit kundër Komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, apo të internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për shkak të mosnjohjes së statusit të dëshmorëve të rënë brenda periudhës 1968-1990. Z. Krasniqi ka pohuar se neni 8, paragrafi 2 i Ligjit përcakton se të drejtat në pension e beneficione për familjet e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së i realizojnë edhe të gjitha familjet e dëshmorëve të kombit, të rënë në forma të ndryshme për lirinë e vendit në periudha të ndryshme historike. Komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, apo të internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka refuzuar kërkesat e familjeve të dëshmoreve të kombit të rënë brenda periudhës 1968-1990. Sipas ankuesit, arsyet e refuzimit ishin se Komisioni Qeveritar kishte deklaruar se nuk është kompetent për të vendosur lidhur me kategorinë e dëshmorëve të kombit të rënë brenda kësaj periudhe.

Pas shqyrtimit të ankesës, Avokati i Popullit ka ardhur në përfundim se neni 8, paragrafi 2 i Ligjit ka krijuar pritje legjitime tek familjarët e dëshmorëve të kombit të rënë në periudha të ndryshme historike lidhur me realizimin e të drejtave të tyre. Mos përmbushja e pritjeve legjitime të krijuara nga familjarët e dëshmorëve të kombit nga ana e autoriteteve të Republikës së Kosovës, përbën shkelje të të drejtave të tyre të përcaktuara me ligj.

Lidhur me këtë Avokati i Popullit ka rekomanduar që: Qeveria e Republikës së Kosovës të jap mandat Komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, apo të internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ose të themelojë një komision të ri i cili do të shqyrtonte kërkesat për njohje të statusit të dëshmorëve të kombit të rënë në periudha të ndryshme historike sipas përcaktimit të vet Ligjit; Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me përkrahjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të ndërmerre iniciativë për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-054, Për Statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në mënyrë që përkufizimet e ligjit të jenë në harmoni me përmbajtjen e ligjit.

Avokati i Popullit nuk ka pranuar përgjigje lidhur me raportin brenda afatit të përcaktuar me raport dhe as pas dërgimit të shkresës përkujtuese dërguar kryeministrit dhe ministrit të MPMS, në fund të vitit 2015.



#### **2.4. Rastet: A.nr.23/2014 Pjetër Saliquani dhe të tjerët; 473/2014 Zvonimir Vasić dhe të tjerët kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit në lidhje me vonesat në emërimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit**

Avokati i Popullit më 30 tetor 2015, publikoi Raportin me Rekomandime lidhur me rastin. Çështja e rastit është ngritur ndarazi nga ankuesit, lidhur me vonesat në shpërndarjen e mjeteve apo kompensim të kreditorëve të ndërmarrjeve shoqërore në likuidim. Ndërmarrjet shoqërore respektive, në likuidim, të cilat janë nën menaxhimin e AKPv-së ju kanë mbetur borxh ankuesve disa paga mujore, kompensimi i të cilëve është njohur me anë të vendimeve gjyqësore, por vendimet kanë mbetur të pazbatuara për shkak se për kompensimin e pagave nevojitet miratimi i Bordit të Drejtorëve të AKPv-së. Bordi i Drejtorëve të AKPv-së bartë të gjitha kompetencat e AKPv-së. Bordi i AKPv-së përbëhet nga 8 anëtarë, tre prej të cilëve ndërkombëtarë, të emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar dhe 5 anëtarë të tjerë vendorë, të cilët ishin emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Mandati i tre anëtarëve ndërkombëtarë kishte skaduar më 31 gusht 2014 dhe që nga atëherë Bordi i AKPv-së është jofunksional, për shkak të mungesës së kuorumit, ndërsa në fund të vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015, Bordi i AKPv-së ka mbetur edhe pa anëtarët vendorë. Në vonesën e emërimit të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve kanë mundur të ndikojnë rrethana të ndryshme por një vonesë e tillë, sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit, ka shkaktuar ndërhyrje në të drejtën pronësore të ankuesve si dhe shkeljen e së drejtës në një gjykim të drejtë dhe të paanshëm për shkak se ekzekutimi i vendimeve të plotfuqishme, në këtë rast vendimet për kompensim, duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e gjykimit.

Prandaj Avokati i Popullit, në Raportin me Rekomandime të datës 30 tetor 2015, ka rekomanduar që: Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmerr të gjitha veprimet e domosdoshme për propozimin e tre anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të AKPv-së, sipas nenit 4, paragrafit 3 të Ligjit nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës; Kuvendi i Republikës së Kosovës të emërojë anëtarët e Bordit të AKPv-së, në mënyrë që Bordi të kompletohet dhe të bëhet funksional ose së paku ta ketë kuorumin e duhur, sa më shpejtë që është e mundur, në mënyrë që të ndalohen shkeljet e shkaktuara nga mungesa e Bordit; Nga akterët e përfshirë në çështjet e propozimit dhe emërimit të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të AKPv-së të vendoset procedura për emërimin e tre anëtarëve, të cilët deri më 31 gusht 2014 i kishte emëruar Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar.

Avokati i Popullit nuk ka pranuar përgjigje nga akterët e përfshirë në procesin e emërimit të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, mirëpo Kuvendi i Republikës së Kosovës më 18 dhjetor 2015 ka emëruar anëtarët e Bordit të Drejtorëve të AKPv-së.

**2.5. Rasti Nr. 302/2012 Agim Memaj kundër Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me zvarritjen procedurale nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës në vendosjen e lëndës SR-11-0315/C-III-12-1993, që ka të bëjë me dorëzimin e patundshmërisë nga KBI “Progres” në Prizren**

Avokati i Popullit më 23 shkurt 2015, publikoi Raportin me Rekomandime për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (DHPGJS) lidhur me rastin e sipërpërmendur.

Avokati i Popullit ka konstatuar se ka pasur shkelje të së drejtës për proces të rregullt gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe të drejtës për mjete efektive juridike në vendosjen e lëndës së ankuesit. Në procedurën civile, koha që duhet marrë parasysh, kur vendoset për zvarritjen e procedurës, fillon të rrjedhë nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, e që në rastin konkret fillon nga momenti kur parashtruesi i ankesës parashtrroi padi në vitin 2005.

Prandaj, Avokati i Popullit ka rekomanduar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme që: Të marrë masa të menjëhershme për shqyrtimin dhe vendosjen meritorë, pa vonesë të mëtutjeshme, të lëndës gjyqësore të z. Agim Memaj.

Avokati i Popullit më 22 prill 2015 ka pranuar përgjigje nga DHPGJS ku në mes tjerash ceket se gjatësia e procedurave të lëndës ka të bëjë kryesisht me nevojën e përkthimit të dosjes në gjuhën angleze, ndërrimet e gjyqtarëve dhe zyrtarëve ligjor të caktuar për lëndën dhe ndryshimet në ligj sa i përket jursidiksionit.

**2.6. Rasti Nr.602/2014 Sali Rexhepi kundër Shërbimit Korrektues të Kosovës për shkak të mosrealizimit të së drejtës në arsim, sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Nr.04/L-149**

Avokati i Popullit më 13 maj 2015, publikoi Raportin me Rekomandime për Z. Hajredin Kuçi, ministër i Drejtësisë së Republikës së Kosovës lidhur me rastin e sipërpërmendur.

Gjatë vizitës në Burgun e Dubravës, IAP ka pranuar ankesën e z. Sali Rexhepi kundër Drejtorisë së Qendrës Korrektuese në Dubravë, lidhur me kërkesën e tij për t'i vazhduar provimet e mbetura në Fakultetin e Edukimit, sipas programit të Ministrisë së Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Edukimin dhe Avancimin e Mësimdhënësve. Z. Rexhepi, ka shprehur shqetësimin e tij lidhur me mos përgjigjen nga Shërbimi Korrektues i Kosovës në kërkesën e tij për vazhdimin e arsimit, që sipas tij, nëse ai nuk i nënshtrohet provimeve të mbetura në afatin e marsit apo prillit 2015, do të humb të drejtën e vazhdimin të shkollimit, pasi është gjenerata e fundit sipas programit të MASHT-it. Sipas z. Rexhepi disa të burgosurve u lejohet vazhdimi i arsimit gjë që e kishin konfirmuar edhe zyrtarët e Shërbimit Korrektues Kosovës gjatë kontakteve me zyrtarë të IAP-it.

Avokati i Popullit ka konstatuar se mungesa e një vendimi nga Shërbimi Korrektues i Kosovës lidhur me lejimin apo mos lejimin e vazhdimit të shkollimit të z. Rexhepi ka cenuar të drejtën në mjete juridike. Kur disa personave të cilët qëjanë në vuajtje të dënimit u lejohet vazhdimi i shkollimit me leje administrative apo gjatë vikendeve, i vë në pozitë të pabarabartë me personat tjerë të privuar nga liria.

Prandaj, Avokati i Popullit ka rekomanduar që: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës të ndërmarrin masa të menjëhershme, për nxjerrjen e akteve nënligjore, që kërkohen sipas nenit 249 të Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, përmes të cilave rregullohet procedura e vazhdimit të arsimit të lartë për personat që gjenden në vuajtje të dënimit; Të nxirret një vendim dhe, mbi bazën e lejeve administrative të cilat janë përdorur për raste të tjera nëpër institucionet korrektuese dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, t'i lejohet ankuesit që t'i nënshtrohet provimeve të mbetura; Që organet përgjegjëse të Shërbimit Korrektues të Kosovës, për zbatimin e ligjeve, të përgjigjen brenda afateve ligjore me shkrim në të gjitha parashtrësat e drejtuara nga personat e dënuar, si një e drejtë kushtetuese dhe ligjore e të gjithë qytetarëve, për shfrytëzim të mjeteve juridike efektive dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave.

Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga ushtruesi i detyrës së drejtorit të Shërbimit Korrektues të Kosovës i cili thekson se deri në nxjerrjen e një akti nënligjor për arsimin universitar, të burgosurve të dënuar ju mbetet që të drejtën e arsimimit ta realizojnë me përmbushjen e kushteve të parapara për realizimin e beneficionit – pushimit jashtë burgut.

## **2.7. Ex officionr.498 /2015 lidhur me ngritjen e “Parkut të Paqes”, “Sheshit Car Lazar”, “Sheshit UÇK” dhe “Sheshit Adem Jashari”, në komunën e Mitrovicës së Veriut**

Avokati i Popullit më 29 maj 2015, ka publikuar Raportin me Rekomandime për Qeverinë Republikës së Kosovës lidhur me rastin e sipërpërmendur. Duke filluar në qershor të 2014, janë ngritur ose kanë filluar të bëhen katër ndërtime në Komunën e Mitrovicës së Veriut. Këto ndërtime janë të ashtuquajturat “Parku i Paqes”, “Sheshi Car Lazar”, “Sheshi Adem Jashari” dhe “Sheshi UÇK”.

Avokati i Popullit ka vlerësuar se, ka munguar një trajtim i kësaj çështjeje dhe analizë ligjore dhe kushtetuese e situatës nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut. Në mënyrë që të plotësojë këtë zbrazëti, Avokati i Popullit kishte vendosur të hapë hetime me vetiniciativë lidhur me këto ndërtime me ç’ rast ka konstatuar se Sheshi “UÇK” dhe Sheshi “Adem Jashari” janë ndërtime të kundërligjshme ndërsa Ngritja e “Parkut të Paqes” dhe “Sheshit Car Lazar” përbën jo vetëm një shkelje të ligjit, por edhe një shkelje të Kushtetutës dhe instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Prandaj, Avokati i Popullit ka rekomanduar që: Zyra Administrative e Komunës së Mitrovicës së Veriut dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, në afatin më të shkurtë kohor, të largojnë “Parkun e Paqes” nga ura kryesore e lumit Ibër, si dhe të ndalin punimet në “Sheshin Car Lazar” dhe ta kthejnë rrugën në gjendjen e mëparshme, duke lejuar lëvizjen e lirë në këtë urë, si për këmbësorët ashtu edhe për automjetet; Zyra Administrative e Komunës së Mitrovicës së Veriut dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, në afatin më të shkurtë kohor, të largojnë të gjitha pengesat e ndërtuara fizike në Lagjen e Boshnjakëve dhe në hyrje të fshatit Sudoholl, respektivisht të “Sheshi Adem Jashari” dhe “Sheshi UÇK”; Ndaj të gjithë personave përgjegjës për vendosjen e “Parkut të Paqes”, sidomos ndaj udhëheqësve të tyre, kryetarit Rakiq dhe z. Marko Gjuriq, të ndërmerren masa të parashikuara me ligj për shkeljen e Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, duke përfshirë edhe ndjekje penale; Kryetari Rakiq dhe kryetarja Bozhoviq, të marrin të gjitha masat e nevojshme për të bashkëpunuar në nivelin e duhur me zyrtarët e tjerë të Komunës.

Në lidhje me këto rekomandime Avokati i Popullit nuk ka pranuar përgjigje nga autoritetet përgjegjëse.

## **2.8. Rasti nr. 221/2013 Arsim Biqaku kundër Gjykatës Themelore në Prizren lidhur me zvarritjet procedurale nga gjykata për vendosjen e lëndës përkitazi me ndërprerjen e marrëdhënies së punës**

Avokati i Popullit më 29 janar 2015, publikoi Raportin me Rekomandime për Gjykatën Themelore në Prizren (GJTHPz) lidhur me rastin e sipërpërmendur.

Rasti ka filluar të procedohet në GJTHPz më 9 dhjetor 2003 dhe deri në publikimin e raportit me rekomandime rasti nuk është vendosur. Vendosja e rastit zgjat dymbëdhjetë vite. Gjykata e shkallës së dytë vendimet e gjykatës së shkallës së parë për tri herë me radhë ia ka kthyer në rigjykim, e po ashtu edhe Gjykata Supreme e Kosovës, dy herë radhazi i ka prishur vendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim.

Avokati i Popullit vlerëson se zvarritjet e tepruara të procedurave gjyqësore dhe pa një vendim përfundimtar të formës së prerë, janë në kundërshtim me të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor, brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ dhe nenin 10.1 të LPK.

Prandaj, Avokati i Popullit ka rekomanduar Gjykatës Themelore në Prizren që: Të marrë masa të menjëhershme për shqyrtimin dhe vendosjen meritore, pa vonesë të mëtutjeshme, të lëndës gjyqësore të z. Arsim Biqaku, lënda C.nr.899/2012; Të garantojë shqyrtimin e rasteve për të gjitha palët brenda një afati të arsyeshëm kohor, në pajtim edhe me nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së. Zyrës së Prokurorit Disiplinor i rekomandoi që: Të marrë masa ndaj mosveprimeve/keqpërdorimeve eventuale të gjyqtarëve përkatës, në të tri nivelet e gjyqësorit, të cilat kanë trajtuar rastin e z. Biqaku, për zvarritjen e paarsyeshme të

procedurës gjyqësore, në rastin e Arsim Biqaku. Ndërsa Këshillit Gjyqësor të Kosovës që: gjyqësori të zbatojë nenin 190, paragrafi 3, të Ligjit për Procedurën Kontestimore që, pas anulimit për herë të dytë të aktgjykimeve të gjykatave të shkallës së parë, të mos i rikthejë çështjet në rigjykim, por të vendosen në mënyrë meritore.

Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga Gjykata Themelore e Prizrenit dhe nga Zyra e Prokurorit Disiplinor të cilët kanë përshkruar rastin dhe kanë pohuar se zvarritja ka ardhur si rezultat i rrethanave objektive. Avokati i Popullit më 15 dhjetor 2015 ka dërguar një shkresë përkujtuuese kryetarit të GJTHPz në lidhje me mos zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në raportin nr. 221/2013, kundër Gjykatës Themelore në Prizren për të cilën nuk ka marrë përgjigje.

## **2.9. Ankesa nr. 66/2015 Novica Filipović kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Graçanicë në lidhje me zgjatjen e procedurës gjyqësore**

Avokati i Popullit me datën 6 nëntor 2015, ka lëshuar një raport në lidhje me tejzgjatjen e procedurës së trajtimit në rastin e mësipërm.

*Inter alia*, Avokati i Popullit konstatoi se Gjykata Themelore në Prishtinë dega në Graçanicë nuk e ka zgjidhur lëndën e ankuesit në një periudhë të arsyeshme kohore, që paraqet shkelje të të drejtave të ankuesit për gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Lënda e cila i referohet raportit ka të bëjë me procedurat civile të iniciuara nga ankuesi qysh në vitin 2009 dhe të plotësuara në vitin 2011. Rasti ka të bëjë me kontestin e punës, dhe sipas mendimit të Avokatit të Popullit pasi nuk ka qenë i ndërlikuar, ka mundur të zgjidhet në një periudhë të shkurtër kohore. Gjegjesisht, lëndën e cekur dega kompetente e Gjykatës Komunale në Graçanicë e ka vënë në punë në vitin 2013, kur janë planifikuar tri seanca. Pas kësaj, kjo Gjykatë nuk ka marrë ndonjë veprim për lëndën e ankuesit, për më shumë se dy vjet nga seanca e fundit, dhe gjithsejtë gjashtë vite nga paraqitja e padisë e që rasti nuk është trajtuar.

Në lidhje me situatën e mësipërme, gjykata kompetente ka theksuar në letrën e saj për IAP se dega në Graçanicë një kohë ka qenë pa gjyqtar, dhe për shkak të numrit të madh të rasteve të grumbulluara ka ardhur deri te vonesa në procedurë në këtë rast. Avokati i Popullit konstatoi se të lartë përmendurat nuk mund të jenë arsyetim për shtyrjen e punës në rastet që kanë të bëjnë me lëmin e mosmarrëveshjeve të punës, si dhe Gjykata nuk ka marrë ndonjë veprim në lidhje me lëndën e ankuesit. Si pasojë, ajo nuk ka trajtuar rastin me kujdesin e duhur që kërkohet me nenin 6 paragrafi 1 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe neni 10 i Kodit të Procedurës Civile.

Avokati i Popullit ka arritur në përfundimin se mungesa e një mjete juridik përbën shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm si dhe shkelje të së drejtës për ankim efektiv sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Në këtë raport, Avokati i Popullit i ka bërë rekomandime kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë që duhet të sigurojë, duke marrë parasysh vonesat e mëparshme, që dega e kësaj Gjykate në Graçanicë të vazhdojë të veprojë në rastin e ankuesit pa vonesa të mëtejshme.

Gjithashtu, Avokati i Popullit ka rekomanduar që Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës duhet të sigurojë burime financiare dhe të emërojë një numër të mjaftueshëm të gjykatësve në Gjykatat Themelore dhe degët e tyre, ose të merr masa të tjera të nevojshme për të garantuar shqyrtimin e rasteve dhe dorëzimin e aktgjykimeve të gjitha palëve brenda një afati të arsyeshëm. Përveç kësaj, rekomandimi i është bërë edhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës për të iniciuar hartimin e një instrumenti ligjor që siguron një mjet efektiv juridik sipas nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili do të ofrojë ndihmë parandaluese dhe kompensuese lidhur me ankesat për zgjatje të tepruar të procedurës në rastet civile.

Deri në fund të periudhës raportuese, IAP nuk ka marrë përgjigje në këtë raport. Megjithatë, më 16 nëntor 2015 ankuesi e informoi IAP se gjykata kompetente pas publikimit të raportit të IAP ka caktuar gjykim për këtë rast dhe ka filluar procedurën e të njëjtit.

#### **2.10. Ankesa nr. 435/2013 Nadežda Jovanović kundër AKPr në lidhje me ekzekutimin e Vendimit të Gjykatës Supreme KI 187/13**

Avokati i Popullit më datën 6 maj 2015 publikoi një raport për moszekutimin e vendimeve, më parë të Gjykatës Supreme në vitin 2012 dhe më vonë të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2014 nga ana e Sekretariatit të AKPr-së në ekzekutimin e dëbimit të një uzurpimit të pronës private të ankuesit Nedezhda Jovanović, si dhe shembjen e ndërtimeve pa leje në pasurinë e saj të paluajtshme në lagjen Sofalija, Komuna e Prishtinës.

Avokati i Popullit në këtë rast, ndër të tjera, arriti në përfundimin se AKPr nuk ka vepruar sipas procedurës së përcaktuar ligjore, sidomos në zbatimin e Vendimit të formës së prerë të Gjykatës Supreme dhe Gjykatës Kushtetuese i cili AKPr-në e obligon në ekzekutimin e së njëjtës.

Avokati i Popullit në rastin në fjalë, arriti në përfundimin se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave të pronësisë nuk ka kuptim nëse nuk është e mbrojtur edhe në praktikë. Është absurde të flitet për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë, nëse qytetarët nuk janë në gjendje për të mbrojtur të drejtat e tyre legjitime për mjete efektive ligjore dhe mekanizma. Avokati i Popullit në këtë raport ka konstatuar se dështimi për të ekzekutuar vendimet e Gjykatës Supreme më parë, dhe më vonë vendimet e Gjykatës Kushtetuese nga ana e AKPr, ka

shkelur të drejtën e parashtrueses së ankesës për gëzimin e papenguar dhe disponimin e pronës private, në përputhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

Përveç kësaj, në rastin në fjalë parashtruesit të ankesës i është shkelur e drejta e barazisë para ligjit e garantuar me nenin 24 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me mbrojtjen e pronës.

Në këtë raport, Avokati i Popullit ka bërë rekomandime që AKPr të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar ekzekutimin e Vendimit të Gjykatës Supreme KI 187/13, i dt. 16 prill 2014, dhe pa vonesë të mëtutjeshme të mbrojtë të drejtën e pronës në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjin. Kopjet e raportit i janë drejtuar Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Këshillit Gjyqësor dhe Gjykatës Supreme.

Më 26 maj 2015, IAP ka marrë një përgjigje në raportin e publikuar nga u.d. i Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv i AKPr, i cili thekson se Agjencia nuk është në gjendje për të ekzekutuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe shembjen e objekteve të ndërtuara në mënyrë të paligjshme në pronën e ankuesit, sepse nuk ka fonde në buxhetin e saj për këtë qëllim. Në shkresën e AKPr thuhet gjithashtu se në lidhje me këtë problem ju kanë drejtuar edhe Ministrisë së Financave, në mënyrë specifike në lidhje me ekzekutimin e këtyre lëndëve, por për fat të keq Ministria nuk është përgjigjur në shkresat e AKPr.

Kuvendi Republikës së Kosovës nuk ka bërë komente në lidhje me këtë raport.

## **2.11. Ankesa nr. 290/2015 Hivzija Bukvić kundër MPB në lidhje me procesin e marrjes së shtetësisë dhe përdorimin e gjuhëve**

Avokati i Popullit më 25 nëntor 2015, ka publikuar një raportin lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe të drejtën e shtetësisë në lëndën e Hivzija Bukvić.

Në këtë rast, ankuesi në vitin 2014 nëpërmjet Komunës së Istogut ka aplikuar për shtetësi të Republikës së Kosovës, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion (MPB DSHAM), i cili edhe në shkallën e parë edhe të dytë është refuzuar (në shkallë të dytë për këtë vendos Komisioni për Ankesa për Shtetësi - KASH), si dhe vendimin e tij të refuzuar i kanë dorëzuar vetëm në gjuhën shqipe, të cilën ankuesi pak e kupton. Përveç kësaj, dy herë mbiemri i tij është shkruar gabimisht Burkić në vend të Bukvić. Ankuesi ka kërkuar nga zyrtarët e DSHAM që vendimi i shkallës së dytë për refuzimin e kërkesës për marrjen e shtetësisë t'i përkthehet në gjuhën serbe, por mori përgjigjen se për përkthim të vendimit duhet të paraqesë një kërkesë të veçantë.

Në këtë raport, Avokati i Popullit konstatoi se MPB DSHAM-KASH ka shkelur të drejtat e ankuesit në lidhje me përdorimin e gjuhëve zyrtare, të drejtën për shtetësi dhe shkeljen e Rregullores së Punës të KASH gjatë ushtrimit të autoritetit legjislativ gjatë vendimmarrjes për ankesën e apeluesit për pranim në shtetësinë e Kosovës.

Avokati i Popullit në këtë raport ka konstatuar se në lidhje me shkeljen e të drejtës për përdorimin e gjuhëve në këtë rast konkret, çështja e statusit të barabartë të gjuhës shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë dhe përdorimi i tyre i barabartë në të gjitha institucionet e Kosovës, rregullohet me Kushtetutë dhe Ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe, si i tillë, pa përjashtim dhe plotësisht duhet të respektohet dhe të zbatohet, kurse në bazë të fakteve të pakontestueshme në rastin e ankuesi nuk ishte ashtu. Avokati i Popullit në raportin e tij arriti në përfundimin se ka pasur shkelje të të drejtave të ankuesit për përdorimin e gjuhëve zyrtare.

Gjithashtu, kur flasim për të drejtën e shtetësisë Avokati i Popullit ndër të tjera konkludon se çdo individ pavarësisht se ku ndodhet, i jepet e drejta e një marrëdhënie juridike me shtetin në bazë të kombësisë (neni 15 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut). Lidhur me procedurën e autoritetit kompetent të MPB, në rastin konkret, Avokati i Popullit ka konstatuar se nuk është respektuar Rregullorja e punës, dhe ankuesi nuk ishte i informuar për datën e shqyrtimit të ankesës së tij pranë KASH. Kur është fjala për shqyrtimin dhe vlerësimin e provave të paraqitura në rastin konkret, interpretimin e ligjeve dhe procedurave, Avokati i Popullit konstatoi se MPB-DSHAM-KASH, nuk i ka shqyrtuar me kujdesin e duhur të gjitha dëshmitë nga dokumentacioni i lëndës, çka rezultoi që në procedurën e vendimmarrjes janë bërë gabime materiale dhe formale për të cilat arsye ankuesit nuk i është pranuar kërkesa për marrjen e shtetësisë së Kosovës.

Në këtë raport, Avokati i Popullit ka bërë rekomandime për Ministrinë e Brendshme, për të siguruar se gjatë veprimeve administrative DSHAM KASH, merr në konsideratë dhe u bënë një vlerësim të vlefshëm të gjithë faktorëve që kanë të bëjnë me aktin e caktuar administrativ. Si dhe të siguroj që në të gjitha rastet në të cilat vendoset për shtetësinë DSHAM- KASH, në procesin e vendimmarrjes do të respektoj Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve. Një kopje e këtij raporti i është dërguar Zyrës së Komisionerit për Gjuhët.

Më 4 dhjetor 2015, IAP ka marrë përgjigje në raportin e publikuar të Ministrit të Punëve të Brendshme, ku thuhet se Ministria e Punëve të Brendshme i pranon rekomandimet.

Më 16 dhjetor 2015, IAP ka marrë një letër nga Komisioneri për Gjuhët në të cilën thuhet se KPGJ do t'i kushtojë vëmendje të veçantë shkeljes së të drejtës për përdorimin e gjuhëve në institucionet e Republikës së Kosovës, si dhe do të monitoroj zbatimin e rekomandimeve të IAP në lidhje me implementimin i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

## **2.12. Ex Officio nr. 680/2015, Rekomandimet drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me Strategjinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut**

Më 16 dhjetor 2015, Avokati i Popullit në përputhje me mandatin dhe kompetencat e tij i ka dërguar rekomandime Qeverisë së Republikës Kosovës në lidhje me Strategjinë për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut e cila është përgatitur nga Zyra për Qeverisje të



Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Duke pasur parasysh se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër Kabinetit të Kryeministrit janë angazhuar në kuadër të politikave që menaxhojnë promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe hartimin e dokumenteve në fusha të caktuara strategjike, Avokati i Popullit konsideron se kjo çështje duhet të përcillet me kujdes të veçantë. Avokati i Popullit konsideron të nevojshme vlerësimin e kësaj çështje, si dhe koordinimin e duhur të strategjive të bëra, dhe kështu edhe aplikimin e tyre. Qeveria ka bërë një numër të dokumenteve strategjike, dhe ato që të gjitha kanë mekanizma specifike për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të tyre. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit rekomandoi që, pasi Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Kabinetit të Kryeministrit tashmë ka hartuar dokumente strategjike në lidhje me të drejtat e njeriut, të ketë parasysh faktin se të drejtat e njeriut janë unike dhe të patjetërsueshme, dhe se është e nevojshme që në nivelin qendror të hartohet një Strategji për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, e cila do të përfshijë të gjithë strategjinë ekzistuese dhe të planifikuara nga kjo fushë.

Avokati i Popullit ka adresuar rekomandimet e mëposhtme në Qeverinë e Republikës së Kosovës, që sipas mundësisë të hartoj një dokument të vetëm strategjik në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut, e cila do të përfshijë të gjitha strategjitë e veçanta të të drejtave të njeriut. Dhe së bashku me Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Zyrës për Qeverisje të Mirë të diskuton rezultatet e zbatimit të strategjisë në fushën e të drejtave të njeriu.

Deri në fund të periudhës raportuese, IAP nuk ka marrë ndonjë përgjigje nga Kryeministri i Republikës së Kosovës për rekomandimet e dhëna.

### **2.13. Ankesa nr.124/2015 Božidar Perić kundër Komunës Partesh në lidhje me të drejtën për të punuar dhe moszbatimin e Vendimit të Inspektoratit të Punës**

Më 24 nëntor 2015, Avokati i Popullit publikoi raportin në lidhje me shkeljen e të drejtës për punë dhe moszbatimin e vendimit të Inspektoratit të Punës në rastin e Božidar Perić. Ankuesi ka parashtruar ankesë pranë IAP dhe provat kundër Komunës së Parteshit, në lidhje me vonesën e moszbatimit të vendimeve të organit ekzekutiv të Inspektoratit të punës që ka të bëjë me kthimin e ankuesit në postin e Asistentit të Kryesuesit të Kuvendit Komunal Partesh, nga e cila pozitë është shkarkuar në mënyrë të paligjshme në shkurt të vitit 2015.

Avokati i Popullit ndër të tjera në raportin e tij arriti në përfundimin se vonesa ishte e pajustificueshme në zbatimin e vendimeve të organit ekzekutiv të Inspektoratit të Punës, e cila është në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 1, dhe nenit 13 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, ku në mënyrë të qartë përcaktohen detyrimet e shtetit, para së gjithash, për të mbrojtur të drejtat e njeriut përmes sistemit ligjor, për të siguruar një garanci shtesë për individin, kështu që ai në mënyrë efektive t'i gëzojë këto të drejta. Kështu, neni 13 i garanton individit një ankesë efektive juridike përpara autoriteteve lokale, për

arsye të shkeljes së të drejtave të tij, ndërkohë që neni 6 parashikon shqyrtimin e çështjes në brenda një afati të arsyeshëm. Duke pasur parasysh se vendimi i autoritetit ekzekutiv të Inspektoratit të Punës është ekzekutiv dhe i detyrueshëm, dhe i njëjti deri tani nuk është zbatuar nga ana e Komunës së Parteshit, Avokati i Popullit në këtë rast konkludon se me veprimet e saj ka ardhur deri te shkelja e të drejtave të njeriut të ankuesit.

Në këtë raport, Avokati i Popullit i ka dërguar Kryetarit të Komunës së Parteshit një rekomandim që të marrë masa urgjente për të zbatuar vendimet e autoritetit ekzekutiv të Inspektoratit të punës Nr. 9 / 442 i dt. 15 prill 2015.

Më 29 dhjetor 2015, IAP ka marrë përgjigje në raportin e publikuar të Drejtorit të Administratës të Komunës së Parteshit ku thuhet se më 02 dhjetor 2015 komuna ka iniciuar kontest administrativ kundër Inspektoratit të Punës për këtë lëndë para Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për kontestet administrative, dhe do të veprojë në përputhje me vendimin e gjykatës i cili ende nuk është marrë. Komuna e Parteshit nuk ka vepruar në përputhje me rekomandimin e Avokatit të Popullit.

#### **2.14. Ankesa nr.189/2015 Shaban Jashari kundër PK në Gjakovë në lidhje me të drejtën për jetë**

Më 03 nëntor 2015, Avokati i Popullit ka publikuar raport lidhur me të drejtën për jetë në rastin e Sh. J. , duke iu referuar mungesës së një hetimi efikas të PK në Gjakovë në lidhje me zhdukjen e djalit të ankuesit, si dhe pohimin e ankuesit se PK në Gjakovë ka kontribuar në zhdukjen e djalit të tij.

Më 31 Janar 2015, Policia e Kosovës pas lajmërimit nga fqinjët hyri në banesë ku e mori djalin e ankuesit dhe e dërgoi në Klinikën Psikiatrike në Gjakovë. Djali i ankuesit që nga viti 1992 është diagnostifikuar me "Schizophrenia Psychosis" Në ditën e ndalimit ai ishte i vetëm në banesë kur i theu dritaret dhe kjo ishte arsyeja e ndalimit policor . PK pa vendim gjykate personin e përmendur e vendosi në Klinikën Psikiatrike, dhe për këtë çështje paraprakisht nuk i informoi prindërit. Më datën 1 shkurt 2015, pas hospitalizimit dhe terapisë së marrë, djali i ankuesit pa u vënë re u arratis nga Klinika Psikiatrike dhe u largua në drejtim të panjohur. As personeli i Klinikës dhe as policia nuk ishin në gjendje të jepnin asnjë shpjegim në lidhje me largimin e tij.. Ankuesi pretendon, gjithashtu, se policia sipas mendimit të tij ka kontribuar me qëllim për zhdukjen e djalit të tij me zhvillimin e keq të hetimit, si dhe duke injoruar rastin aktual.

Avokati i Popullit në raportin e tij për këtë rast vjen në përfundimin se ankesa e ankuesit është e justifikuar dhe e ligjshme. Në rastin konkret ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, sepse policët me vet faktin se, tashmë personin e humbur e kanë dërguar në mjekim të detyrueshëm psikiatrik pa një vendim gjykate, kanë vepruar në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe legjisllacionin në fuqi.

Gjithashtu, raporti i Avokatit të Popullit ka konstatuar se institucioni shëndetësor i cili e ka pranuar në trajtim një person me sëmundje mendore nuk i ka ofruar atij ndihmën e nevojshme profesionale, sepse pas pranimit të tij në institucionin shëndetësor deri në zhdukjen e tij nga institucioni, ai nuk është vizituar nga ndonjë psikiatër, por vetëm nga personeli kujdestar medicinal. Fakti shqetësues është se si rezultat i trajtimit joadekuat dhe kontrollit të dobët të pacientit, erdhi deri te arratisja e tij nga ky institucion, edhe atë pa u vënë re. Gjatë hetimeve në lidhje me këtë rast, IAP ka konstatuar se në Institucionin Psikiatrik të cekur edhe më parë ka pasur raste tjera që janë larguar nga institucioni, pa lejen paraprake të mjekëve, dhe nga pacientët të cilët janë të sëmurë mendërisht.

Avokati i Popullit në këtë raport arriti në përfundim se autoritetet përgjegjëse shtetërore kanë dështuar për të marrë masa në lidhje me detyrimet pozitive, ose për të mbrojtur pacenueshmërinë e integritetit fizik dhe psikologjik të një personi, veçanërisht në rastet kur integriteti dhe jeta e njeriut është e kërcënuar.

Kur bëhet fjalë për bashkëpunim e PK me IAP, Avokati i Popullit në raport ka konstatuar se mosdorëzimi i një kopje të dosjes së lëndës nga ana e policisë me kërkesën e IAP, është veprim anti-kushtetues dhe anti-ligjor. Gjithashtu, pamundësia e IAP të ketë qasje në dosjen e policisë për lëndën e djalit të humbur të ankuesit i ka pamundësuar IAP që të verifikoj pretendimet për shkelje tjera të të drejtave të personit të zhdukur të cilat ankuesi në ankesën e tij i ka cekur dhe për të cilat pretendon të kenë ndodhur.

Avokati i Popullit në lidhje me raportin e mësipërm i ka bërë rekomandime Policisë së Kosovës që në përputhje me përgjegjësitë dhe kompetencat që dalin nga ligji, dhe në bashkëpunim me të gjitha agjencitë e tjera të sigurisë (duke mos përjashtuar ato të inteligjencës, si dhe ndihmën ndërkombëtare) të marrë masa urgjente për të gjetur personin e zhdukur. Si dhe, në përputhje me përgjegjësitë dhe kompetencat ligjore, të bëjë rritjen e kapaciteteve profesionale të Policisë së Kosovës në lidhje me të drejtën e jetës dhe aspektet procedurale të një hetimi efektiv në raste të tilla.

Avokati i Popullit i ka dhënë një rekomandim Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës që të nxjerrë një udhëzim me shkrim, për të informuar të gjitha stacionet policore dhe njësitë se është obligim dhe detyra e tyre për të bashkëpunuar me IAP si dhe të njëjtit në kërkesë t'i sigurojnë të gjitha informacionet e kërkuara, duke përfshirë kopje të plotë ose të pjesshme të dosjes së lëndës, e cila është në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjin për Avokatin e Popullit.

Avokati i Popullit i ka dhënë rekomandim Ministrit të Shëndetësisë dhe Shërbimit Klinik Spitalor dhe Universitar të Kosovës që Shërbimi Klinik Spitalor dhe Universitar i Kosovës të sjellë një Udhëzim përmes të cilit do të informojë të gjitha institucionet shëndetësore për obligimet dhe përgjegjësitë që kanë kur përballen me shembuj të pranimit të të sëmurëve mendorë kundër vullnetit të tyre, si dhe t'i obligoj institucionet për të vepruar në pajtim me nenet 78 dhe 79 të Ligjit për Procedurë Jashtëkontestimore. Gjithashtu, që Shërbimi Klinik Spitalor dhe Universitar i Kosovës të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme për të forcuar nivelet profesionale dhe etike të stafit, dhe të kërkoj nga punëtorët shëndetësorë që

pacientët t'i trajtojnë me përgjegjësi dhe me profesionalizëm maksimal, duke u ofruar shërbime profesionale shëndetësore dhe duke i mbikëqyrur vizualisht gjatë gjithë kohës së punës derisa këta persona janë në institucionin mjekësor.

Më 01 dhjetor 2015, IAP ka pranuar përgjigje në raportin e publikuar të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës në të cilin e informoi atë për rrjedhën e përgjithshme të hetimit të PK-së në rastin e ankuesit, se janë marrë të gjitha masat e nevojshme të dhëna në rekomandimin e raportit dhe se zhdukja e djalit të ankuesit është raportuar edhe në INTERPOL. Përveç kësaj, PK pas raporteve të Avokatit të Popullit në këtë rast, ka miratuar Rregulloren Nr.01 / 2015 për obligimin e policisë për të bashkëpunuar dhe për t'i siguruar mbështetje IAP në kryerjen e detyrave zyrtare e cila hyri në fuqi më 24 nëntor 2015.

Më datën 04 dhjetor 2015, IAP ka marrë një përgjigje në raportin e publikuar nga Ministri i Shëndetësisë se do të miratohet Ligj për Shëndetin Mendor (i cili në ndërkohë është miratuar dhe ka hyrë në fuqi), i cili do të rregullojë të gjitha ato që Avokati i Popullit i ka dhënë në rekomandimet e tij.

## **2.15. Ankesa nr. 337/2014 Mursel Bytyqi kundër Gjykatës Themelore në Prizren në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore**

Më 22 shtator 2015, Avokati i Popullit ka publikuar raport në lidhje me çështjen e mësipërme në të cilën është konstatuar se Gjykata Themelore në Prizren ka dështuar për të zgjidhur lëndën e ankuesit brenda një periudhe të arsyeshme kohore e që parqet shkelje të të drejtave të ankuesit për gjykim të drejtë sipas paragrafit 1, Nenit 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Rasti i mësipërm ka të bëjë me një padi civile që ishte iniciuar në vitin 2002 në lidhje me vendosjen e të drejtave pronësore dhe kthimin e pronës. Gjykata Themelore në Prizren (aso kohe Gjykata Komunale) për disa vite sjellë disa Aktgjykime të ndryshme të cilat Gjykata e Apelit (aso kohe Gjykata e Qarkut në Prizren), si gjykatë e shkallës së dytë, i anulon dhe i kthen për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, gjë e cila zgjati deri në vitin 2006. Bazuar në veprimet hetimore të ndërmarra nga IAP në këtë rast, vijmë në përfundim se Gjykata Themelore në Prizren, në rastin konkret ka proceduar për herë të fundit në vitin 2012 dhe që nga ajo kohë e deri në publikimin e këtij raporti nuk është ndërmarrë asnjë veprim procedural.

Avokati i Popullit në raportin e tij arriti në përfundimin se e drejta për gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme dhe e drejta për mjete efektive juridike nuk janë plotësuar, dhe se veprimet e tilla janë në kundërshtim me të drejtën e ankuesit për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me nenin 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit 1 i nenit 6 të KEDNJ-së, dhe nenit 10.1 Ligji mbi Procedurën Civile. Në lidhje me këtë janë dhënë rekomandime Gjykatës Themelore në Prizren që të

sigurojë zgjidhjen e rastit të ankuesit pa vonesa të mëtejshme, në përputhje me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane. Avokati i Popullit në lidhje me këtë rast i ka dërguar një rekomandim edhe Këshillit Gjyqësor për të iniciuar hartimin e një instrumenti ligjor që do të përbëjë një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili siguron lehtësim në formë të parandalimit apo kompensimit lidhur me ankesat për zvarritjen e procedurave gjyqësore.

Kopjet e raportit u dërguan në Këshillin Gjyqësor dhe Gjykatën e Apelit.

Më 12 tetor 2015, IAP ka marrë përgjigje në raportin e publikuar të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren, ku ka deklaruar se ata nuk e marrin përgjegjësinë për vonesën e trajtimit të këtij rasti. Në mënyrë të veçantë, në letër thuhet se Gjykata në këtë rast ka caktuar shtatë seanca gjyqësore pasi nga gjykata e atëhershme e Qarkut e Prizrenit dy herë është kthyer lënda për rishqyrtim, dhe deri te vonesat në zgjidhjen e rastit ka ardhur për shkak të numrit të madh të palëve në procedurë, si dhe kompleksitetit të vet çështjes. Në shkresë gjithashtu thuhet se herën e fundit lënda është ndërprerë për shkak të vdekjes së njërit prej prokurorëve dhe në raste të tilla është e nevojshme, në përputhje me Ligjin për Procedurën Civile që trashëgimtarët të marrin përsipër këtë proces, për të cilin trashëgimtarët janë informuar më 04 shkurt 2015, por që nuk kanë marrë asnjë veprim në lidhje me atë që u cek më lart. Bashkë me letër Kryetari i Gjykatës ka bashkangjitur edhe një Aktvendim të cilin e ka lëshuar kjo Gjykatë në lidhje me këtë rast, i cili është lëshuar më 30 janar 2016, pas ndërhyrjes së IAP në lidhje me këtë rast.

## **2.16. Ankesa nr. 305/2015 Alinexhat Zeqiri kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë në lidhje me mosekzekutimin e Aktgjykimit përfundimtar dhe të ekzekutueshëm**

Më datën 06 nëntor 2015, Avokati i Popullit publikoi raport në lidhje me moszbatimin e Aktgjykimit të plotfuqishëm nga Gjykata Themelore në Prishtinë për rastin e Alinexhat Zeqirit, i cili ka të bëjë me riposedimin e pronës së ankuesit dhe disponimin e së njëjtës pa pengesa.

Avokati i Popullit në raportin e tij konstatoi se Gjykata Themelore në Prishtinë nuk ka ndërmarrë masat e duhura për ekzekutimin e Aktgjykimit të formës së prerë, i cili u bë i formës së prerë qysh në vitin 2010. Në lidhje me këtë rast, gjyqtari i procedurës paraprake në letrën e tij dërguar IAP deklaroi se rasti i është caktuar në vitin 2013 dhe Gjykata Themelore në Prishtinë është duke u përpjekur për t'a ekzekutuar Aktgjykimin që nga viti 2011 me prani të Policisë së Kosovës, por për arsye të ndryshme nuk është realizuar ekzekutimi i Aktgjykimit.

Raporti i Avokatit të Popullit ka konstatuar se është shqetësues fakti se nga dita kur Gjykata Themelore në Prishtinë ka bërë përpjekjen e parë, më 28 dhjetor 2011 me praninë e PK të ekzekutoj lëndën, dhe kur ekzekutimi i të njëjtit rast shtyhet për 17 janar 2012, kanë kaluar

më shumë se 3 vite. Për më tepër, deri në datën e publikimit të raportit mbi këtë temë nuk është shënuar ndonjë përpjekje e gjykatës kompetente që në pajtim me ligjin në fuqi t'a përfundoj procedurën e përmbarimit në këtë rast.

Avokati i Popullit, gjithashtu ka konstatuar se ankuesit i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme dhe e drejta në mjete efektive juridike për këtë rast konkret. Duke pasur parasysh se Gjykata Themelore e ka zvarritur dhe vonuar ekzekutimin e lëndës së ankuesit mbi 7 vjet, dhe procedurat e së cilës para Gjykatës kompetente kanë filluar qysh në vitin 2002 dhe ende nuk janë përfunduar krejtësisht deri në datën e publikimit të këtij raport.

Raporti i Avokatit të Popullit ka konstatuar se është shqetësues fakti se një proces gjyqësor që ka zgjatur për më shumë se 13 vjet, si në këtë rast, ka krijuar një situatë të përgjithshme të pasigurisë juridike, ka zvogëluar dhe ka humbur besimin e qytetarëve në drejtësinë dhe sundimin e ligjit. Asnjë mënyrë apo mjet i veçantë juridik nuk ka ekzistuar dhe nuk ka qenë në dispozicion të ankuesit, me anë të të cilit ai do të mund të ankohej në lidhje me zgjatjen e procedurës në shqyrtimin e çështjes duke parashikuar ose duke shpresuar për të arritur ndonjë lehtësim, në formë të parandalimit të padrejtësisë, ose kompensimin e padrejtësisë të cilën e ka përjetuar nga ana e Gjykatës, që paraqet shkelje të një mjeti efektiv juridik sipas nenit 13 të KEDNJ-së.

Në këtë raport, Avokati i Popullit ka rekomanduar Gjykatën Themelore në Prishtinë që të ndër marrë masa urgjente për zbatimin e Aktgjykimit të formës së prerë për lëndën e ankuesit E. nr. 193/2008, datë 18 mars 2008.

Deri në fund të periudhës raportuese IAP nuk ka marrë përgjigje nga Kryetari i Gjykatës Komonale në Prishtinë në lidhje me raportin e publikuar.

### **2.17. Ex officio nr.518/2014 lidhur me regjistrimin e kandidatëve nga kategoritë e dala nga Lufta e UÇK-së në vitin akademik 2014/2015**

Avokati i Popullit më 18 shkurt 2015, ka publikuar raportin me rekomandime për Qeverinë Republikës së Kosovës dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës lidhur me rastin e sipërpërmendur.

Avokati i Popullit ka konstatuar se Vendimet e Senatit të Universitetit të Prishtinës, të datave 30 maj, 26 shtator dhe 16 tetor 2014, për përcaktimin e kriterëve për pranimin e studentëve për vitin akademik 2014/2015, nuk janë në përputhje me ligjin sepse (a) u japin përparësi në regjistrim vetëm disave nga kategoritë që duhet të gëzojnë këtë përparësi sipas ligjit, dhe (b) e japin këtë përparësi në kushte jo plotësisht të barabarta me kandidatët e tjerë.

Avokati i Popullit, lidhur me rastin kishte drejtuar rekomandime për Universitetin e Prishtinës që: nëse mbeten kandidatë nga gjashtë kategoritë e dala nga lufta (veteranët e UÇK-së, invalidët e UÇK-së dhe anëtarët e familjeve të ngushta të veteranëve, invalidëve,

dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së, që ende nuk janë regjistruar, por që kanë fituar të njëjtin numër pikësh sa ndonjë kandidat i suksesshëm në fakultetet ku kanë aplikuar, t'i regjistrojë ata, me kusht të verifikimit të statusit të tyre në përputhje me ligj; Të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbaruar verifikimin e statusit të studentëve aktualë, që janë pranuar falë statusit të tyre si anëtarë të familjeve të dëshmorëve, dhe të marrë masa disiplinore në rast të zbulimit të paraqitjes së informacioneve të falsifikuara gjatë procesit të regjistrimit në Universitetin e Prishtinës.

Kryeministrin dhe ministrin e MASHT që: Të shfuqizojë vendimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, të datës 13 nëntor 2014, për regjistrimin e fëmijëve të kategorive të dala nga lufta; Të mos ndërhyjë në asnjë aspekt të përcaktimit të kriterëve për pranimin e studentëve nga Senati i Universitetit të Prishtinës; Të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar në të ardhmen bashkëpunim adekuat me Avokatin e Popullit, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Avokatin e Popullit, dhe në përputhje me premtimin e vetë kryeministrit Mustafa në fjalimin e tij inaugurues si i nominuar për postin e kryeministrit. Ndërsa Kuvendit të Republikës së Kosovës që: Të ndryshojë nenin 30 të Ligjit Nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili përcakton se: “Përparësia e pranimi në institucionet arsimore publike, në kushte të barabarta, është e drejtë të cilën e realizojnë veteranët luftëtarë dhe anëtarët e ngushtë të familjes së tyre”, duke fshirë pjesën “dhe anëtarët e ngushtë të familjes së tyre”.

Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje në raportin me rekomandim nga Rektori i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, i cili është zotuar se do t'i zbatojë rekomandimet e Avokatit të Popullit për Universitetin e Prishtinës. Përderisa Avokati i Popullit nuk ka pranuar përgjigje nga Kryeministri dhe ministri i arsimit.

## **2.18. Rasti Nr.369/2014 lidhur me zvarritjen e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së z. Sahit Kastrati, z. Rrahman Mazreku dhe z. Agim Hyseini, për mos kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të mosbashkëpunimit të MPMS me Avokatin e Popullit**

Avokati i Popullit më 19 shkurt 2015, ka publikuar Raportin me Rekomandime për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) lidhur me rastin e sipërpërmendur.

Sipas ankuesve, ata janë transferuar në detyrën e re të punës nga punëdhënësi Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), dhe disa herë kishin kërkuar kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, mirëpo kjo nuk ishte realizuar për disa muaj. Më 17 mars 2014, ata sërish kishin parashtruar kërkesë për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, mirëpo pa sukses, sepse autoritetet përkatëse të MPMS-së nuk u kishin dhënë përgjigje dhe ato ende nuk kanë vendosur lidhur me kërkesën në fjalë.

Avokati i Popullit ka konstatuar se mos shqyrtimi i kërkesës së ankuesve, të parashtruar më 17 mars 2014, nga MPMS, përbën shkelje të së drejtës për një proces të rregullt, brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ, si dhe nenet 11, 38.4 dhe 90.1 të Ligjit për Procedurën Administrative.

Avokati i Popullit, lidhur me rastin kishte drejtuar rekomandime Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që: të ndërmarr masatë menjëhershme, për shqyrtimin e kërkesës së z. Sahit Kastrati, z. Rrahman Mazreku dhe z. Agim Hyseini, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, pa zvarritje të mëtejme, bazuar në ligjet e cituara me lart; Trajtimin e rasteve dhe vendosjen meritore, lidhur me kërkesat e ngjashme, për të gjithë kërkuesit, brenda një afati të arsyeshëm kohor, në pajtim me legjislacionin përkatës, të zbatueshëm në Republikën e Kosovës; Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të përgjigjet në letrat e Avokatit të Popullit, të dërguara më 2 shtator 2014 dhe më 22 tetor 2014, si detyrim kushtetues dhe ligjor për bashkëpunim me Avokatin e Popullit. Kuvendit të Republikës së Kosovës i rekomandoi që: Të përdorë autoritetin ligjor dhe kushtetues ndaj organeve të tjera shtetërore, në mënyrë që ato të përmbushin detyrimin e tyre kushtetues dhe ligjor, në raport me kërkesat dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit nuk ka pranuar përgjigje në raportin me rekomandime as pas dërgimit të shkresës përkujtuese më 18 dhjetor 2015.

**2.19. Rastet A. nr. 542/2013 Hafije Bislimi, A. nr. 4/2014 Suzana Caca, A. nr. 85/2014 Xhemajl Ademi kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) lidhur me ankesat për pezullimin e kërkesave për realizimin e të drejtave që burojnë nga Ligji për Statusin e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre Ligjin Nr. 04/L-054**

Avokati i Popullit më 14 korrik 2014, publikoi Raportin me rekomandime lidhur me rastin. Çështja e rastit është ngritur ndarazi nga një numër qytetarësh të cilëve Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimat Civile (DFDIL) ka refuzuar tu pranojë kërkesat për njohje të statusit të familjeve të viktimës civile. Gjatë hetimit të rasteve Avokati i Popullit ka hasur në vendimin 171, të lëshuar më 9.6.2011 nga ish ministri i MPMS-së z. Nenad Rashiq, lidhur me rekomandimet për veprime që duhet ndërmarrë DFDIL-i. Vendimi udhëzon DFDIL-in që numri i paraqitësve të kërkesave për njohjen e statusit sipas Ligjit për Vlerat e Luftës të përmbillet me gjendjen e datës 31 maj 2011 dhe deri në nxjerrjen e “një vendimi të ri politik” nga Ministri i MPMS-së, të mos pranohet asnjë kërkesë e re për njohjen dhe realizimin e asnjë të drejte të përcaktuar me ligj.

Avokati i Popullit ka konstatuar se ka pasur shkelje të së drejtës në mbrojtje e barabartë të të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të



kompetencave publike dhe trajtim të pabarabartë para ligjit në mes të personave që kanë aplikuar para datës 31 maj 2011 dhe të atyre që kanë aplikuar pas kësaj date.

Prandaj, Avokati i Popullit ka rekomanduar që: Ministri i MPMS të ndërmerr masa të menjëhershme për shfuqizimin dhe anulimin e vendimit Nr. 171, të datës 9 qershor 2011; Të nxirret një vendim i ri nga ministri i MPMS, me të cilin do të riparoheshin dëmet e shkaktuara nga pasojat juridike të Vendimit Nr. 17, i datës 9 qershor 2011, në atë mënyrë që njohja e statusit dhe realizimi i të drejtave të zbatohet nga data 31 maj 2011; Ky rekomandim t'u përcillet të gjitha njësive në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të MPMS, për zbatimin e ligjeve në fuqi dhe mundësimin e realizimit të së drejtës së garantuar me Kushtetutë dhe ligj të të gjithë qytetarëve, si dhe mundësimin e shfrytëzimit të mjeteve juridike efektive, pa asnjë dallim.

Avokati i Popullit nuk ka pranuar përgjigje nga ministri i MPMS-së edhe përkundër faktit që Raporti me rekomandime i datës 14 korrik 2014, i është përcjellë MPMS-së më 16 janar 2015 si dhe më 15 dhjetor 2015, kryeministrit dhe MPMS-së u është dërguar një letër përkujtuese lidhur me obligimin autoriteteve publike për tu përgjigjur kërkesave të Institucionit të Avokatit të Popullit.

### III. AKTIVITETET E INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

#### 3.1. Aktivitetet e Grupit për të Drejtat e Fëmijëve

Grupi për të Drejtat e Fëmijëve (GDF) në kuadër të IAP-së është themeluar me qëllim që me kujdes të veçantë t'i mbikëqyr, mbroj dhe hetoj shkeljet e të drejtave të fëmijëve nga autoritetet publike në Kosovë.

GDF gjatë vitit 2015 përveç se ka shqyrtuar ankesat e paraqitura në IAP, ka ndërmarrë edhe aktivitete të tjera në drejtim të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, si dhe të ngritjes së kapaciteteve profesionale.

Më 3 mars 2015, në Prishtinë u mbajt konferenca për prezantimin e hulumtimit "Mos më mbyll derën, jam vetëm një fëmijë!" e organizuar nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF), në të cilën mori pjesë edhe GDF. Në këtë konferencë nga përfaqësues të KOMF u prezantuan edhe të gjeturat e hulumtimit në fjalë, i cili i referohej situatës dhe mbrojtjes së fëmijëve në rrezik për të rënë në konflikt me ligjin dhe fëmijëve në konflikt me ligjin pa përgjegjësi penale.

Më 27 mars 2015, GDF mori pjesë në takimin e Këshillit për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijë (KMDF),<sup>123</sup> në të cilin u diskutua plani i veprimit i KMDF për vitin 2015.

Më 30 mars 2015, përfaqësuesi i IAP-së është takuar me nxënës të shkollës së mesme ekonomike në Gjakovë, të cilët i ka informuar edhe për rolin e IAP-së në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut si dhe për mënyrat e adresimit të ankesave në IAP.

Më 24 prill 2015, përfaqësuesi i IAP-së ka biseduar me nxënës të shkollës fillore të mesme të ulët "Mustafa Bakija" në Gjakovë, përveç tjerash, edhe për gjendjen e respektimit të të drejtave të njeriut në shkollën në fjalë.

Më 14 maj 2015, SOS fshatrat e Fëmijëve në kuadër të fushatës 3 vjeçare "Kujdesu për mua" shënuan fillimin e fushatës "Unë jap shpresë" e cila do të zhvillohej me qëllim të ngritjes së vetëdijes së shoqërisë, e në veçanti të institucioneve shtetërore, për të shtuar përpjekjet dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për t'u ofruar mbrojtje adekuate fëmijëve pa përkujdesje prindërore si dhe familjeve në përgjithësi. Në këtë ngjarje mori pjesë edhe përfaqësuesi i IAP- së.

---

<sup>123</sup> KMDF është themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 25 gusht 2011. Mandati i KMDF ka të bëjë përveç tjerash edhe me definimin e prioritetëve dhe përcaktimin e masave të nevojshme që duhet të ndërmerren me qëllim të përmirësimit të situatës në lidhje me mbrojtjen dhe drejtësinë për fëmijë. Ai përbëhet nga përfaqësues të institucioneve qeveritare dhe jo qeveritare që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve. IAP është pjesë e KMDF në cilësinë e anëtarit vëzhgues.

Më 20-21 maj 2015, në Prizren u mbajt punëtorja për miratimin e fushave prioritare për përpilimin e objektivave strategjike dhe të planit të punës për hartimin e planit strategjik për të drejtat e fëmijëve për periudhën 2015-2019. Në punëtorinë në fjalë nga përfaqësues të institucioneve qeveritare dhe joqeveritare, përfshirë edhe IAP u diskutua për fushat të cilat do të jenë prioritare me rastin e hartimit të strategjisë së re (2015-2019), objektivat që supozohej të realizoheshin si dhe plani i punës për hartimin e saj.

Më 27 maj 2015, GDF mori pjesë në takimin e radhës të KMDF në të cilin u diskutua edhe për nismën për hartimin e Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe praktikën më të mira të qeverisë së Holandës në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

“Të drejtat e fëmijës – në mes të interesave të prindërve dhe detyrimeve të shtetit” ishte tema e diskutimit në konferencën e dhjetë vjetore të Rrjetit të Ombudsmanëve për Fëmijë të Evropës Juglindore (CRONSEE),<sup>124</sup> e cila u mbajt më 28 maj 2015, në Zagreb (Kroaci). Në këtë konferencë mori pjesë edhe GDF. Përfaqësues të ombudsmanëve, anëtarë të CRONSEE, si dhe ekspertë përkatës diskutuan për mënyrën e realizimit të të drejtave dhe interesave të fëmijës atëherë kur duket se interesi i prindërve është në kundërshtim me interesin e fëmijës, si dhe për detyrimet e shtetit për mbrojtjen e mirëqenies së tij.

Më 31 maj 2015, me rastin e shënimit të Ditës së Fëmijëve, përfaqësues të IAP-së nën tendat e vendosura në sheshin kryesor të Prishtinës kanë biseduar me fëmijë për të drejtat e fëmijëve dhe rolin e IAP-së në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, përkatësisht të fëmijëve.

Me 1 qershor 2015, përfaqësues të IAP-së kanë biseduar me fëmijë edhe në lagjen e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptiasve në Fushë Kosovë, të cilët i kanë informuar për rolin e IAP-së në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, në veçanti të grupeve më të cenueshme shoqërore.

Po të njëjtën ditë, përfaqësuesja e IAP-se mori pjesë në “ Debatin për Liritë dhe të Drejtat e Fëmijëve”, të organizuar nga organizata joqeveritare ETEA në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës me qëllim të ngritjes së vetëdijes qytetare rreth rëndësisë dhe respektimit më të madh të të drejtave të fëmijëve.

Nga 10-13 qershor 2015, në Durrës të Shqipërisë, Zyra e Kryeministrit me përkrahjen e Terre des hommes në Kosovë organizoi punëtorinë, në të cilën u diskutua dhe u shqyrtua Projektligji për Mbrojtjen e Fëmijëve. Në këtë punëtori morën pjesë përfaqësues të institucioneve qeveritare, organizatave joqeveritare si dhe të IAP-së.

---

<sup>124</sup>CRONSEE është themeluar në vitin 2006, me qëllim të bashkëpunimit, promovimit dhe këmbimit të përvojave më të mira në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në vendet e Evropës Juglindore. IAP është anëtar i këtij rrjeti prej vitit 2009.

Nga 6-7 gusht, në Pejë u mbajt punëtori për hartimin e platformës së grupit “Respect Our rights” (ROR)<sup>125</sup>, e cila u organizua nga OJQ “Syri i Vizionit” në bashkëpunim me Save the Children. Në këtë punëtori përveç fëmijëve të ROR mori pjesë edhe përfaqësuesja e IAP-së.

Nga 22 - 23 shtator 2015, në Amsterdam të Holandës u mbajt konferenca e nëntëmbëdhjetë e Rrjetit të Ombudsmanëve për Fëmijë të Evropës (ENOC)<sup>126</sup> në të cilën morën pjesë edhe përfaqësues të IAP-së në cilësinë e vëzhguesit. Fokusi i konferencës ishte luftimi i dhunës ndaj fëmijëve dhe roli i ombudsmanëve për fëmijë në këtë betejë.

Në muajin shtator të këtij viti, Save the Children së bashku me IAP kanë filluar realizimin e sondazhit “Zërat e Fëmijëve”, nga i cili do të reflektojnë qëndrimet e fëmijëve kosovarë të moshës 12, 14 dhe 16 vjeç, për të drejtat e fëmijëve në Kosovë. Sondazhi “Zërat e Fëmijëve” do të jetë mjet i dobishëm në diskutime me politikanët, politikëbërësit dhe akterët e tjerë që të vihen në dijeni për pikëpamjet e fëmijëve për fusha të caktuara të të drejtave të njeriut.

Më 14 tetor 2015 në Prishtinë u mbajt konferenca rajonale për fëmijët e rrugës, e organizuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, në bashkëpunim me Terre des hommes dhe Policinë e Kosovës. Nga pjesëmarrësit, përfaqësues të organeve qeveritare dhe joqeveritare nga Shqipëria dhe Kosova, përfshirë edhe IAP, u diskutua, përveç të tjerave, edhe për bashkëpunimin ndërqeveritar lidhur me fëmijët e rrugës.

Në kuadër të fushatës “*Java kundër dhunës ndaj fëmijëve*” më 22 tetor 2015, në Prishtinë u mbajt konferenca “Çka ka bërë apo duhet të bëjë shteti në mbrojtjen e fëmijëve” e organizuar nga OJQ “Syri i Vizionit” në bashkëpunim me Save the Children. Në këtë konferencë nga përfaqësues të institucioneve shtetërore, IAP dhe OJQ u prezantuan aktivitetet e ndërmarra në parandalimin e dhunës në institucionet shkollore, u diskutua për nevojën e kompletimit të legjislacionit që rregullon fushën e mbrojtjes së fëmijëve, si dhe për atë që zëri i fëmijëve të dëgjohej gjithëherë, për çështjet që kanë të bëjnë me ta.

Më 28 tetor 2015, në Osijek të Kroacisë u mbajt takimi tematik i Rrjetit të Ombudsmanëve të Evropës Juglindore, në të cilën morën pjesë edhe përfaqësuesit e IAP-së. Tema kryesore e diskutimit i referohej Protokollit të tretë fakultativ të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe mundësitë që u ofron atyre për të parashtruar ankesat në Komitetin për të Drejtat e Fëmijës, kur të drejtat e tyre cenohen dhe institucionet e brendshme shtetërore nuk u ofrojnë mbrojtjen përkatëse.

---

<sup>125</sup>Grupi ROR është themeluar në kuadër të zhvillimit të projektit të organizatës Syri i Vizionit dhe organizatës Save the Children, në fushën e programit CRG (Qeverisja për të drejtat e fëmijës). Grupi përbëhet nga 24 fëmijë nga 10 qytete të Kosovës. Fëmijët janë të moshave 14 deri në 17 vjeç, nga grupet e ndryshme etnike apo me aftësi të kufizuara.

<sup>126</sup>ENOC është themeluar më 1997 nga 42 institucione të pavarura që merren me të drejtat e fëmijëve nga 34 shtete të Evropës. ENOC është themeluar me qëllim të inkurajimit të zbatimit të plotë të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, këmbimit të informatave, qasjeve dhe strategjive si dhe për të promovuar zhvillimin e institucioneve të të drejtave të fëmijëve.

Më 18 nëntor 2015, në kuadër të programit "Qeverisja për të Drejtat e Fëmijës" në Prishtinë është mbajtur konferenca për shënimin e Ditës Universale të Fëmijëve, e organizuar nga OJQ "Syri i Vizionit" në bashkëpunim me Save the Children, në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve qeveritare, shoqërisë civile, mediave si dhe të IAP-së. Në këtë konferencë, përveç tjerash, nga pjesëmarrësit janë diskutuar edhe të arriturat në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve.

Në shënimin e përvjetorit të njëzetë të pranisë së UNICEF-it në Kosovë, që u shënuar më 20 nëntor 2015, mori pjesë edhe IAP. Me këtë rast përfaqësues të UNICEF-it dhe partnerë të tjerë të përfshirë para pjesëmarrësve shpalosën aktivitetet dhe punën e UNICEF-it përgjatë viteve në përparimin e të drejtave të fëmijëve, si dhe në përmirësimin e shëndetit dhe të mirëqenies së tyre, pa dallim, në shumë fusha të jetës.

Gjatë muajit nëntor dhe dhjetor 2015, IAP ka zhvilluar fushatën informuese "Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit" për nxënës të shkollave fillore të mesme dhe të larta, lidhur me rolin e IAP-së në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Qëllimi kryesor i organizimit të fushatës ka qenë informimi i nxënësve për rolin e IAP-së në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, si dhe për mundësitë që për shkeljet e të drejtave të njeriut, t'i drejtohen IAP-së.

Qëllim tjetër i fushatës ka qenë edhe ofrimi i mundësive fëmijëve që të dëgjohen nga përfaqësuesit e IAP-së, përkatësisht që të shprehin mendimet, qëndrimet apo shqetësimet e tyre, për probleme të ndryshme me të cilat ata ballafaqohen çdo ditë, jo vetëm në shkollë, por edhe në rrugë e gjetiu.

Në kuadër të fushatës fëmijët janë njoftuar edhe për platformën elektronike "Njih të Drejtat Tua"<sup>127</sup> e cila nga 2 dhjetori 2015, ka kaluar në pronësi të IAP-së. Nga nëntori i vitit të kaluar e deri më tani platforma në fjalë është përdorur mbi 30 mijë herë, nga më se 8000 vizitorë. Përdoruesit e platformës janë informuar edhe për IAP dhe mundësinë që nëpërmes të saj të ankohen në IAP në rast se nga institucionet publike u cenohen të drejtat e tyre.

Gjatë kësaj fushate janë vizituar shumë shkolla të fshatrave dhe qyteteve të komunave të Kosovës si të Prishtinës, Gjilanit, Mitrovicës, Ferizajt, Istogut, Gjakovës, Rahovecit, Prizrenit, Dragashit, Mamushës dhe Suharekës.

Më 2 dhjetor 2015, përfaqësuesja e IAP-së dhe përfaqësues të Laboratorit të Inovacioneve të Kosovës (LIK) – UNICEF, morën pjesë në programin e mëngjesit në RTK, në të cilin shikuesit i kanë informuar edhe për platformën elektronike "Njih të Drejtat Tua".

---

<sup>127</sup>Më 20 qershor 2014, IAP dhe UNICEF nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit përkitazi me projektin "Njih të Drejtat Tua", i cili do të realizohet nëpërmjet platformës online: [www.knowyourrights.org](http://www.knowyourrights.org), e cila do t'u mundësojë të rinjve (16- 29 vjet) të mësojnë më shumë për të drejtat e tyre, qasje në informata lidhur me funksionimin e sistemit ligjor në Kosovë, si dhe në adresimin dhe kërkimin e ndihmës juridike për paraqitjen e ankesave për shkelje të të drejtave të njeriut.

Më 2 dhjetor 2015, IAP në bashkëpunim me LIK, në Prishtinë organizuan lansimin publik të platformës “Njih të Drejtat Tua”, në të cilën morën pjesë palët kryesore të interesit në nivel qendror dhe lokal, të rinj dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Më 4 dhjetor 2015, përfaqësuesja e IAP-së mori pjesë në programin e pasdites në RTV 21 në të cilin u diskutua për platformën elektronike “Njih të Drejtat Tua”.

Më 8 dhjetor 2015, Zyra e UNICEF-it në Prishtinë mbajti takimin plenar për rishikimin e Planit vjetor të UNICEF-it në të cilin ishin të pranishëm institucione qeveritare dhe akterë të tjerë, përfshirë edhe IAP. Në këtë takim u diskutua për rezultatet e arritura për fëmijët gjatë vitit 2015, si dhe për fushat kryesore prioritare të Programit të UNICEF-it, si pjesë e Planit të Punës për vitet 2016-2017.

Më 10-11 dhjetor 2015, në Prishtinë u mbajt trajnimi përkitazi me rëndësinë dhe procedurat e raportimit lidhur me zbatimin në praktikë të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, në të cilën mori pjesë edhe përfaqësuesja e IAP-së. Trajnimi në fjalë ishte organizuar nga UNICEF.

Më 15 dhjetor 2015 përfaqësuesja e IAP mori pjesë në punëtorinë “Reflektim mbi Situatën Aktuale të Tryezave për Menaxhimin e Rasteve - TMR, të Arriturat, Sfidat dhe Vizioni për të Ardhmen” të organizuar nga fondacioni Terre des Hommes. Përveç prezantimit të vlerësimit të kryer lidhur me TMR, nëpërmes punës grupore, të pranishmit identifikuan dhe prezantuan të arriturat, sfidat dhe vizionin e punës së TMR në Kosovë.

Më 21 dhjetor 2015, përfaqësuesja e IAP-së mori pjesë në takimin konsultativ, të organizuar nga ZKM/ZQM në bashkëpunim me UNICEF. Në takim u diskutua për progresin, sfidat dhe mundësitë në realizimin e të drejtave të fëmijëve nga akterët e qeverisjes lokale, rekomandimet e së cilëve do të përdoren për përcaktimin e objektivave strategjike dhe veprimeve që do të ndërmerren gjatë tre viteve të ardhshme, në drejtim të avancimit edhe të qeverisjes së mirë, monitorimit dhe llogaridhënies për fëmijët.

### **3.2. Aktivitetet e Departamentit kundër Diskriminimit**

DKD edhe gjatë këtij viti raportues ka realizuar vizita të rregullta nëpër OJQ-të, të cilat i përfaqësojnë interesat e personave me aftësi të kufizuara, nga të cilët IAP ka pranuar ankesa lidhur me kushtet për qasje të lirë nëpër institucione publike si dhe legjislacionin për persona me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, janë realizuar vizita të rregullta nëpër shkolla fillore dhe të mesme, spitale, vendbanime të banuara me komunitetet, dhe nëpër shtëpitë për të moshuar. Në monitorimin e respektimit të të drejtave të njeriut te personat e vendosur në shtëpitë për të moshuar dhe në institucionet për përkujdesje, gjatë këtij viti është vizituar në baza mujore shtëpia për të moshuar. Gjithashtu gjatë këtij viti është vizituar rregullisht edhe Institucioni Special në Shtime.

Në kuadër të fushatës “Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit”, janë vizituar shkolla nëpër Komuna të Kosovës dhe janë mbajtur ligjëratë lidhur me rolin e Avokatit të Popullit në mbrojtje nga diskriminimi.

Gjatë periudhës raportuese DKD, ka pasur takime me Zyrën për Qeverisje të Mirë, koordinatorë për të drejta të njeriut në nivel lokal dhe qendror.

Përfaqësues të DKD kanë qenë pjesëmarrës në debate publike në mediat audio-vizuele vendore, ku janë trajtuar tema lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe të komunitetit LGBT (Lesbikë, Gei, Biseksual dhe Transgjinjorë).

DKD gjatë këtij viti raportues ka vizituar qendrën burimore “Përparimi” në Prishtinë ku kanë biseduar me nxënës si dhe personelin e shkollës lidhur me të drejtat e njeriut dhe të drejtat e fëmijëve në veçanti.

Duke pas parasysh faktin se Avokati i Popullit me ligjin e ri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është përcaktuar si mekanizëm qendror për trajtimin e rasteve që kanë të bëjnë me diskriminimin, DKD më 2 nëntor 2015, ka mbajtur punëtorinë me temën “Zbatimi i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi - Procedurat dhe Autoritetet përgjegjëse - Avokati i Popullit, Gjyqësori dhe akterët e tjerë - Sfidat dhe Mundësitë.”

IAP në ditën ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut më 10 dhjetor 2015, në mbështetjen e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka organizuar tryezën me temën “Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi në Alfabetin Brail, Procedurat dhe Autoritetet Përgjegjëse - Mandati i Avokatit të Popullit si mekanizëm ankese për trajtimin e rasteve të diskriminimit”. Kjo tryezë ka ofruar mundësinë e diskutimit të përbashkët në mes të Avokatit të Popullit, përfaqësuesve të organizatave joqeveritare të cilat i përfaqësojnë interesat e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë si dhe akterëve të tjerë lidhur mbrojtjen ligjore të personave me aftësi të kufizuara si dhe zbatimin dhe sfidat në zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

DKD, gjithashtu ka qenë pjesëmarrëse si dhe ka dhënë kontribut në takimin Grupit Këshillëdhënës dhe Koordinues në nivel Nacional në Republikën e Kosovës për të drejtat e komunitetit LGBT.

Gjatë këtij viti raportues me ftesë të MBPZHR, përfaqësues të DKD për stafin e nivelit të lartë të punëtorëve të kësaj Ministrie kanë mbajtur një ligjëratë lidhur me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi - Procedurat dhe Autoritetet përgjegjëse - Avokati i Popullit.

### **3.3. Aktivitetet e Njesisë për Barazi Gjinore**

Njësia për Barazi Gjinore, në përputhje me legjislacionin aktual, ka juridiksion të trajtoj dhe të hetoi ankesat lidhur me diskriminimin në bazë të gjinisë. Gjithashtu ajo ka përgjegjësi të rishikoj ligjet dhe të jap komente lidhur me zbatimin e legjislacionit sa i përket çështjeve

gjinore. Përveç analizave ligjore, Njësia për Barazi Gjinore angazhohet edhe në parandalimin dhe monitorimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut në bazë të gjinisë si dhe në aktivitetet e avancimit të parimit të barazisë gjinore.

Në periudhën për të cilën raportohet, NJBGJ ka pranuar ankesa në lidhje me diskriminimin në gjini, në fushën e punësimit, edukimit, pronësisë dhe shëndetësisë. Gjithashtu, një numër i ankesave të cilat janë paraqitur në NJBGJ i janë referuar dhunës në familje, si dhe të drejtës për qasje në sistemin gjyqësor.

Gjatë kësaj periudhe NJBGJ ka mbajtur kontakte të rregullta me përfaqësues ndërkombëtar dhe vendor si dhe me përfaqësues të shoqërisë civile. Bashkëpunimi i kësaj Njësie është realizuar me përfaqësuesit e Agjencia për Barazi Gjinore, UNDP, OSBE, UNIFEM dhe përfaqësues të OJQ-ve të ndryshme.

NJBGJ ka bashkëpunuar edhe me Policinë e Kosovës, Qendrat për Punë Sociale dhe Shtëpitë e Sigurta. Bashkëpunimi nuk ka munguar edhe me OJQ të ndryshme si „Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës”, „Norma”, „Qendra Kosovare për Studime Gjinore”, dhe të tjera.

### **3.4. Bashkëpunimi i IAP-it me Shoqërinë Civile,**

#### **3.4.1. Bashkëpunimi me institucionet, organizatat dhe agjencitë ndërkombëtare**

Pjesë e mandatit të IAP-it është edhe bashkëpunimi me shoqërinë civile me qëllim të avancimit, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut. IAP edhe përgjatë vitit 2015 vazhdoi bashkëpunimin me shoqërinë civile, organizatat joqeveritare. Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare kishte të bënte përveç tjerash edhe me çështje të mbrojtjes nga diskriminimi, të drejtave të komuniteteve, dhunës gjinore, lirisë së informimit si dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, për të cilat fusha mund të informoheni edhe në pjesët ku flitet për aktivitete të grupeve të veçanta. Ky bashkëpunim konsistoi kryesisht në pjesëmarrjen e OJQ në aktivitetet e IAP, të realizuara me qëllim të promovimit të të drejtave të njeriut, pjesëmarrjen e IAP-it në punëtoritë dhe aktivitetet e organizuara nga OJQ, për adresimin e çështjeve të ndryshme të të drejtave të njeriut, si dhe në të ndihmuarit e OJQ-ve në realizimin e projekteve të veçanta apo të përbashkëta me to.

Përfaqësuesit e IAP ishin pjesë e takimeve konsultative, të mbajtura gjatë vitit 2015, në finalizimin e Projekt-rregullores për standardet minimale për procesin e konsultimit me publikun, të organizuara nga Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit në bashkëpunim me OSBE. Qëllimi, i hartimit të dokumentit në fjalë kishte të bënte me realizimin e objektivit strategjik të Qeverisë lidhur me bashkëpunimin me Shoqërinë Civile 2013 – 2017, si dhe me fuqizimin dhe përfshirjen e shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit, që derivon nga kjo strategji.



Më 19 qershor 2015, përfaqësuesit e IAP morën pjesë në tryezën e organizuar nga UNHCR – QKRMT, me temën, “ Udhëzuesi i UNHCR-së mbi Kriteret dhe Standardet e Zbatueshme në lidhje me Mbjajtjen e Azilkërkuesve dhe Alternativat e Mbjajtjes” në të cilën pjesëmarrësit përveç tjerash u informuan në detaje për përmbajtjen e tij.

Më 29 shtator 2015, përfaqësuesit e OJQ “Sun flowers” dhe “Shëndet për të gjithë” - “Health for all” (HFA) nga Fushë Kosova, të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, vizituan IAP. Qëllimi i kësaj vizite ishte njoftimi i OJQ-ve mbi mandatin e IAP si dhe prezantimi i aktiviteteve të zhvilluara nga këto dy OJQ. Në fokus të bisedës ishte edhe shikimi i mundësive të bashkëpunimit në projekte të përbashkëta në drejtim të vetëdijesimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për të drejtat e njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe konventa ndërkombëtare.

Me 19 - 25 tetor 2015, OJQ-ja “Syri i Vizionit” në Gjakovë, në partneritet me organizatën ndërkombëtare “Save the Children”, organizuan “Javën kundër dhunës ndaj fëmijëve”. Në kuadër këtyre aktiviteteve në Teatrin e Gjakovës është dhënë edhe shfaqja me titull “Kur kam të drejtë, kam..!” në të cilën morën pjesë përfaqësues të të institucioneve qeveritare, OJQ-ve, nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, prindër, mësime dhe përfaqësues të IAP-së. Porosia e kësaj shfaqjeje i referohej ndalimit të dhunës ndaj fëmijëve.

Me 20 tetor 2015, në Prishtinë u mbajt ceremonia e ndarjes së bursave për rreth 500 nxënës të shkollave të mesme të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, në Prishtinë, në të cilën morën pjesë edhe përfaqësuesit e IAP. Programi i ndarjes së bursave për vitin shkollor 2015/2016, u mbështet nga “Roma Education Fund” në Budapest, “Swiss Office for Cooperation”, “Swiss Foundation HEKS”, Ambasada Britaneze në Prishtinë, Ambasada Norvegjeze në Kosovë në bashkëpunim me MASHT-in dhe OJQ Voice of Roma, Ashkali and Egyptians (VoRAE) me seli në Graçanicë.

Më 2 dhjetor 2015, nga Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), në mbështetje të OSBE është organizuar Tryeza me temën “Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës” në të cilën morën pjesë përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë, MPMS, Këshillit të Evropës, OJQ dhe të tjerë.

Qëllimi i mbajtjes së kësaj tryeze ishte, përveç tjerash, informimi për mandatin dhe rolin e këtij mekanizmi në parandalimin e torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.

Më 14 dhjetor 2015, në Gjakovë u mbajt tryeza e rrumbullakët, e organizuar nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKK) në Gjakovë për të drejtat e komuniteteve me temën: “Komunitete mësoni dhe ushtroni të drejtat tuaja”, në të cilën përveç përfaqësuesve të institucioneve qeveritare dhe të organizatave joqeveritare morën pjesë edhe përfaqësues të IAP. Në këtë tryezë është diskutuar për problemet me të cilat përballen komunitetet pakicë, në veçanti është theksuar nevoja e përmirësimit të standardit jetësor të tyre, nivelit të arsimit, punësimit, si dhe të kushteve shëndetësore si dhe integritit të tyre në shoqëri.

Me 15 dhjetor 2015, përfaqësuesi i IAP-së mori pjesë në promovimin e veprës “*Monografia për personat e rrëmbyer dhe të zhdukur gjatë luftës në Kosovë, Gjakovë, 24 Mars 1999 - 12 Qershor 1999*”, të përgatitur dhe të botuar nga shoqata “Thirrjet e Nënave” me seli në Gjakovë.

Më 16 dhjetor 2015, OJQ- “Thirrjet e Nënave” në bashkëpunim me OJQ “Žensko Pravo”, në Gjakovë në kuadër të projektit “*Hulumtimi dhe monitorimi i institucioneve publike rreth zbatimit të Ligjit për Familjen në Kosovë*”, mbajtën punëtorinë në të cilën u prezantua broshura me të dhënat mbi nivelin e zbatueshmërisë së Ligjit për Familjen në Kosovë. Pjesë e punëtorisë ishte edhe IAP.

Më 21 dhjetor 2015, u mbajt tryeza e diskutimit me temën: “*Trajtimi i rasteve në procedurën e lirit me kusht*”. Në këtë tryezë morën pjesë përfaqësuesi të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Panelit për Lirim me Kusht (PLK), Shërbimit Korrektuese e Kosovës, Zyrës ligjore të Ministrisë të Drejtësisë, Shërbimit Sprovues të Kosovës (SHSK), Qendrave Korrektuese, Qendrave të Paraburgimit, shoqërisë civile, të EULEX-it, përfshirë edhe IAP. Qëllimi i organizimit të kësaj tryeze, ishte diskutimi për punën e PLK, sfidat me të cilat ballafaqohet ai, bashkëpunimi me aktorët e tjerë të kyçur në proces, procesi i përcjelljes së dosjeve, radhitja e tyre, etj.

Më 23 dhjetor 2015, në Prishtinë, u mbajt tryeza e diskutimit me temën: “*Heqja e zotësisë së veprimit për persona me aftësi të kufizuara mendore- ngecje në zhvillimin mendor*”, e organizuar nga IAP në mbështetje të OSBE.

Qëllimi i organizimit të tryezës përveç tjerash ishte prezantimi i hulumtimit të IAP-së lidhur me vendimet gjyqësore për heqjen dhe kthimin e zotësisë për të vepruar, personave me aftësi të kufizuara mendore - ngecje në zhvillim mendor, rezidentë në institucionet e menaxhuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Në këtë punëtori morën pjesë institucione dhe organizata që trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me strehimin, monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave personave me aftësi të kufizuara mendore - ngecje në zhvillimin mendor.

Më 16 dhjetor 2015, në Prishtinë nga OSBE Misioni në Kosovë, është organizuar takimi me përfaqësues të shoqatave të gazetarëve, institucioneve të mediave, institucioneve të zbatimit të ligjit, institucioneve të drejtësisë, si dhe organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, përfshirë edhe përfaqësuesit e IAP.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi për sfidat e lirisë së shprehjes, lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve, në funksion të gjetjes së zgjedhjes në mënyrë që gazetarët të përmbushin pa pengesa detyrat e tyre, përfshirë këtu edhe trajtimin përkatës nga punëdhënësit dhe respektimin e kontratave dhe kushteve të punës, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Më 25 dhe 26 nëntor 2015, në Prishtinë është mbajtur samiti për romët, i organizuar nga organizata Civil Rights Defenders, në të cilën është diskutuar për mundësitë e përfshirjes së romëve në shoqëri, në Ballkanin Perëndimor.

Në këtë samit ndër të tjera është folur për zbatimin e pamjaftueshëm të Ligjit për Shërbimin Civil në Kosovë, sa i përket komuniteteve pakicë, i cili i obligon institucionet shtetërore që se së paku 10% të shërbyesve civil t'i rekrutojnë nga komunitetet jo shumicë. Në këtë drejtim në veçanti komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian janë lënë anash. Është bërë thirrje për integrimin më të madh të tyre si dhe për zbatimin përkatës të legjislacionit që ka të bëjë me këto komunitete.

Më **10 dhjetor 2015**, në Konferencën Rajonale "Multikulturalizmi, Ndërkulturalizmi dhe Të Drejtat e Njeriut" e organizuar nga Qendra e Kosovës për Arsim (KEC) në bashkëpunim me **DVV International** (Deutscher Volkshochschul-Verband) – Zyra në Kosovë. mori pjesë edhe përfaqësuesi e IAP në cilësinë e anëtarit të panelit. Në këtë konferencë nga të pranishmit u diskutua për rëndësinë e multikulturalizmit dhe ndërkulturalizimit në shoqëritë me shumë komunitete, si dhe u prezantuan të arriturat dhe praktikat më të mira nga rajoni.

Gjate vitit raportues IAP ka pas bashkëpunim të mirë edhe me **OJQ të mediave**. Me qëllim të avancimit të bashkëpunimit në promovimin e punës, përfaqësues të IAP, kanë vizituar radio stacionet lokale "Vizioni" dhe "Llapi" në Podujevë, TV Mitrovicën në Mitrovicë, radio "Vicianum" në Vushtëri, radio-televizionin "Besa" në Prizren, radio "Graçanica" në Graçanicë, dhe televizionin "Vali" në Gjilan.

### 3.5. Bashkëpunimi ndërkombëtar

IAP si institucion i pavarur kushtetues për të drejtat e njeriut në Kosovë është i përkushtuar që të veprojë si urë lidhëse në shkëmbimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, prandaj një nga prioritetet e tij ka vazhduar të jetë edhe bashkëpunimi me institucionet homologe dhe organizata të tjera ndërkombëtare për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

Ndër vite ka ekzistuar një interes i shtuar ndërmjet organizatave ndërkombëtare, sidomos e Këshillit të Evropës dhe Kombeve të Bashkuara, në forcimin e institucioneve të Ombudsmanëve si mekanizma institucional për garantimin e të drejtave të njeriut. Prandaj, me qëllim të arritjes së këtij synimi, këto organizata dhe institucione ndërkombëtare kanë zhvilluar shumë aktivitete, takime e konferenca ndërkombëtare, në të cilat edhe Institucioni i Avokatit të Popullit ftohet dhe jep kontributin e tij në diskutimet e frytshme të kuadër të tyre.

Këto takime, të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, kanë shërbyer për avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe rrjetëzimin e tij në arenën ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut.

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Data
1.	<i>Kongresi Botëror për Drejtësinë për të Mitur Gjenevë, Zvicër</i>	26-30 janar 2015
2.	<i>Takimi i Dialogut të Stabilizim Asociimit për Kosovën</i>	27-29 janar 2015

	Bruksel, Belgjikë	
3.	<i>Takimi vjetor i ICC Gjenevë, Zvicër</i>	10-13 mars 2015
4.	<i>Takimi për shkëmbimin e përvojave në mes anëtareve Paris, Francë</i>	2 prill 2015
5.	<i>Takimi i komunikimit ndërmjet rrjeteve ndërkombëtare dhe publikut Vjenë, Austri</i>	4-5 maj 2015
6.	<i>Konferenca për parandalimin e torturës Hagë, Holandë</i>	8 maj 2015
7.	<i>Konferenca e CRONSEE për të drejtat e fëmijëve Zagreb, Kroaci</i>	28-29 maj 2015
8.	<i>Seminar për Dimensionin e të drejtave të Njeriut dhe Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut Varshavë, Poloni</i>	1-3 qershor 2015
9.	<i>Takimi i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut në kuadër të Ditëve Evropiane të Zhvillimit Bruksel, Belgjikë</i>	4-5 qershor 2015
10.	<i>Punëtorin e NPM-ve të rrjetit të rajonit të Evropës Juglindore (SEE), për kujdesin shëndetësor të personave të privuar nga liria Tiranë, Shqipëri</i>	29-30 qershor 2015
11.	<i>Seminar i ekspertëve të Ombudsmanëve në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara Varshavë, Poloni</i>	13-15 shtator 2015
12.	<i>Simpoziumi i tretë ndërkombëtar për Institucionet e Ombudsmanëve Ankara, Turqi</i>	16-17 shtator 2015
13.	<i>Asambleja e Përgjithshme e Institutit Evropian të Ombudsmanëve Mainz, Gjermani</i>	20-21 shtator 2015
14.	<i>Konferenca e 19-të vjetore e Rrjetit Evropian të Ombudsmanëve për Fëmijë(ENOC) Amsterdam, Holandë</i>	22-23 shtator 2015
15.	<i>Kongresi i 9-të i Asamblesë së Përgjithshme të AOMF-së Quebek, Kanada</i>	13-15 tetor 2015
16.	<i>Konferenca “ Monitorimi i implementimit të Konventës së Stambollit: Sinergjitë e reja” Sarajevë, Bosnje</i>	20 tetor 2015
17.	<i>Takimi i Grupit Punues për Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara Zagreb, Kroaci</i>	26-27 tetor 2015
18.	<i>Konferenca e 7-të ndërkombëtare të institucioneve të Ombudsmanëve për forca të armatosura Pragë, Çeki</i>	25-27 tetor 2015
19.	<i>Takimi i CRONSEE për Protokollin Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve- Roli i Ombudsmanëve për Fëmijë Osijek, Kroaci</i>	27 tetor 2015
20.	<i>Punëtori lidhur me ndalimin e migrantëve, kthimin e migrantëve dhe trajtimin e dështuar të azilkërkuësve në Evropës Juglindore Tiranë, Shqipëri</i>	29-30 tetor 2015

21.	<i>Punëtorja me shumë-perfitues lidhur me rolin e institucioneve të Ombudsmanëve për mbrojtjen e të drejtave të migranteve</i> Tiranë, Shqipëri	12-13 nëntor 2015
22.	<i>Seminari “ Roli i Ombudsmanit në demokracinë moderne parlamentare- një perspektivë regjionale ”</i> Bruksel, Belgjikë	18-19 nëntor 2015
23.	<i>Konferenca e Beogradit për rolin NHRI ne mbrojtjen e refugjateve dhe emigrantëve</i> Beograd, Serbi	23-24 nëntor 2015
24.	<i>Asambleja e Përgjithshme e ENNHRI</i> Utrecht- Holandë	30 nëntor- 1 dhjetor 2015
25.	<i>Vizitë studimore për shkëmbimin e praktikave më të mira në mbrojtjen nga diskriminimi dhe parandalimin e torturës</i> Paris, Francë	7-10 dhjetor 2015

***Tabela 1 Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare***

### **3.5.1. Bashkëpunimi me homologë dhe organizata të tjera ndërkombëtare**

Bashkëpunimi me homologë dhe organizata të tjera ndërkombëtare në Kosovë dhe jashtë saj, është shumë i rëndësishëm për Institucionin e Avokatit të Popullit, prandaj në këtë kuadër, edhe në vitin 2015, janë realizuar disa aktivitete të përbashkëta.

Vlen të përmendet që një bashkëpunim shumë të mirë kemi me të gjitha vendet në rajon, e në veçanti me Avokatin e Popullit në Shqipëri, me të cilin ka kohë që e kemi të formalizuar këtë bashkëpunim edhe përmes nënshkrimit të një memorandumit. Meqenëse, Parlamenti i Republikës së Kosovës, në korrik të viti 2015, zgjodhi z. Hilmi Jashari si Avokat i Popullit, ndër vizitat e para për të uruar, ishte ajo e z. Igli Totozani, Avokatit të Popullit të Shqipërisë. Përveç kësaj, Avokati i Popullit të Kosovës me bashkëpunëtor, kanë marrë pjesë edhe në dy punëtori të organizuara në Shqipëri, njëra lidhur me punën e mekanizmit kundër torturës në Evropën Juglindore dhe tjetra lidhur me rolin e institucioneve të Ombudsmanëve për mbrojtjen e të drejtave të migrantëve.

Bashkëpunim tjetër i mirë po vazhdon të jetë edhe me Ombudsmanin e Turqisë, i cili çdo vit organizon një simpozium ndërkombëtar, në të cilin ftohet edhe Avokati i Popullit të Kosovës. Këtë vit simpoziumi kishte për qëllim krijimin e një platforme diskutimi për praktikën më të mira dhe mësimet e mësuara për funksionimin e efektshëm të institucioneve të Ombudsmanëve në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare dhe praktikën evropiane.

Meqë në korrik të vitit 2015, hyri në fuqi pakjoja e ligjeve për të drejtat e njeriut<sup>128</sup>, edhe këtë vit ka vazhduar një bashkëpunim shumë i mirë me Ombudsmanin e Francës dhe në

<sup>128</sup> Pakon ligjore për të drejtat e njeriut e përbëjnë Ligji për Avokatin e Popullit, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ligji për Barazi Gjinore

kuadër të këtij bashkëpunimi, me mbështetjen financiare të Ambasadës së Francës në Kosovë dhe Instrumentit TAIEX, Avokati i Popullit dhe pesë bashkëpunëtore të tij, në dhjetor të vitit 2015, morën pjesë në një vizitë studimore që kishte për qëllim shkëmbimin e përvojave më të mira lidhur me trajtimin e rasteve kundër diskriminimit dhe punën dhe funksionimin e Mekanizimit Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Gjatë kësaj vizite, delegacionin e priti homologu francez z. Jacques Toubon, të cilët biseduan për mandatin dhe përgjegjësitë që kanë, sfidat me të cilat përballen dhe perspektivat e punës që bëjnë. Me qëllim të vazhimit të bashkëpunimit edhe në të ardhmen, z. Jashari, Avokati i Popullit e ftoi z. Toubon për një vizitë në Kosovë, gjatë vitit të ardhshëm, me qëllim të sjelljes së përvojave të Francës në Kosovë, sidomos në çështje që ndërlidhen me bashkëpunimin me parlamentin dhe institucione të tjera publike si dhe përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve. Një ditë e kësaj vizite iu kushtua edhe parandalimit të torturës dhe praktikave të punës në Francë dhe për një ditë të tërë qëndruam tek Kontrollori i Përgjithshëm i vendeve të privimit nga liria, i cili vepron si mekanizëm për parandalimin e torturës atje.

Bashkëpunim i mirë ekziston edhe me institucione të tjera homologe në rajon dhe më gjerë, me të cilat Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës është në komunikim të përhershëm për çështje të interesit të përbashkët.

Bashkëpunim shumë të mirë, IAP ka edhe me organizata dhe zyra të huaja që veprojnë në Kosovë, të cilat kanë qenë partner i përhershëm mbështetës dhe të cilët e kanë ndihmuar IAP me projekte të ndryshme, që kanë pasur për qëllim fuqizimin e tij, ngritjen e kapaciteteve të stafit dhe funksionimin e përgjithshëm efektiv.

Një nga këto organizata është edhe Këshilli i Evropës, i cili ka filluar projektin me titull *”Mbështetje në zbatimin e standardeve evropiane për të drejtat e njeriut në Kosovë”*, në të cilin një nga përfituesit është edhe Institucioni i Avokatit të Popullit, për të cilin janë të dedikuara një sërë seminaresh, trajnimesh dhe fushata vetëdijesuese, të cilat pritet të kenë ndikim të padiskutueshëm në ngritjen e kapaciteteve dhe realizimit më të mirë të mandatit.

Po ashtu Qeveria zvicerane, përkatësisht Ambasada e Zvicrës në Kosovë, ka vendosur që ta mbështesë Institucionin e Avokatit të Popullit me një projekt të dedikuar specifikisht për të, i cili do të jetë ndihmë e madhe, sidomos gjatë vitit 2016, kur IAP po përballlet me limite financiare për të përmbushur mandatet e reja që i ka dhënë pakoja e ligjeve për të drejtat e njeriut. Projekti përmban aktivitete si angazhimi i këshilltarëve të jashtëm që do të ndihmojnë departamentin e hetimeve, tri tryeza tematike, dy trajnime me tematika për luftimin e nxitjes së gjuhës së urrejtjes dhe tjetra për luftimin e ksenofobisë dhe racizmit, tri manuale për punën me raste të diskriminimit, punën me ankesa dhe punën për monitorimin e vendeve të ndalimit.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), si vitet e mëparshme, ashtu edhe gjatë vitit raportues e ka mbështetur IAP me disa aktivitete si : vlerësimin e organizimit të brendshëm të institucionit përmes angazhimit të një konsulenti të jashtëm, pesë tryeza tematike dhe një konferencë rajonale me fokus në praktikën më të mirë në zbatimin e ligjit kundër diskriminimit. Ndërsa, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të

Drejtave të Njeriut, IAP publikoi Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi në alfabetin Brajl me mbështetjen e OSBE. Ky ligj do t'i mundësoj komunitetit me shikim të dobësuar, një nga grupet më të cenueshme në Kosovë, të mësojnë për të drejtat e tyre si dhe për obligimet që institucionet kanë ndaj tyre.

Po ashtu, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim(UNDP) mbështeti financiarisht edhe punëtorinë me temën “Zbatimi i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi-Procedurat dhe Autoritetet përgjegjëse - Avokati i Popullit, Gjyqësori dhe akterët e tjerë- Sfidat dhe Mundësitë”. Nga kjo tryezë dolën rekomandime shumë të vlefshme për rrugën përpara lidhur me zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe puna e nevojshme nga secila prej institucioneve përgjegjëse.

Në fund, është e nevojshme të theksohet ofrimi i ndihmës nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe zyrat e tjera ndërkombëtare, duke e mbështetur IAP në sfidat dhe problemet me të cilat është përballur.

### 3.5.2. Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe anëtarësimi në mekanizma që merren me të drejtat e njeriut njihet si mjet i rëndësishëm në punën e institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut, meqë ato ofrojnë mundësi të shkëmbimit të informatave dhe zhvillimeve më të reja në botë në fushën e të drejtave të njeriut.

Prandaj, IAP edhe këtë vit ka lajme të mira në këtë drejtim, meqë me datë 15 tetor 2015, në kuadër të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme që u mbajt në Kebek të Kanadasë, u pranua si anëtar në **Asociacionin e Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Frankofonisë (AOMF)**. Ky asociacion u krijua në vitin 1988 dhe sot përbëhet nga 49 institucione anëtare. Roli kryesor i tij është promovimi i rolit të Ombudsmanëve dhe Mediatorëve, si dhe konsolidimi dhe inkurajimi i institucioneve të pavarura që merren më të drejtat e njeriut.

Përveç tij, IAP është i anëtarësuar edhe në mekanizma tjerë ndërkombëtar si:

- Instituti ndërkombëtar i Ombudsmanëve (IOI)<sup>129</sup>
- Instituti Evropian i Ombudsmanëve (EOI)<sup>130</sup>
- Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI)<sup>131</sup>
- Rrjeti i Ombudsmanëve për Fëmijë i Evropës Juglindore (CRONSEE)
- Aderues në *Deklaratën e Sarajevës për bashkëpunim*<sup>132</sup>

<sup>129</sup>Për më shumë informata rreth Institutit Evropian të Ombudsmanëve, vizitoni këtë webfaqe: [www.theioi.org](http://www.theioi.org)

<sup>130</sup>Për më shumë informata rreth Institutit Evropian të Ombudsmanëve, vizitoni këtë webfaqe: [www.eoi.at](http://www.eoi.at)

<sup>131</sup>Për më shumë informata rreth Institutit Evropian të Ombudsmanëve, vizitoni këtë webfaqe: [www.ennhri.org](http://www.ennhri.org)

<sup>132</sup> Kjo deklaratë ka formalizuar bashkëpunimin dhe aktivitetet e të gjitha institucioneve të Ombudsmanëve në regjion. Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë e ka nënshkruar këtë Deklaratë me datën 4 prill 2014.

### 3.5.3. Raportimi në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtar

IAP çdo vit pranon pyetësor të tematikave të ndryshme nga organizata ndërkombëtare për të raportuar për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Edhe këtë vit janë dërguar pesë pyetësor të cilët janë të listuar në tabelën e mëposhtme.

Data	Tema e raportit	Organizata/institucionit të cilit i është dërguar raporti
10 gusht 2015	Qasja në drejtësi për fëmijët	Child Rights International Network (CRIN)
2 shtator 2015	Trajtimi i ankesave dhe zgjedhja e konflikteve	Human Rights Centre- University of Essex
28 shtator 2015	Diskriminimi i komunitetit LGBT	Immigration and Refugee Board of Canada
5 nëntor 2015	Politikat e ndalimit të fëmijëve të huaj në Republikën e Kosovës	Global Detention Project- Switzerland

***Tabela 2 Lista e raporteve të dërguara në organizata ndërkombëtare***

### 3.6. Komunikimi me mediat

Në funksion të ngritjes së vetëdijes dhe promovimit të të drejtave të njeriut, si dhe punës së IAP-së gjatë vitit 2015-të, plasimi i informatave, qëndrimeve apo raporteve, si dhe avokimi në përmbushje të mandatit dhe misionit, është bërë përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit, përfshirë këtu komunikimin e drejtpërdrejtë me publikun, ueb faqen zyrtare, mediat dhe rrjetet sociale. Si i tillë, komunikimi ka qenë intensiv dhe në vazhdimësi, duke përshtatur kanalet e komunikimit në varësi të situatës, mesazhit apo grupit të targetuar për komunikim.

Ueb faqja e IAP-së, ashtu siç edhe faqja dhe profili zyrtar në rrjetin social Facebook, kanë shërbyer si kanale afishimi të materialeve për publikun, përfshirë këtu publikimin e shtatë raporteve lidhur me rastet dhe tre raporteve *ex officio*, të cilat paraprakisht u janë dërguar institucioneve gjegjëse. Po ashtu, gjatë këtij viti, IAP ka publikuar (në kopje fizike dhe në formë elektronike) Raportin vjetor për vitin 2014 dhe Përmbledhjen ekzekutive të statistikave dhe rekomandimeve nga Raporti vjetor për vitin 2014 ( në gjuhën shqipe, serbe, turke, rrome dhe angleze).

Në periudhën raportuese 1 janar – 31 dhjetor 2015, janë plasuar për publikun 57 informata, deklarata, lajme dhe njoftime, përmes postës elektronike, ueb faqes zyrtare të IAP-së dhe profilit e faqes zyrtare të IAP-së në Facebook. Të shpërndara statistikisht sipas muajve, duken si në tabelën e mëposhtme:



	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
2015	2	6	4	2	2	3	4	4	5	13	8	4

**Tabela 3 Shpërndarja e informatave/deklaratave/njoftimeve në ueb faqen e IAP-së**

Gjithashtu, përmes lajmit të shkurtër dhe foto-galerisë, janë bërë të njohura për publikun aktivitete të veçanta, të zhvilluara në periudha të ndryshme të vitit.

Komunikimi i drejtpërdrejtë me mediat, përmes formës elektronike të dërgimit të informatave, deklaratave apo njoftimeve, ashtu si edhe prononcimet e intervistat e drejtpërdrejta, konferencat për shtyp apo mundësitë e pyetje/përgjigjeve në ngjarjet ku IAP ka qenë organizatore apo pjesëmarrëse, kanë qenë disa prej mënyrave të përdorura për avokim dhe transparencë.

Gjatë vitit 2015, janë realizuar 115 paraqitje publike, kryesisht të Avokatit të Popullit, por edhe të zyrtarëve të IAP-së, si përgjigje në kërkesa të mediave dhe gazetarëve për prononcime, intervista, emisione të hapura për pyetje të qytetarëve, debate etj., përmes mediave tradicionale, portaleve elektronike dhe shtypit të shkruar. Këtu nuk përfshihet shpërndarja apo afishimi i të njëjtave nëpër media të tjera, të shkruara, elektronike apo rrjete sociale. Listën e paraqitjeve mediale, sipas medimeve, e gjeni në tabelën e mëposhtme.

<b>PARAQITJET MEDIALE TË SHPËRNDARA SIPAS MEDIUMEVE</b>			
<b>ARTA TV</b>	<b>3</b>	<b>Portali “Te Sheshi”</b>	<b>1</b>
<b>Betimi për Drejtësi</b>	<b>1</b>	<b>Radio “Prosperiteti”, Gjakovë</b>	<b>2</b>
<b>BIRN / Kallxo.com</b>	<b>5</b>	<b>Radio Dukagjini</b>	<b>1</b>
<b>Bota Sot</b>	<b>2</b>	<b>Radio Kosova</b>	<b>6</b>
<b>Express</b>	<b>2</b>	<b>Radio Evropa e Lirë</b>	<b>3</b>
<b>Gazeta Tribuna</b>	<b>1</b>	<b>TV Rrokum</b>	<b>5</b>
<b>Indeksonline</b>	<b>1</b>	<b>RTK 1</b>	<b>7</b>
<b>Infokus</b>	<b>1</b>	<b>RTK 2</b>	<b>5</b>
<b>Jeta n’Kosovë</b>	<b>3</b>	<b>RTK 3</b>	<b>1</b>
<b>Klan Kosova</b>	<b>9</b>	<b>RTV “Besa”, Prizren</b>	<b>1</b>

<b>Koha Ditore</b>	<b>9</b>	<b>RTV 21</b>	<b>3</b>
<b>Kosovapress</b>	<b>3</b>	<b>Top Channel</b>	<b>1</b>
<b>Kosova Sot</b>	<b>5</b>	<b>Toskanapress</b>	<b>1</b>
<b>Kosovo 2.0</b>	<b>1</b>	<b>Tribuna Channel</b>	<b>10</b>
<b>KTV</b>	<b>12</b>	<b>Radio Vala Rinore, Prishtinë</b>	<b>1</b>
<b>Lajmi.net</b>	<b>1</b>	<b>Zëri</b>	<b>4</b>
<b>Qendra Mediale Çagllavicë</b>	<b>1</b>		

**Tabela 4** Lista e paraqitjeve mediale sipas medimeve

Me qëllim të avokimit për zbatimin e të drejtës së qasjes në dokumente publike, lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave dhe Sensibilizimit të zyrtarëve institucional / shoqërisë civile / mediave, mbi rëndësinë e këtyre tre segmenteve nga gama e gjerë e të drejtave të njeriut, në transparencën institucionale dhe në funksionimin e përgjithshëm të demokracisë, gjatë muajit maj është realizuar **Projekti i punëtorive në funksion të transparencës**, në qendrat regjionale ku ndodhen zyrat rajonale të IAP-së dhe në Prishtinë, ku në mënyrë gjithëpërfshirëse kanë marrë pjesë përfaqësues relevant të institucioneve nga pothuajse të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, përfaqësues të organizatave jo qeveritare që zhvillojnë aktivitetet në nivel lokal, si dhe gazetarë nga media lokale. Po ashtu, përmes këtyre punëtorive është avokuar edhe për punën, mandatin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit dhe të Zyrave regjionale, si pjesë e përbërëse e IAP-së.

Me qëllim të intensifikimit të komunikimit dhe të bashkëpunimit të IAP-së me institucione të nivelit qendror dhe atij lokal, në periudhën gusht- dhjetor, janë zhvilluar një varg takimesh, në të cilat ka prezantuar vetë Avokati i Popullit. Gjatë vizitave nëpër qendrat lokale, po ashtu është biseduar edhe me organizata joqeveritare që veprojnë në nivel lokal, ashtu si edhe media lokale.

Në anën tjetër aktivitete të veçanta, si shënimi i 1 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, tryezat me tema specifike, në varësi të palëve përgjegjëse të përfshira, me qëllim diskutimin dhe promovimin e pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut, që kanë hyrë në fuqi në korrik të vitit 2015, apo ngjarje të tjera të organizuara nga IAP, kanë shërbyer për shpërndarjen e materialeve promovuese, përfshirë këtu materiale të shtypura në letër, fanella, kapela, lapsa me logon e IAP-së dhe me moto avokuese për të drejtat e njeriut. Në funksion të informimit të komuniteteve me nevoja të veçanta, një sasi e konsiderueshme e një buletini të veçantë informues, shtypur me alfabetin e Brajlit, në gjuhën shqipe, serbe dhe turke, i është dorëzuar Shoqatës së të Verbërve të Kosovës dhe Shkollës Speciale për të Verbër në Pejë. Gjithashtu, me qëllim të shpërndarjes së materialeve promovuese tek kategori të reja të publikut të gjerë, një sasi Raportesh vjetore dhe buletinësh, nga periudha

të ndryshme disavjeçare të punës së IAP-së, është dorëzuar në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës.

## IV. FINANCIMI

### 4.1. Buxheti i IAP-së

IAP është institucion i pavarur i cili financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës. Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit “*IAP e përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe ia dërgon për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës*”.<sup>133</sup> Po sipas kësaj dispozite ligjore, IAP-së i sigurohet buxhet i nevojshëm “*pavarësisht nga dispozitat e ligjeve të tjera*”.<sup>134</sup>

### 4.2. Financimi i IAP-së nga Buxheti i Republikës të Kosovës

Duke u bazuar në procesin ligjor të përgatitjes dhe dorëzimit të kërkesës së rregullt buxhetore, Avokati i Popullit sikurse edhe viteve paraprake edhe këtë vit i ka parashtruar kërkesën buxhetore, Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kërkesa buxhetore e Avokatit të Popullit për vitin 2015 është ndërtuar mbi bazën e planit të punës dhe të aktiviteteve të planifikuara të IAP-së. Ndarja buxhetore nuk është bërë në përputhje me kërkesën e Avokatit të Popullit, por duke marrë për bazë ndarjen buxhetore për vitin 2014.

Aq më tepër, buxheti i IAP-së për vitin buxhetor 2015 është shkurtuar në korrik 2015 në shumën prej 112,037.00 € në bazë të Ligjit Nr. 05/L-046 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës të Kosovës. Ky shkurtim i buxhetit është bërë në kategoritë buxhetore: Paga dhe Mëditje, në shumën prej 50,695.00 € dhe për Mallra dhe Shërbime, në shumën prej 61,343.00 €.

Pasqyrimi i gjendjes, shkurtimeve dhe rrjedhës së buxhetit të IAP-së për vitin 2015 do ta paraqesim në formën tabelare. Ndërsa, raporti dhe pasqyrimi i detajuar i të gjitha rrjedhave në buxhetin e IAP-së për vitin buxhetor 2015 sipas të gjitha kategorive dhe nënkategorive të veçanta ekonomike, i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas formularit të unifikuar për raportime financiare nga institucionet e pavarura, ashtu siç edhe kërkohet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në tabelën si në vijim e paraqesim buxhetin e IAP-së duke filluar me *Kërkesën buxhetore, buxhetin e ndarë, shkurtimet buxhetore dhe buxheti final për vitin 2015.*

<sup>133</sup> Ligji për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-0195, neni 35, paragrafi 2.

<sup>134</sup> Po aty.

<i><b>Kategoria Ekonomike</b></i>	Kërkesa buxhetore për vitin 2015	Buxheti i ndarë për vitin 2015	Buxheti i shkurtuar me plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Buxhetin të vitit 2015	Buxheti i shkurtuar gjatë dhjetorit 2015, me vendim të Qeverisë	<b>Buxheti Final 2015</b>	Buxheti final i vitit 2014
<b>Paga dhe mëditje</b>	798.742.02	675.469.99	624.774.99	23.239.72	<b>601.535.27</b>	596.371.00
<b>Mallra dhe shërbime</b>	459.239.00	390.353.00	329.011.00	14.809.27	<b>314.201.18</b>	390.353.15
<b>Shpenzime komunale</b>	30.000.00	25.500.00	25.500.00	9.089.98	<b>16.410.02</b>	25.500.00
<b>Shpenzimet kapitale</b>	12.000.00	0.00	0.00	0.00	<b>0.00</b>	10.000.00
<i><b>Gjithsej buxheti</b></i>	1.299.963.02	1.091.322.99	979.285.99	47.138.97	<b>932.147.02</b>	1.022.224.15

***Tabela 5: Kërkesa buxhetore, buxheti i ndarë, shkurtimet buxhetore dhe buxheti final për vitin 2015***

Planifikimi dhe shpenzimi i buxhetit është realizuar sipas nevojave dhe destinacionit të përcaktuar për punë dhe funksionimin e IAP-së, kurse nuk ka mundur monitorimi dhe kontrolli i brendshëm në shfrytëzimin e buxhetit. Mirëpo, me shkurtimin e buxhetit të IAP-së për vitin 2015, IAP-së i janë shkaktuar pasoja dhe pengesa në punë për ushtrimin e plotë të mandatit dhe kompetencave të IAP-së, sepse me këto shkurtime buxhetore IAP-së iu janë kufizuar punësimet e reja për të gjitha pozitat / vendet e punës të lejuara me buxhetin fillestar për vitin 2015, konkretisht ka ndikuar drejtpërsëdrejti në mosplotësimin e dhjetë (10) vendeve të lira të punës për vitin 2015, gjë që ka vështirësuar mbarëvajtjen e punës dhe ushtrimin e plotë të kompetencave kushtetuese e ligjore të institucionit gjatë vitit 2015.

Me rastin e përmbylljes së vitit fiskal 2015, pas analizës financiare të gjendjes së buxhetit në raport me mjetet e planifikuara për shpenzim deri më 31 dhjetor 2015, IAP ka identifikuar dhe vlerësuar kursimet buxhetore për kategorinë ekonomike Shpenzime Komunale në shumën prej 8,000.<sup>00</sup> €. Më 30 nëntor 2015, IAP ka dërguar njoftimin me shkrim Ministrisë së Financave për kursimin dhe kthimin e këtyre mjeteve financiare buxhetore, ndërsa një pjesë e kursimeve tjera buxhetore janë tërhequr drejtpërdrejtë nga Ministria e Financave me vendim të Qeverisë të Republikës të Kosovës të dhjetorit të vitit 2015.

### 4.3. Buxheti final i IAP-së dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2015

Buxheti i IAP-së për vitin buxhetor 2015 është realizuar për 94.66 %. Në tabelën vijuese e paraqesim gjendjen e buxhetit final në raport me shpenzimet buxhetore për vitin 2015. Paraqitja tabelare e të dhënave buxhetore është bërë sipas kategorive ekonomike dhe sipas shpenzimeve të shprehura në përqindje (%).

Nr.	Kategoritë ekonomike	Buxheti Final 2015	Buxheti i shpenzuar	Mjete të lira	Realizimi në %
1.	Paga dhe mëditje	601.535.27	601.535.27	0.00	100.00 %
2.	Mallra dhe shërbime	314.201.73	268.896.91	45.304.82	85.58 %
3.	Shpenzime komunale	16.410.02	11.951.32	4.458.70	72.83 %
4.	Shpenzime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00 %
<b>Gjithsej</b>		<b>932.147.02</b>	<b>882.383.50</b>	<b>49.763.52</b>	<b>94.66 %</b>

*Tabela 6: Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2015*

### 4.4. Financimi i IAP-së nga donatorët

Edhe gjatë vitit 2015, IAP është mbështetur nga organizata dhe institucione ndërkombëtare të cilat veprojnë në Kosovë si Këshilli i Evropës, OSBE, UNDP, GIZ, Ambasada e Francës etj. Kjo mbështetje ka konsistuar në përkrahjen financiare në realizimin e konferencave të ndryshme, trajnimeve dhe realizimin e vizitave studimore jashtë vendit.

## V. STATISTIKAT

### 5.1. Përmbledhja statistikore e ankesave dhe rasteve

Nga 1 janari 2015 deri më 31 dhjetor 2015, në selinë e IAP-së në Prishtinë dhe në zyrat rajonale janë parashtruar 1995 ankesa dhe kërkesa për këshillë apo ndihmë juridike, nga qytetarët e Kosovës. Me Avokatin e Popullit apo zëvendësit e Avokatit të Popullit janë takuar personalisht, 245 ankues, gjatë “Ditëve të hapura” të mbajtura dy herë në muaj në Prishtinë dhe së paku njëherë në muaj nëpër komuna të tjera.

Numri më i madh i rasteve të hetuara nga IAP, gjatë periudhës raportuese kanë të bënë me të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, mbrojtjen e pronës, të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit dhe mbrojtjen shëndetësore dhe sociale.

Në tabelat e mëposhtme, në mënyrë të hollësishme, paraqitet numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit 2015. Në këto tabela janë të pasqyruara të gjitha llojet e veprimeve dhe të rasteve me shifra absolute. Po ashtu, këtu janë të pasqyruara edhe rastet e zgjidhura nga IAP, raportet për rastet e hetuara dhe rekomandimet e nxjerra në raporte, dështimet e autoriteteve përgjegjëse për t’u përgjigjur në letrat e IAP-së, etj.

	<b>Numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura në IAP</b>	1995
	<i>Numri i personave të përfshirë në ankesat e paraqitura<sup>135</sup></i>	3281
<b><i>Përkatësia etnike e ankuesve</i></b>		
	Shqiptarë	1764
	Serb	131
	Boshnjak	30
	Turq	21
	Rom	16
	Egjiptas	13
	Ashkali	9
	Të tjerë	11
<b><i>Gjinia e ankuesve të paraqitur në IAP</i></b>		

<sup>135</sup> Një ankesë mund të ketë disa ankues, të cilët pohojnë se u janë shkelur të drejtat nga autoritetet publike

	Meshkuj	1546
	Femra	449
<i>Autoritetet përgjegjëse ndaj të cilave janë drejtuar ankesat (një ankesë mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)</i>		
	Gjykatat	587
	Ministritë	481
	Komunat	360
	Policia	101
	Person privat	89
	Autoritetet e huaja	64
	Prokuroritë Shtetërore	55
	Ndërmarrjet publike	55
	Kompanitë private	46
	Agjencia Kosovare për Privatizim	35
	Agjencia Kosovare e Pronës	14
	Të tjera	184

***Tabela 7: Ankesat e paraqitura nga qytetarët në IAP gjatë vitit 2015***

	<b>Numri i ankesave të shpallura të papranueshme</b>	1268
<b><i>Baza ligjore e papranueshmërisë së ankesave bazuar në Ligjin për Avokatin e Popullit</i></b>		
	S'ka shkelje, keqadministrim - Neni 22, pika 1.1	367
	Mos shfrytëzim i mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.4	332
	Në shfrytëzim të mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.3	253
	Jashtë juridiksionit - Neni 21, pika 1.3.1	248
	E parashtruar pas afatit ligjor - Neni 21, pika 1.3.2	37
	Mosinteresim, dështim i palës - Neni 22, pika 1.2	31

***Tabela 8: Ankesat e shpallura të papranueshme gjatë vitit 2015***

	<b>Rastet e hapura për hetim nga ankesat e paraqitura nga qytetarët</b>	727
--	---	-----

	<b>Rastet e hapura sipas detyrës zyrtare (Ex. Officio)</b>	30
<b><i>Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në rastet e hetuara</i></b>		
	Shqiptarë	608
	Serb	82
	Boshnjak	9
	Turq	9
	Egjiptas	7
	Rom	5
	Ashkali	2
	Të tjerë	5
<b><i>Gjinia e ankuesve bazuar në rastet e hetuara nga IAP</i></b>		
	Meshkuj	561
	Femra	166
<b><i>Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP (një rast mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)</i></b>		
	Gjykatat	249
	Ministritë	202
	Komunat	146
	Policia	41
	Prokuroritë Shtetërore	22
	Ndërmarrjet publike	13
	Agjencia Kosovare për Privatizim	12
	Person Privat	10
	Agjencia Kosovare e Pronës	9
	Kompanitë private	6
	Autoritetet e huaja	6
	Të tjera	76

***Tabela 9: Rastet e hapura për hetim IAP gjatë vitit 2015***

	E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	228
--	---	-----



Mbrojtja e pronës	118
E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit	110
Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	109
E drejta për mjete juridike	79
Të drejtat e të akuzuarit	55
Barazia para ligjit	53
Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues	27
E drejta e qasjes në dokumente publike	23
Të drejtat e fëmijës	22
E drejta për arsimin	22
Mbrojtja gjyqësore e të drejtave	17
E drejta e martesës dhe familjes	14
Raste për ndërmjetësim	13
Përgjegjësia për mjedisin jetësor	12
Dinjiteti i njeriut	8
E drejta për jetën	8
E drejta e lirisë dhe sigurisë	7
Liria e lëvizjes	7
E drejta e privatësisë	6
Liria e shprehjes	2
Liria e asociimit	2
Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore	2
Të tjera	8

***Tabela 10: Lënda e rasteve të hetuara, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë (një rast mund të përfshijë më shumë se një shkelje të të drejtave të garantuara)***

<b>Numri i përgjithshëm i rasteve të mbyllura</b>	<b>580</b>
<b><i>Baza ligjore e mbylljes së rasteve bazuar në Ligjin për Avokatin e Popullit</i></b>	
I zgjedhur pozitivisht, në pajtim me kërkesën e ankuesit - Neni 21, pika 1.5.	328

I papranueshëm, në shfrytëzim të mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.3	87
I papranueshëm, s'ka shkelje, keqadministrim - Neni 22, pika 1.1	80
I papranueshëm, mos shfrytëzim i mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.4	39
I mbyllur për mosinteresim të ankuesit, dështim i palës - Neni 22, pika 1.2	22
I mbyllur me raport	20
I papranueshëm, jashtë juridiksionit - Neni 21, pika 1.3.1	4

***Tabela 11: Numri i përgjithshëm i rasteve të mbyllura nga IAP gjatë vitit 2015 (jo vetëm rastet e vitit 2015, por edhe rastet e regjistruara më herët e të mbyllura gjatë këtij viti)***

<b>Autoriteti përgjegjës</b>	<i>Numri i letrave të dërguara nga IAP</i>	<b>Numri i letrave të mbetura pa përgjigje</b>
<b>SISTEMI GJYQËSOR DHE PROKURORIAL</b>		
Gjykata Kushtetuese e Kosovës	13	11
Gjykata Themelore në Prishtinë	73	14
Gjykata e Apelit	49	2
Prokuroria Themelore në Prishtinë	9	2
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme	40	2
Misioni i EULEX-it	1	1
<b>AUTORITETET QEVERITARE</b>		
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	16	12
Ministria e Drejtësisë	3	3
Ministria për Komunitete dhe Kthim	3	2
Qendra për Punë Sociale në Prishtinë	2	2
Komisioni Qeveritar për Verifikimin e Statusit të Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës	2	2
Ministria e Financave	2	1
<b>PUSHTETI LOKAL</b>		

Komuna e Prishtinës	12	9
Komuna e Pejës	4	2
Komuna e Prizrenit	4	1
Komuna e Mitrovicës	3	1
Komuna e Lipjanit	6	2
Komuna e Dragashit	3	1
Komuna e Gjilanit	3	1
Komuna e Drenasit	2	1
Komuna e Ferizajt	2	1
Komuna e Gjakovës	1	1
<b>INSTITUCIONE TË TJERA PUBLIKE</b>		
Qendra Klinike Universitare e Kosovës	3	3
Presidenca e Kosovës	2	1
Universiteti i Prishtinës	8	3
Policia e Kosovës	15	3

**Tabela 12: Dështimet e autoriteteve përgjegjëse për t'u përgjigjur në letrat e IAP-së**

	Raporte për rastet e hetuara (nga ankesat e qytetarëve)	15
	Raporte për rastet e hetuara <i>ex officio</i>	5
	<i>Rekomandime në Raportet e rasteve të hetuara</i>	57


**Tabela 13: Raportet me rekomandime për rastet nga IAP**

<b>Autoriteti përgjegjës</b>	<i>Rekomandime të implementuara</i>	<i>Rekomandime të paimplementuara</i>	<i>Në pritje për implementim</i>
Kuvendi i Kosovës	1	2	3
Gjykata Themelore në Prishtinë	1	1	
Shërbimi Korrektues i Kosovës		3	


Ministria e Drejtësisë		2	
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë		2	
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale		7	
Policia	2		
Ministria e Punëve të Brendshme	2		
Qeveria e Kosovës	2	11	2
Ministria e Shëndetësisë	1		
Komuna e Parteshit		1	
Komuna e Prishtinës		3	
Gjykata Themelore në Prizren	3		
Këshilli Gjyqësor i Kosovës		2	
Agjencia Kosovare e Pronës		2	
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme			1
Universiteti i Prishtinës	1		1
Zyra e Prokurorit Diciplinor	1		
<b>Gjithsej</b>	<b>14</b>	<b>36</b>	<b>7</b>

*Tabela 14: Zbatimi i rekomandimeve të nxjerra në raporte për rastet e hetuara nga IAP*


### Shqyrtimi i ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit 2015




*Figura 1: Paraqitja grafike e statistikave 1 janar 2015 - 31 dhjetor 2015*




*Figura 2: Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në ankesat e paraqitura në IAP gjatë vitit 2015*




**Figura 3: Gjinia e qytetarëve bazuar në ankesat e paraqitura në IAP gjatë vitit 2015**




**Figura 4: Autoritetet përgjegjëse të ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit 2015**




**Figura 5: Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në rastet e hapura për hetim gjatë vitit 2015**



**Figura 6: Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP**




**Figura 7: Lënda e rasteve të hetuara, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë**



**Figura 8: Rastet e mbyllura nga IAP gjatë vitit 2015 (jo vetëm rastet e vitit 2015, por edhe rastet e regjistruara më herët e të mbyllura gjatë këtij viti)**





**Figura 9: Zbatimi i rekomandimeve të nxjerra në raportet për rastet e hetuara nga IAP**

## Shkurtesat

<b>AKPv</b>	Agjencia Kosovare e Privatizimit
<b>AKPr</b>	Agjencia Kosovare e Pronës
<b>AKK</b>	Agjencia Kundër Korrupsionit
<b>AMM</b>	Agjencia për Mbrojtje të Mjedisit
<b>AOM</b>	Asociacioni i Ombudsmanëve të Mesdheut
<b>ASK</b>	Agjencia e Statistikave të Kosovës
<b>AShAK</b>	Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
<b>ASHMDHP</b>	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BIK</b>	Bashkësia Islame e Kosovës
<b>BSL</b>	Burgu i Sigurisë së Lartë
<b>CRONSEE</b>	Rrjetin e Ombudsmanëve për Fëmijë të Evropës Juglindore
<b>DAPK</b>	Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës
<b>DÇPB</b>	Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore
<b>DFDIL</b>	Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimat Civile
<b>DKA</b>	Drejtoria Komunale e Arsimit
<b>DKD</b>	Departamenti kundër Diskriminimit
<b>DUDNJ</b>	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
<b>DHPGJSK</b>	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës
<b>ECMI</b>	Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve
<b>ENOC</b>	Rrjeti Evropian i Ombudsmanëve për Fëmijë
<b>EOI</b>	Instituti Evropian i Ombudsmanëve
<b>EULEX</b>	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
<b>GDF</b>	Grupi për të Drejtat e Fëmijëve
<b>GJEDNJ</b>	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>GJKK</b>	Gjykata Kushtetuese e Kosovës
<b>GJTHP</b>	Gjykata Themelore në Prishtinë
<b>GJTHPz</b>	Gjykata Themelore në Prizren
<b>IAP</b>	Institucioni i Avokatit të Popullit
<b>ICC</b>	Komiteti Koordinues Ndërkombëtar i Institucioneve Kombëtare
<b>IGJK</b>	Instituti Gjyqësor i Kosovës
<b>IOI</b>	Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve
<b>IPFK</b>	Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës
<b>IPK</b>	Inspektoriati Policor i Kosovës
<b>IKDNJ</b>	Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut

<b>ISHM</b>	Instituti i Shëndetit Mendor
<b>KEDNJ</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KEK</b>	Korporata Energjetike e Kosovës
<b>KEDS</b>	Kompania Kosovare për Distribim dhe Furnizim me Energji Elektrike
<b>KES</b>	Këshilli Ekonomiko Social
<b>KGJK</b>	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
<b>KK</b>	Kuvendi Komunal
<b>KKSB</b>	Këshilli Komunale për Siguri në Bashkësi
<b>KKKP</b>	Komisioni i Kosovës për Kërkesa Pronësore
<b>KMDL NJ</b>	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut
<b>KMDF</b>	Këshillit për Mbrojtje dhe Drejtësi për Fëmijë
<b>KOMF</b>	Koalicioni i OJQ-ve për të Drejtat e Fëmijëve
<b>KOS</b>	Kisha Ortodokse Serbe
<b>KPK</b>	Këshilli Prokurorial të Kosovës
<b>KPRK</b>	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
<b>LQDP</b>	Ligji për Qasje në Dokumente Publike
<b>LGBT</b>	Lesbian, Gay, Bisexual and Transgender
<b>MAP</b>	Ministria e Administratës Publike
<b>MAPL</b>	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
<b>MBPZHR</b>	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MKK</b>	Ministria për Komunitete dhe Kthim
<b>MKPT</b>	Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
<b>MMPH</b>	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>MPMS</b>	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
<b>MSH</b>	Ministria e Shëndetësisë
<b>OAK</b>	Oda e Avokatëve të Kosovës
<b>OJQ</b>	Organizatë Joqeveritare
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>PLK</b>	Paneli për Lirim me Kusht
<b>QK</b>	Qendra Korrektuese
<b>QKRMT</b>	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
<b>QKUK</b>	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
<b>QP</b>	Qendra e Paraburgimit
<b>RTK</b>	Radio Televizioni i Kosovës
<b>SHSK</b>	Shërbimi Sprovues i Kosovës

<b>UÇK</b>	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
<b>UNDP</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
<b>UNICEF</b>	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
<b>UNHCR</b>	Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
<b>USAID</b>	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
<b>ZAP</b>	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
<b>ZKK</b>	Zyra për Komunitete dhe Kthim
<b>ZKM</b>	Zyra e Kryeministrit
<b>ZPD</b>	Zyra e Prokurorit Disiplinor
<b>ZQM</b>	Zyra për Qeverisje të Mirë